

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 9.2.2007**

**T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE DANA 9.02.2007.GODINE**

SHKURT – FEBRUAR 2007

Seanca plenare filloi në orën 12,00,në sallën e Kuvendit të Kosovës

Seancën e kryesuan: kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha dhe kryesuesi Xhavit Haliti

R e n d i i d i t ë s

1. Debat për propozimin e marrëveshjes për statusin e Kosovës.

1. Rasprava o predlogu rešenja statusa Kosova.

KRYETARI KOLË BERISHA – I nderuari president Sejdiu, i nderuari z. Surroi, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë dhe të pranishmit e tjerë, përfaqësuesit e zyrave ndërkombëtare të akredituara në Kosovë. Mirë dita dhe mirë se erdhët në këtë seancë plenare. Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit më 5 shkurt në një mbledhje të përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare mori vendim që ta konvokoj një seancë të veçantë plenare për 9 shkurt dhe të ftojë Grupin e Unitetit për të biseduar lidhur me dokumentin e z. Ahtisari.

Ju njoftoj se në sallë janë 102 deputetë.

Kolegë të nderuar, para se t'ia jap fjalën presidentit Sejdiu dëshiroj të konstatoj se jam shumë i lumtur që kërkesën nga seanca plenare për marrjen e një vendimi, të ashtuquajtur paketë e Ahtisarit, ta kenë në dorë menjëherë pasi ta marrë Grupi i Unitetit. Unë si kryetar i Parlamentit, por edhe Grupi i Unitetit dhe stafi administrativ e përmbushëm këtë kërkesë. Vërtet menjëherë pas përfundimit të mbledhjes që e kishim me z. Ahtisari ftuam Kryesinë e Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare për një bisedë të shkurtër dhe ua dhamë nga një kopje të dokumentit, që ky dokument të arrijë sa më shpejt deri te ju, së pari ashtu siç ishte në gjuhën angleze ua shpërndamë pasdite nëpër kutitë tuaja, me sqarimin se posa të përkthehet në gjuhën shqipe dhe atë serbe do ta keni në dorë. Pos kësaj Grupi i Unitetit ka mirëpritur ftesën e Kryesisë së Kuvendit dhe të shefave të grupeve parlamentare dhe ja që sot jemi këtu së bashku të bisedojmë për dokumentin në fjalë.

Ftoj presidentin Sejdiu që ta marrë fjalën:

PRESIDENTI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU – I nderuari kryetar i Kuvendit z. Berisha, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit, zonja dhe zotërinj

Kam nderin të jem sot me ju së bashku me Ekipin e Unitetit në këtë shqyrtim për fazën e fundit të vendosjes së statusit të Kosovës, në të cilën tashmë kemi shkelur.

Dorëzimi, të premtën e kaluar, i pakos së Presidentit Ahtisaari, të cilën ai e ka quajtur Propozim Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, nis fazën e fundit, e shpresojmë të shkurtër, të përmbyllet se statusit të Kosovës. Pas leximit të kujdesshëm që i kemi bërë individualisht dhe si Ekip i Unitetit, mund të përfundojmë me siguri të madhe se pakoja e Ahtisarit Kosovën e çon në pavarësi dhe sovranitet.

Gjatë 15 raundeve të bisedimeve në Vjenë dhe shumë kontakteve e konsultave në ndërkohë, delegacionet dhe ekipet e Kosovës kanë bërë një punë të madhe dhe të mundimshme, me qëllim të formësimit të këtij dokumenti të rëndësishëm, i cili përcakton të ardhmen e vendit tonë.

Pakoja, në tërësinë e saj është e pranueshme për Ekipin Negociator, e unë jam i bindur edhe për popullin e Kosovës. Gjatë këtyre ditëve, Ekipi i Unitetit së bashku me Grupin Politik Strategjik dhe ekipet e tjera profesionale, po analizojnë në hollësi dokumentin për të parë se ku mund të përmirësohet. Të gjitha propozimet për përmirësimet e mundshme nuk kanë për qëllim dhe nuk do ta vënë në dyshim pakon si tërësi. Do të jemi plotësisht të gatshëm që të vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë me presidentin Ahtisaari dhe ekipin e tij. Për këtë arsye, Ekipi i Unitetit i ka konfirmuar presidentit Ahtisaari pjesëmarrjen e Kosovës në konsultimet e mëtejme në Vjenë, sipas kërkesës së tij. Në këto konsulta do të diskutojmë me hartuesit e këtij dokumenti për aspekte të caktuara të pakos me qëllim të përsosjes së mëtejme të këtij dokumenti, i cili Kosovën duhet ta bëjë shtet funksional. Vërejtjet tona assesi nuk kanë për qëllim dhe nuk synojnë rihapjen ose rinegociimin e pakos si tërësi.

Të nderuar deputetë, zonj a dhe zotërinj :

Dokumenti që kemi para nesh është version parafinal e jo dokument inicial. Për këtë arsye jemi të bindur se nuk duhet të rihapet për negociata të mëtejme, por vetëm të korrigjohet në segmente të caktuara, për aq sa është e mundshme.

Ekipi i Unitetit, siç e ka theksuar edhe në deklaratën e vet menjëherë pas pranimit të pakos më 2 shkurt, është i bindur se procesi ndërkombëtar i zgjidhjes së statusit të Kosovës, të cilit po i prin presidenti Ahtisaari, do të përmbyllet se shpejti me bërjen e Kosovës shtet të pavarur, me të gjitha garancat e duhura për komunitetet që jetojnë në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetin serb.

Kosova shtet, në kufijtë e saj aktual, me një pushtet funksional, ekonomi tregu, demokraci pluraliste, me të drejtat dhe garancat për të gjithë qytetarët dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë, është zgjidhja e vetme e qëndrueshme për statusin e Kosovës. Prandaj, ne jemi të bindur se presidenti Ahtisaari, në raportin e tij final të cilin do t'ia dorëzojë Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-se, përkatësisht Këshillit të Sigurimit, do të japë rekomandim të qartë për pavarësi për vendin tone. Propozimi duhet të jetë eksplisit dhe të mos lërë dilema as politike e as juridike për të ardhmen e Kosovës.

Deputetë të nderuar, zonja dhe zotërinj:

Kosova dhe populli i saj po i kalojnë çastet e fundit dhe vendimtare në ndërtimin e të ardhmes së vet. Optimizmin për një të ardhme të lumtur dhe prosperuese, ne dhe

qytetarët e Kosovës e mbështesim në përcaktimin tonë të fuqishëm për stabilitet dhe paqe me të gjithë fqinjët tanë dhe në vendosmërinë tonë për integrim të shpejtë në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Është po ashtu përcaktim i fuqishëm i popullit të Kosovës që të vazhdojë të kultivojë marrëdhënie të veçanta dhe miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Populli i Kosovës është i bindur se koha e luftërave në këtë pjesë të Evropës ka përfunduar një **herë e mirë** dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve e sheh vetëm me rrugë dhe mjete paqësore e kursesi me dhunë. Dhuna tashmë, jemi të sigurtë, është e huaj dhe e kaluar për popullin paqedashës të Kosovës.

Me qëllim të përmbylljes sa më të shpejtë të fazës finale, do të vazhdojmë të punojmë të gjithë së bashku, duke bashkëpunuar ngushtë me miqtë dhe partnerët kryesorë të Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare. Askush nuk duhet të ketë as më të voglin dyshim se Kosova, me resurset e mëdha natyrore dhe humane që ka, do të dijë të ndërtojë një shtet të qëndrueshëm, i cili po kështu do të kontribuojë për stabilitetin e rajonit dhe më gjerë.

Kosova tashmë është në prag të hyrjes në familjen e kombeve të lira dhe demokratike. Zyrtarizimi i statusit të Kosovës, si shtet i pavarur do t'i heqë edhe pengesat e fundit për rimëkëmbje dhe shtim të përshpejtuar ekonomik të vendit tonë.

Të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj:

Populli i Kosovës ka arsye të plotë që të ardhmen e vet ta shohë me optimizëm, sepse garancë për këtë është, përpos propozimit të presidentit Ahtisaari, është përcaktimi i fuqishëm i popullit të Kosovës për të qenë i lirë dhe i pavarur dhe pjesë e botës demokratike. Për këtë, populli i Kosovës ka dhënë prova të fuqishme gjatë historisë së vet, e sidomos gjatë dy dekadave të fundit.

Shqyrtimi i sotëm i këtij dokumenti të rëndësishëm në Kuvendin e Kosovës është edhe një kontribut shumë i vlefshëm për realizimin përfundimtar të vizionit tonë të përgjithshëm për Kosovën -shtet të pavarur dhe sovran. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. president. Fjalën e ka z. Thaçi.

DEPUTETI HASHIM THAÇI - I nderuari kryetar i Parlamentit, i nderuari president. Te nderuar deputetë, të nderuar të gjithë ju të pranishëm në sallë.

Te nderuar qytetarë të Kosovës

Kosova, politika dhe populli i saj ka mirepritur dhe pranuar dokumentin e dorëzuar nga presidenti Ahtisaari të mbeshtetur nga e gjithë bota demokratike, SHBA-te, Bashkimi Evropian dhe nga Grupi i Kontaktit.

Propozimi i botës demokratike është mirepritur nga politika kosovare, ne do ta respektojmë agjenden konsultative për takimet në Vjenë.

Bota po e pranon dhe njeh Kosoven.

Te nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës

Dokumenti permban substancën e shtetit të ardhshëm të Kosovës.

Kosova vend demokratik, me identitet shtetror, e gatshme për të qeverisur veten, e gatshme për të ndërtuar institucione demokratike dhe funksionuar efektivisht.

Kosova shtet modern me demokraci qytetare.

Realitetin e pavarsisë se Kosovës me sakrificat e të gjithë qytetarëve të Kosovës e kemi arritur ne qershor te vitit 1999, *populli i Kosoves e fitij me luften e vet, sot bota demokratike po na njeh .*

Për këtë realitet duhet të ndihemi krenarë të gjithë, çdo qytetar i Kosovës e ka pjesën e vet të meritës për lirinë dhe shtetin që po ndërtojmë.

Rruga jonë nuk ka qene e lehtë,por plotë pengesa, vuajtje e sakrifica.

Gjatë historisë shqiptarëve iu ndodhen padrejtsi, qe nga viti 1912, populli ynë luftoi, por nuk fitoi, nuk kishim aleatet e duhur, luftuam edhe ne vitin 1945, ishim në anën e aleateve, por perseri Kosova u ripushtua.

Vazhdoi periudha e ndejkejeve, e burgosjeve dhe e internimeve. Në fund te viteve 1960 filluam të formësoheshim politikisht, proklamua kerkesën për Republikë,por u mashtrua prapë.

Kjo kerkese ka vazhduar më 1968, por u theksua qartë dhe fiqishem më 1981, kur populli ynë nga Universiteti i Prishtinës masovikisht fuqizoi kerkesën e vet per pavarësi.

Kosova Republike nuk ishte tashme kërkesë e nje grupi të caktuar politik, por ishte vullneti i popullit të Kosovës.

Pavarsia ishte vullneti i gjithe shqiptarëve.

Ky vullnet është më i vjeter se çdo ideologji apo parti politike në Kosovë për këtë vullnet jetuan dhe sakrifikuan breza me radhe, baballarët tanë, baballarët e baballareve tanë, ne sot duhet investojme për femijet tanë dhe për fëmijëte femijëve tanë.

Zonja dhe zotërinj

Kur permendim pavarësine dhe krijimin e shtetit tonë- gjithëmonë -ne dhe bota demokratike duhet kujtuar vitet e rinisë kosovare nëpër burgjet anekend Jugosllavisë.

Duhet kujtuar internimet, sakrificën e madhe të botës akademike, izolimet e intelektualeve, rolin e jashtezakonshëm të diasporës qe ndauë për lirinë dhe pavarësinë e Kosoves edhe kafshatën e gojës.

Duhet kujtuar lotët e nënave tona që prisnin në arkivole trupat e njomë të vellezereve tanë nga burgjet apo ushtria jugoslave.

Duhet kujtuar deportimet masive të popullit tonë.

Por, ne gjithmonë besuam në drejtësi dhe fituam.

Kulmi i nderimit, përljes dhe kujtimit tonë duhet mbetur gjithmonë tek ata që ranë për liri në luftën heroike të UÇK-së dhe familjet e tyre, rreth 20 000 martire të lirisë dhe mijëra të tjerë të zhdukur, ankthet e familjeve të tyre, gjymtyrët e trupit të invalidëve të luftës. Duhet kujtuar luftën dhe masakrat në Prekaz, Likoshan, Reçak, Izbicë, Mejen dhe anekënd Kosovës

Duhet menduar dhe punuar me respekt për fëmijët jetimë që humben prindërit se si po rriten ata në lirinë e Kosovës, të arritur me gjakun e prindërve të tyre, është obligim ynë ata t'i bëjmë të lumtur në jetë dhe krenarë me shtetin e Kosovës.

Duhet kujtuar me respekt çdo njeri dhe çdo rast që ka sakrifikuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Para se gjithash duhet të përulemi para jetës dhe veprës së komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jasharit, pastaj Zahir Pajazitit, veprimtarëve Jusuf Gervalla, Kadri Zeka, komandanteve Agim Bajrami, Ismet Jashari, Agim Ramadani, Meh Uka, Fehmi Lladrovci, Sali Çeku etj.

Duhet kujtuar të sakrifikuarit për pavarësi: Fehmi Aganin, Latif Berishën, Bardhyl Çausi, plakun e urtë Anton Çeten.

Te nderuar deputetë, qytetarë të nderuar,

Gjendemi në periudhën e sfidave të mëdha të njohjes definitive të realitetit të shtetit tonë. E përmenda një periudhë kronologjike të sakrificës së historikut të popullit tonë, për të argumentuar dhe për të prezantuar edhe një herë vendosmërinë tonë se për Kosovën është vetëm një zgjidhje dhe pavarësinë e Kosovës në Kosovë nuk e sjell presidenti Ahtisari, por e kemi merituar, kemi sakrifikuar, kemi luftuar dhe e kemi fituar të gjithë ne.

E kemi mirëpritur propozimin e presidentit Ahtisari, sepse ky propozim është propozim i botës demokratike, është propozim për të ardhmen e Kosovës, është propozim për Kosovën demokratike, është propozim për Kosovën multietnike, është propozim për Kosovën për të jetuar **mirë** e sigurt të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim të përkatësisë etnike. Pra, Kosova edhe de jure po bëhet shtet,

-Kosova do ta nxjerr Kushtetutën e vet moderne,

-Kosova shtet i të gjithë qytetareve të saj, me të drejta e **afirmuara** për minoritetet, para së gjithash për serbet,

- Kosova shtet ku do te sundojël ligji,
- Kosovës i garantohet integriteti territorial edhe ndërkombëtarisht,
- Sovraniteti Serbisë po largohet përfundimisht nga Kosova,
- Kosova po fiton subjektivitetin ndërkombëtar,
- Kosova do t'i ketë simbolet shtetërore, flamurin, stemën dhe himnin,
- Kosova veç i ka disa prej simboleve shtetërore, simbolet inkluzive dhe të pranueshme nga te gjithë, TMK-ne, Shërbimin Policor, federatat e ndryshme sportive.
- Kosova fiton te drejtën të aplikoje për anëtarësim ne OKB,
- Te jetë anëtare e Bankës Botërore,
- Kosova të jetë pjesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar,
- Kosova do ta ketë ushtrinë e vet, pjesë e kontinuitetit të transformimit të UÇK-TMK - Ushtri e Kosovës, e integruar ne Partneritet për paqe e më vonë edhe ne NATO.
- Kosova do ta ketë shërbimin e vet modern të Intelegjencës,
- Kosova do të zhvillojë marrëdhënie shumë të mira me fqinjët,
- Do të ruhen dhe kultivohen monumentet kulturoro-historike,
 - Do të ndodhë reformimi i pushtetit lokal, sipas parimit qytetar e jo etnik apo territorial,
 - Kosova do te ketë ekonomi te lire te tregut, qe do ti mendësoi vendit zhvillim ekonomik dhe jete me te mire për qytetaret;
 - Do te ndodhin reforma ne politike, ekonomi dhe legjislacion,
 - Kosova do të jetë ne te ardhmen e afërt anëtare e Bashkimit Evropian
 - Anëtare e NATO-s
 - Do të kemi edukim më të mirë,
 - Shëndetësi me efikase,
- Kosova do të jetë anëtare e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian,

- Kosova do të jetë anëtare e Këshillit të Evropës,
- Kosova do vazhdojë të jetë pjesë aktive e luftës globale antiterroriste,
- Në Kosovë do ketë vend vetëm demokracia, e kurrë bota e se keqes apo bota e mbyllur,
- Kosova do të jetë pjesë moderne dhe demokratike e Evropës dhe e botës së qytetruar,
- Kosova do të jetë në çdo kohë dhe rrethanë partner i qëndrueshëm i Perëndimit, në veçanti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i Bashkimit Evropian.
- Kosova i beson dhe ka arsye t'i besojë Amerikës dhe Perëndimit, por edhe ata popullit të Kosovës,
- Procesin e statusit do ta përmbysim bashkërisht dhe do ta thellojmë bashkëpunimin me Perëndimin dhe jo që Perëndimi do të jetë në Kosovë, por edhe ne do të jemi çdokund ku janë shtetet moderne.

-Kosova mirëpret prezencën e lehtë civile ndërkombëtare dhe prezencën e NATOS,

-Populli i Kosovës do të informohet për gjithë procesin, në çdo kohë, Parlamenti do të nxjerrë vendime të drejta në kohë të duhur, në përputhje me vullnetin e qytetarëve-Kosova shtet i pavarur dhe sovran. E kur të nxirret vendimi nga Parlamenti i Kosovës ky vendim do të jetë duke respektuar të kaluarën tonë, duke respektuar punën tonë aktuale, por edhe duke respektuar vizionin tonë për të ardhmen e Kosovës, për të ardhmen e Kosovës demokratike me orientim perëndimor, për të ardhmen e Kosovës në paq e siguri, stabilitet, bashkëpunim rajonal dhe integrim Evropian dhe në NATO, por mbi të gjitha Kosovën në paqe me reflektime për stabilitet në gjithë rajonin. Shteti i Kosovës është zgjidhja e vetme për popullin e Kosovës, por zgjidhja më e mirë edhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe për Bashkimin Evropian, prandaj ne jemi në vitin historik, vitin e vendimit për zyrtarizmin e realitetit, të vendimeve historike të vitit 1999 e unë besoj se askush nuk do t'i shikojë interesat partiake, por të gjithë do të ngrihem mbi interesat partiake për të investuar, për të punuar dhe zyrtarizuar sakrificën tonë dhe vullnetin e qytetarëve për shtet të pavarur dhe sovran. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Thaçi, Fjalën e ka Veton Surroi

DEPUTETI VETON SURROI - I nderuari president, i nderuari kryeministër, i nderuar kryetar i Kuvendit koleg i Ekipit të Unitetit, z. Thaçi, të nderuar znj. dhe zotërinj. Është me të vërtetë nderimi të jem këtu dhe të ndaj mendimet për atë se si e kam lexuar këtë dokument dhe atë se çka do të rekomandoja që do të bënim ne si Kuvend, çka do të duhej të bënte Ekipi Negociator, çka do të duhej të bënte grupi ynë politik-strategjik, të dy instancat që deri më sot kanë punuar bashkë dhe do të vazhdojnë të japin një përgjigje

të përbashkët ndaj kësaj sfide dhe në fund të fundit çka do të duhej të bënte Kuvendi i Kosovës, sepse kjo është instanca e cila do të sanksionojë, do të marrë vendimin përfundimtar për çfarëdo procesi negociator që të ndodhë.

Unë e kuptoj pakon e Ahtisarit si një lloj fletëkalimi, është një lloj fletëkalimi për pavarësi, me të kapërcehet një rubikon i rëndësishëm, një rubikon edhe i bashkësisë ndërkombëtare edhe yni i përbashkët ,sepse me të kalojmë prej sovranitetit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, është një hartë e rrugës në të cilën na tregohet se si kalohet prej sovranitetit të Organizatës së Kombeve të Bashkuar në sovranitet të Kosovës, në marrje të plotë të kompetencave si shtet sovran. Me këtë vazhdon ecja historike e vitit 1999. Aso kohe iu mor sovraniteti Serbisë ose ai që quhej sovranitet juridik i Serbisë nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, tash ky sovranitet po i kthehet pronarit të vet legjitim -popullit të Kosovës. Instrumentet e këtij sovraniteti janë aty, janë në atë pako, mund t'i shihni në simbole, në fjalë, në interpretime, qoftë nga aderimi në organizatat ndërkombëtare, të drejtat për traktate, qoftë në kontrollin e hapësirës ajrore, qoftë në nënshkrimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjë që mund të bëjnë vetëm shtetet sovraane, qoftë në suksesionin ekonomik që do të thotë marrje e përgjegjësisë në krejt procesin e zhbërjes së Jugosllavisë nga aspekti i pronësisë, qoftë në procesin e ndërtimit të Ushtrisë së Kosovës, gjegjësisht të forcës së sigurisë së Kosovës.

Në këtë drejtim kjo është një fitore e një ecjeje historike, është një fitore e popullit të Kosovës, një lëvizje e cila ishte e bashkuar që nga viti 1989, në formë të spikatur, por secilës i parapriu edhe një shekull i tërë përpjekjesh të ndërtimit institucional, të ruajtjes së identitetit edhe të ruajtjes ekzistenciale në momente kritike ,siç ishte ajo në luftë. Pra, një lëvizje që kaloi shumë sfida, përfshirë edhe përndjekjen kolektive dhe e cila mund të krenohet gjithashtu me luftën e vet të pabarabartë kundër okupatorit. Duhet thënë me plotë gojë se nuk duhet të kemi drojë nga pakoja e Ahtisarit për sa i përket statusit të Kosovës, ky është fryt i një partneriteti shekullor ,i cili fillon me rënien e murit të Berlinit, një partneritet i cili do të zhvillohet gjatë këtij shekulli në mes Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare. Kosova më në fund ka hyrë në një rrjedhë historike të favorshme për të unifikimit evropian dhe pavarësia e Kosovës duhet të trajtohet në këtë kuadër, në kuadër të bashkimit të shteteve dhe të popujve evropian, popujve të lirë evropianë. Po krijohet një marrëdhënie e re me pakon e z. Ahtisari në mes Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare. Është një shtet unitar, por me kompetenca të forta në nivel të pushtetit lokal, po jepen instrumente të forta për mbrojtjen e komuniteteve pakicë dhe po propozohen instrumente të forta të pranisë së ardhshme ndërkombëtare. Po ndërtohen në fakt dy parime pjesë e një besimi. Parimi i parë është se u jepet besim i plotë qytetarëve të Kosovës që ta kenë të drejtën historike të pronësisë, të sovranitetit mbi vendin e tyre dhe është një besim tjetër, besim pak më i mangët e ajo është një besim jo i plotë ndaj shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës për të menaxhuar atë shtet. Po të kishte qenë besim i plotë ne nuk do të duheshim kaluar nëpër këtë fazë të negociatave e as me këtë dokument, por thjeshtë do të na njihej e drejta e plotë e sovranitetit.

Njëra prej të cilave ka marrë më së shumti kohë, mund, energji, por edhe kënaqësi ka qenë çështja e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. Gjatë vitit 2006 zhvilluam atë çka do të kishte qenë nevojë të bëhej shumë më herët, ky është një dialog i brendshëm në shoqërinë tonë në mes komuniteteve me komunitetet pakicë, në radhë të parë për të identifikuar se cilat janë ato nevoja, cilat janë ato instrumente dhe në fund të fundit si do

të jetë ajo kornizë e cila do t'i mbrojë këto të drejta ,duke mos i cunguar të drejtat e shumicës. Trashëguam në këtë ecje në vitin 2006 edhe përvojat e mira të Kornizës Kushtetuese, por edhe përvoja të këqija të kësaj kornize kushtetuese ,të cilat jemi përpjekur t'i ndryshojmë. U përpoqëm që në këshillin konsultativ të komuniteteve të gjejmë forma, modalitete për ndërtimin e marrëdhënieve të reja në mes të shumicës dhe pakicës dhe pakicave duke aplikuar edhe përvoja të mira jo vetëm të shteteve të avancuara, por edhe këto të rajonit.

Në fund një pjesë bukur e madhe e punës, të cilën e kanë bërë anëtarët e komuniteteve pakicë në Kosovë, është integruar në pakon e Ahtisarit, në fakt shumica e çështjeve të cilat janë ngritur nga komunitetet pakicë janë të vendosura në pakon e Ahtisarit dhe aty mund të themi se kemi një pronësi, ose një bashkëpronësi me Ekipin e z. Ahtisari.

Ka qenë një rrugë bukur e gjatë dhe nuk ka qenë e lehtë, është një rrugë e gjatë të cilën e kemi kaluar për të dëshmuar se Kosova e sotme, Kosova e këtij viti nuk është Kosova e verës së vitit 1999, nuk është ajo ku janë përndjekur serbët, kur janë përndjekur turqit, kur janë përndjekur boshnjakët, kur janë përndjekur egjiptasit, kur janë përndjekur romët vetëm pse nuk kanë qenë shqiptarë, nuk është vera e vitit 1999 kur në këtë përndjekje nuk ka pasur përgjigje, ka ndryshuar krejtësisht situata dhe Kosova nuk është ndërtuar dhe as që do të ndërtohet mbi urrejtjen ndaj popujve tjerë. Liria e shumicës ndërtohet me respektim të plotë ndaj lirive të komuniteteve pakicë dhe përgjegjësia e komuniteteve pakicë është të ruajnë shtetësinë e Kosovës si prodhim të përbashkët të të gjitha komuniteteve.

Prania e lehtë ndërkombëtare është diçka që ne e quajmë dhe kemi kërkuar, por prania e lehtë ndërkombëtare znj. dhe zotërinj nuk ekziston në pakon e Ahtisarit, krahasuar me UNMIK-un, krahasuar me Bosnjen dhe Hercegovinën është në fakt një prani e lehtë ndërkombëtare, por këtë prani duhet identifikuar të atillë çfarë është. Është një prani ndërhyrëse, është një prani e cila merr në duar sundimin e ligjit dhe është një prani e cila në masë të madhe nuk e njuh besimin e institucioneve kosovare në mbrojtjen e ruajtjen e rendit dhe të ligjit. Këtë duhet pranuar si realitet të pakos së z. Ahtisarit, nuk mund t'i mbyllim sytë ndaj asaj që ekziston. Në një rrethanë normale kjo gjë do të ishte natyrisht e papranueshme, por Kosova nuk është në një rrethanë normale, është një proces negociator dhe është një proces partneriteti. Prania e ardhshme ndërkombëtare po të krahasohej me Bosnjen do të jetë version i lehtë ndaj tij, do të ketë kontroll të sundimit të ligjit, do të ketë mundësi ndërhyrjeje në jetën zgjedhore në Kosovë e kjo do të thotë edhe ndërrimin e zyrtarëve të zgjedhur dhe mbi të gjitha përfaqësuesi i ardhshëm ndërkombëtar do të ketë të drejtë të plotë interpretimi të asaj që ai e quan implementim të statusit, d.m.th ai mund të ndërhyjë kur dhe si të dojë në qoftë se interpreton si shkelje të statusit, çfarëdo gjesti të autoriteteve kosovare. Kjo është çka gjendet në pakon e Ahtisarit dhe këtë duhet ndarë si brengë në mes nesh sot.

Një përparësi e madhe, krahasuar me atë të Bosnjes është se prania e ardhshme ndërkombëtare nuk do të merret me ligjvënien ,gjë që ka qenë një kategori e aplikuar në Bosnje gjatë viteve të fundit. E tërë kjo tregon për një ndëshkim që bëhet, një ndëshkim që u bëhet bashkërisht institucioneve të Kosovës dhe UNMIK-ut. Në vitet e fundit znj. dhe z. jemi përpjekur të ndërtojmë një sistem, një sistem joefikas në mbrojtjen e së drejtës, sundimin e ligjit, ky ka qenë një partneritet jo shumë produktiv në mes UNMIK-ut dhe institucioneve kosovare dhe parazpesha e cila është arritur në vitet e fundit për të ruajtur një qetësi sociale në mes UNMIK-ut e institucioneve kosovare . Këtë duhet

pranuar mos krijimi në Kosovë është një baraspeshë e cila ndëshkohet tash me praninë e ardhshme ndërkombëtare dhe të drejtën e ndërhyrjes së tyre në çështjet e sundimit të ligjit. Statusi nuk është vetëm fjalë historike, momentet që mban statusi, është përditshmëri dhe statusin e ndërtojmë në përditshmëri, disa prej nesh që kemi qenë të zëshëm në kritikën, p.sh për çështje elementare ,siç është Villa Gërmia, banale, por e cila nuk lidhet- mendon njeriu me statusin, çështja si suksesion, kush do të mendonte se këto çështje do të lidhen me statusin, me të drejtën e një populli për të qeverisur vetveten, të gjitha këto dhe vlerësimet se kemi joefikasitet qeverisës, joefikasitet institucional në fund paguhen me marrëveshjen e statusit dhe me rolin ndërkombëtar që do të ketë prania e ardhshme ndërkombëtare në Kosovë. Tash dua t'i ndaj me ju 4-5 brenga që mendoj se dalin nga kjo pako dhe të cilat kërkojnë adresim nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës dhe nga ekipet respektohet, Grupi Politik strategjik dhe nga Delegacioni i Kosovës.

I pari është problem strukturor e ky është Mitrovica. Ekzistojnë dy çasje: Mitrovica dhe Veriu i Kosovës, ekzistojnë dy çasje për t'i adresuar këto çështje ose ne kemi menduar se ekzistojnë dy çasje .E para është që të ketë një integrim të ndihmuar të kësaj pjese e cila nuk është administruar nga Kosova as nga UNMIK-u që të integrohet në Kosovë dhe ky është modeli i Sllavonisë Lindore, ky model nuk është aplikuar, ose nuk është propozuar nga z. Ahtisari dhe kemi një model të integrimin të vullnetshëm. Integrimi i vullnetshëm znj. dhe z. do të marrë kohë, do të kërkoj menaxhim të qetë dhe të mençur dhe do të kërkojë çasje të re politike si prej politikës në Prishtinë ashtu edhe prej përfaqësuesve politikë shpresojmë të përfaqësuesve të rinj politikë në atë pjesë të Kosovës.

Çështja e dytë, pengesë strukturore të cilën ne e kemi ngritur në formë konsekuente në Vjenë, janë lidhjet horizontale dhe vertikale të komunave. Kjo është një çështje të cilën duhet riadresuar si brengë jona ,sepse kjo është një formë “sugeneris” ne nuk mund të gjejmë një model të njëjtë dikund tjetër dhe të themi se në bazë të përvojave të atij vendi apo të këtij vendi ka rezultuar kështu. Ky është një model krejtësisht i ri dhe ne duhet të shohim të projektojmë se cilat janë ato probleme eventuale me të cilat do të ballafaqohemi në të ardhmen.

Çështja e tretë është prania e fortë ndërkombëtare ,do të jetë në dëm të ngritjes dhe forcimit të institucioneve të Kosovës. Politika e dobët e Kosovës, strukturat e saj institucionale, do të ballafaqohen me prani të fortë ndërkombëtare dhe këtu do të ballafaqohemi me vazhdimin e institucioneve të dobëta si p.sh ky Kuvend do të miratojë një buxhet, por ministri i Financave duhet të kalojë më herët tek administratori i ardhshëm për t'ia treguar atë buxhet dhe për të marrë leje për atë buxhet, nuk është vetëm buxheti, janë edhe shumë çështje të tjera.

Do të kemi një problem me llogaridhënien ,siç e kemi sot , sepse është lehtë për kosovarët për të thënë se e kemi praninë e ardhshme ndërkombëtare, ata edhe ashtu po vendosin dhe ne nuk mund t'u japim llogari zgjedhësve tanë, ky është një problem real i cili cungon e dobëson forcimin e institucioneve kosovare dhe mund të kemi bashkëdyzim institucioneve të dobëta në fushën e sundimit të ligjit. Ne ende nuk dimë se si do të funksionojë policia jonë me policinë ndërkombëtare dhe kjo është një çështje e cila duhet të zgjidhet sepse janë çështje operative të cilat kërkojnë edhe një parimësi ndërtimi, por natyrisht kërkojnë edhe vendime ekzakto dhe të përditshme.

Në javën që vjen ne duhet të përgatisim si ekip negociator përgjigjet për këtë pako dhe në këtë drejtim njeriu duhet të pyetet se çka realisht mund të bëjë Delegacioni i Kosovës. Na

është tërhequr vërejtja dhe këtë duhet ta themi publikisht dhe ta ndajmë me juve se dy çështje pothuajse janë të panegociueshme, prania e sigurisë dhe segmenti i pranisë së ardhshme ndërkombëtare janë çështje të cilat nuk janë negociuar me ne fare, janë sjellë pa u negociuar paraprakisht. Jemi informuar, natyrisht për disa segmente, por nuk është një pako të cilën e ka negociuar ekipi të cilit ju i keni dhënë besim. Çështja është si do të pozicionohemi ndaj këtyre dy pikave. Unë do të sugjeroja që fillimisht të bëjmë një interpretim se cilat janë ato çështje më urgjente, më të mëdha, më kapitale, në të cilat duhet drejtuar vëmendjen tonë dhe aty kam identifikuar këto: Te çështja e komuniteteve pakicë kemi të bëjmë vetëm me një problem teknik e ky është e njëjta gjë që ka vlerë për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit me vendet e rezervuara të aplikohet edhe te përbërja e Qeverisë. Në dokumentin e z. Ahtisari kemi përsëritje të modelit libanez të ndërtimit të Qeverisë d.m.th të identifikimit të ministrave sipas përkatësisë kombëtare.

Te decentralizimi është shumë e qartë se duhet të rivizitojmë me propozime praktike çështjen e lidhjeve horizontale dhe vertikale, sepse ato mund të na krijojnë një fushë ende të paeksploruar, mund të na sjellin probleme të funksionimit rreth relacionit në mes qendrës dhe pushtetit lokal dhe çka është më me rëndësi besoj duhet të përqendrohemi te prania e ardhshme ndërkombëtare, sepse kjo është **pika** ku ndërtohet partneriteti. Na nevojiten dy çështje elementare te prania ndërkombëtare. E para është që prania e ardhshme ndërkombëtare t'i shërbejë forcimit të institucioneve kosovare e jo të ngulfas ndërtimin e këtyre institucioneve.

Dhe çështja e dytë është që prania e ardhshme ndërkombëtare, prania e Bashkimit Evropian duhet të shërbejë për përgatitjen e Kosovës që të integrohet në Bashkimin Evropian me parametra të qartë. Parametrat e qartë nuk janë vetëm elaborime teorike, formale mbi atë se çka janë vlerat evropiane. Një detyrë e qartë është si do të zhvillohet Kosova në hapësirën buxhetore evropiane prej vitit 2007 deri në vitin 2013 dhe çka mund të bëjë Bashkimi Evropian në këtë drejtim dhe çka kosovarët në këtë drejtim, Atë çka kamë parë unë se është bërë edhe nga partnerët ndërkombëtarë dhe nga institucionet tona, është jashtëzakonisht e dobët, jashtëzakonisht e varfër në këtë përgatitje dhe jashtëzakonisht kundërproduktive.

Me këtë po e përfundoj mbi të gjitha na nevojitet të identifikojmë se kjo është kohë e iniciativës së kosovarëve. Nuk është dashur të presim që presidenti Ahtisari të na tregojë se Kosova ka nevojë për flamur dhe për stemë të vetën. Kjo është një çështje që kemi mundur ta zgjidhim vetë, si kjo ka shumë gjëra të tjera të cilat kemi mundur t'i zgjidhim vetë. Po hyjmë në një kohë krejtësisht të re. Nuk mund të hyhet as me ide as me sjellje të vjetra, kjo znj. dhe z. është koha kur në dyert tona po troket historia. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Surroi. Me qenë se është fjala për regjistrimin e secilit diskutues, kërkoj ta korrigjoni se ka qenë një lapsus juaj atje ku i numëroni pakicat e ndjekura, ndër të tjera thoni se janë ndjekur vetëm pse nuk janë shqiptarë. Besoj se është një lapsus ky.

Fjalën e ka kryeministri Agim Çeku.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – I nderuari z. president, z. kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë të Grupit të Unitetit, të nderuar deputetë, ministra.

Kërkoj falje që u vonova pak, por e patëm për vizitë një delegacion të senatorëve dhe të kongresmenëve amerikanë të udhëhequr nga senatori Libermend dhe senatori Mekejn të

cilët m'u lutën që t'jua përcjell përshëndetjet e tyre dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm për mbështetjen e Kosovës tani dhe në të ardhmen. Do të përpiqem të jem sa më i shkutër që t'ju lë kohë juve për debat.

Para më shumë se një viti ky parlament i dha mbështetje formacionit të përbërë nga pesë krerë të institucioneve politike në vend apo atij që gjegjësisht që sot njihet si Ekipi i Unitetit për të hyrë në biseda për statusin e Kosovës. Mandati i këtij ekipi ka qenë që të hyjë në bisedime me bashkësinë ndërkombëtare me qëllim që të përmbyllë në afat sa më të shpejtë statusin final të Kosovës. Të gjithë e dimë se as ky ekip dhe as ndonjë ekip tjetër nuk do të negocionte për pavarësinë e Kosovës, sepse pavarësia e Kosovës është.

1. E panegociueshme
2. Dhe është gjendje faktike.

Është gjendje faktike, sepse i bart vulën dhe stemën e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të dëshmorëve të kombit, të përpjekjeve të vazhdueshme të popullit tonë për liri dhe pavarësi dhe si e tillë nuk ka qenë dhe nuk është në pikëpyetje. Këto biseda janë bërë për njohjen e sovranitetit ndërkombëtar të Kosovës. Njohja e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës sikurse jemi dëshmitarë është një proces delikat dhe i ndërlikuar. Para një viti ne dinim më pak se sot, ne kemi pasur dëshirën dhe të drejtën në anën tonë. Sot dimë saktësisht se çfarë duhet bërë, sot e kemi mbështetjen e gjerë të bashkësisë ndërkombëtare, synime shumë mirë të formuluar, argumente tepër të fuqishme dhe një dokument gjithëpërfshirës. të cilën na e prezantoi para pak ditësh i dërguari special i Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës presidenti Ahtisari. Të nderuar deputetë, dokumenti i z. Ahtisari përshkruan në fakt modalitetet e rregullimit të brendshëm të shtetit sovran dhe të pavarur të Kosovës. Ai është një dokument i cili krahas vënies së attributeve të shtetit të Kosovës që do të thotë të drejtat dhe përgjegjësitë, na ngarkon gjithashtu edhe me detyra dhe me përgjegjësi. Këto detyra dhe përgjegjësi kanë të bëjnë në masë të madhe me dhënien e garancive për pakicat me theks të posaçëm të banorët serbë të Kosovës. Të nderuar përfaqësues të popullit ju e dini se politika është një mundësi për të bërë ndryshime, ndryshimi i parë i madh që duhet ta bëjë është shkëputja nga e kaluara. Pra, nuk ka kthim në gjendje para vitit 1999, nuk ka kthim të Serbisë në Kosovë, tani ne duhet të fillojmë t'i shohim pakicat në Kosovë si pjesë integrale e shoqërisë kosovare dhe në këta hapa të parë që do të jenë të vështirë për ta, t'u japim siguri të nevojshme se asgjë e keqe nuk do t'u ndodhë në shtetin e pavarur të Kosovës. Ne nuk guxojmë t'i përsërisim gabimet e të së kaluarës, gabimet që të tjerët i kanë bërë ndaj nesh, duhet t'i luftojmë fobiet se banorët serbë të Kosovës nuk përbëjnë asnjë kërcnim për këtë vend. Me kohë do të zhvillojmë një raport shumë më cilësor në mes komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe fqinjëve tanë.

Të nderuar deputetë mandatin që i keni dhënë Ekipit të Unitetit nuk ka qenë mandat i lehtë. Procesin të cilin e kemi kryer me bekimin tuaj nuk ka qenë një ekskursion, është një lojë e vështirë gjatë së cilës arbitrat nuk kanë dhënë shumë herë kohë shtesë. Jemi në minutat e fundit, kemi përparësi të ndjeshme, rrugëtimin tonë e dimë dhe po i shihet fundi, por jo çdo gjë në këtë propozim është saktësisht, siç kemi dashur, i përmendën edhe të tjerët. Kemi bregua për funksionalitetin e pushtetit lokal qëndror, për procesin e vendimmarrjes, për referencat e forcës së ardhshme ushtarake, për fatin e TMK-së të përfshirë në këtë forcë, por ne do t'i zbërthejmë këto 60 faqe në ligje, norma dhe veprime konkrete, Vetëm atëherë ky dokument merr trajtë dhe vetëm atëherë do të jemi në gjendje

të nxjerrim më të mirën prej tij. Kjo kërkon vullnet të mirë, kërkon profesionalizëm dhe bashkëpunim.

Qeveria ka marrë pjesë gjatë tërë këtij procesi duke ofruar infrastrukturë si dhe burime njerëzore financiare. Qeveria do t'i respektojë të gjitha obligimet që do të dalin nga marrëveshja dhe do t'i zbatojë ato. Mbështetja juaj është e pazëvendësueshme. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. kryeministër. Radhën e kanë shefat e grupeve parlamentare. Fjalën e ka Alush Gashi, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryetar i Kuvendit. I nderuari zotëri kryetar i Kosovës z. Fatmir Sejdiu, z. kryeministër, znj. dhe z. deputetë dhe ministra të pranishëm.

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka mbështetur propozimin e z. Ahtisarit duke e rezervuar të drejtën për sugjerime konstruktive për dokumentin final. Z. kryetar jemi të përcaktuar të jetojmë në paqe të brendshme dhe në mirëqenie me fqinjët. Si çdokund në botë të lirë ashtu edhe në Kosovë të pavarur, është obligim i shumicës të garantojë dhe të mbrojë të drejtat e pakicave dhe nga pakicat pret qasje konstruktive në të gjitha proceset e vendit dhe në raport me fqinjët. Z. kryetar kërkesë jona e panegociueshme është pavarësia e plotë e vendit tonë, shtet normal evropian me sovranitet bashkohor. Dykuptimësia eventuale lidhur me pavarësinë dhe funksionalitet të plotë integrues do të jetë pengesë për vazhdim të zhvillimit të institucioneve demokratike, mirëqenies vendore dhe stabilitetit. Duke i dhënë mbështetje Delegacionit të Kosovës, kërkojmë respektim të plotë të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës të miratuar më 17 nëntor të vitit 2005, po ashtu kërkojmë inkuadrimit të sugjerimit të deputetëve në komunikimet e mëtutjeshme me bashkësinë ndërkombëtare, qoftë në ato nga debati apo të tjerat të dhëna në mënyrë të shkruar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit z. Gashi. Fjalën e ka shefi i Grupit të PDK-së Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. president, z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi, të nderuar kolegë deputet.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në procesin e vështirë politik për shtetin e Kosovës ka hyrë nga pozita e opozitës për të ndërtuar unitetin e veprimit edhe pse partitë e tjera të koalicionit dhe opozita e vogël shpesh nuk e kanë përcjellë gatishmërinë tonë. Pra kjo u pa jo më larg se dje, - e kuptojmë se dikush mungesën e investimeve për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës dëshiron ta mbulojë me inat dhe gjelozi të papërmbajtshme, për suksesin e vizitës së kryetarit të PDK-së së Kosovës në shtetin e Izraelit. Në vend që t'i gëzoheshin një suksesi të Kosovës me jashtë me një shtet që ka ndikim të fuqishëm në botën perendimore ,dikush inatoset **derisa të kërkojë** personalisht më shqetëson kjo kulturë komunikimi në kohën kur duhet forcuar unitetin politik të veprimit. Besoj se e dini se PDK-ja nuk është parti që mungesa e liderit e bën të sille si qurat në mjegull apo si boksieri i nokautuar në ring. Dokumenti i parashtruar nga presidenti Ahtisari si propozim gjithëpërfshirës i marrëveshjes për statusin e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran është rezultat i një pune jo të shkurtër të Grupit Negociator dhe

të trupave të tij politikë e profesionalë në komunikimin zyrtar me mekanizmat euroatlantikë, në rastin tonë me presidentin Ahtisari. Natyrisht këtu është edhe roli aktiv i aktorëve relevantë ndërkombëtarë e veçanërisht i Grupit të Kontaktit dhe i z. Ahtisari me ekipin e tij. Dokumenti ndonse nuk përmbush pritjet tona kombëtare, është një hap i madh që faktori relevant ndërkombëtar i bën njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. Ky dokument edhe kështu si është me mangësi ka arritur ta hedhë hapin e parë të madh drejt shkëputjes së Kosovës nga Serbia dhe hapi tjetër do të jetë njohja e shtetit më të ri të botës nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Ne po punojmë për këtë. Unë do të dëshiroja të shpreh nga këtu konsideratat e mja të larta për vendet anëtare të Grupit të Kontaktit dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, përfaqësuesit e të cilëve intenzivisht janë angazhuar në këtë proces që nga marsi i vitit 1998 pas lavdisë dhe flijimit biblik të Jasharajve legjendarë me komandantin legjendar të UÇK-së Adem Jasharin për lirinë dhe shtetin si dhe për zyrtarët e Zyrës së UNOSEKUT në krye me presidentin Ahtisari të cilët na sollën propozimin rreth të cilit po debatojmë sot dhe i cili do ta çojë Kosovën në njohjen ndërkombëtare të shtetit. Populli i Kosovës në vazhdimësi gjatë periudhave të ndryshme historike ka shprehur aspiratën dhe vullnetin e tij për liri, për demokraci dhe barazi në një shtet të pavarur dhe sovran. Ka pasur të drejtë edhe më shumë se për pavarësi edhe para 100 vitesh, por e drejta në vetvete qenka tepër pak për ta finalizuar ëndrrën shekullore për të cilën u deshën sakrifica të mëdha njerëzore dhe materiale. U desh një luftë çlirimtare e popullit të Kosovës e organizuar me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ne gjithmonë i kemi vlerësuar dhe do t'i vlerësojmë angazhimet dhe ndihmën e dhënë nga bashkësia ndërkombëtare në drejtim të dëbimit nga Kosova të aparatit okupues e represiv të Serbisë, që në mënyrë sistematike ka ushtruar dhunë e terror deri në përmasa të gjenocidit dhe etnocidit kundër popullit shqiptar të Kosovës. Nga fundi i luftës në Kosovë e deri më sot institucionet tona nuk i kanë krijuar konturat e ndërtimit të shtetit sovran dhe të pavarur të Kosovës, ashtu si e meritojnë qytetarët e Kosovës e sidomos këtë nuk e kemi bërë si duhet në dy tri vitet e fundit. Nuk janë pa faj as zyrtarët e lartë të administratës ndërkombëtare që kanë lejuar shkeljet e ligjeve dhe keqpërdorimet e tjera nga zyrtarë e qeveritarë të Kosovës. Tani ne duhet të angazhohemi me përgjegjësi të shtuara dhe të kompenzuara që i kemi humbur gjatë viteve të shkuara. Kosovës i duhen drejtues të përgjegjshëm politikë, për të ndërtuar shtetin ligjor ku do të jenë të barabartë të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallime etnike, religjioze, politike, racore e gjinore. Për këtë ne jemi angazhuar, do të angazhohemi dhe këto obligime do t'i zbatojmë në shtetin tonë që po e zyrtarizojmë duke pranuar dhe ratifikuar të gjitha konventat ndërkombëtare për liri dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve pakicë. Sipas dokumentit të sjellë nga presidenti Ahtisari i titulluar Propozimi gjithëpërfshirës i marrëveshjes për statusin e Kosovës është evidente se Kosova i plotëson kushtet që i kërkojnë normat juridike ndërkombëtare për të qenë shtet i pavarur, sovran e veçanërisht në raport me Serbinë.

Ne do ta mirëpresim angazhimin dhe praninë ndërkombëtare civile dhe ushtarake në Kosovë edhe pas zyrtarizimit të pavarësisë si faktor ndihmës për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik, demokratizimin e shoqërisë sonë dhe integrimin e shtetit tonë në Bashkimin Evropian dhe me mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë. Sipas z. Ahtisari ky dokument akoma nuk e ka marrë formën përfundimtare. Konsiderojmë se mund të punojmë dhe ka hapësirë që z. Ahtisari dhe ekipi i tij dhe aktorët e tjerë relevantë ndërkombëtarë të përfshihen në këtë proces, të marrin në konsideratë vërejtjet dhe

sugjerimet tona që do të jenë me qëllim të qartësimit të konkretizimit dhe të krjimit të premisave që shteti i Kosovës të jetë efikas, funksional në zbatimin e obligimeve dhe detyrave që do të dalin pas zyrtarizimit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. Kjo do të ndikonte edhe në heqjen e mëdyshejeve dhe të keqkuptimeve që mund të krijohen te qytetarët e Kosovës. Kjo na obligon që sot t'u drejtohem jo vetëm mbështetësve tanë, por të gjithë qytetarëve të Kosovës që kanë besim në këtë proces, në procesin e bërjes së shtetit të pavarur dhe sovran. Do ta fitojmë të gjithë ose do ta kundërshtojmë të gjithë se veprimet tona të PDK-së nuk do të jenë si....., **por nëse është** nevoja ne të parët do të ballafaqohemi për t'i mbrojtur të drejtat tona të fituara me luftë, me gjak dhe me sakrifica të shumta. Për këtë kemi dhënë më shumë se një herë prova të verifikuara, të njohura edhe ndërkombëtarisht, në këtë rrugë nuk ishim të vetëm. Me ne ishte edhe komuniteti demokratik ndërkombëtar, prandaj ne jemi të obliguar t'u besojmë se do të jenë me ne edhe në bërjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Ne konsiderojmë se që në fillim të dokumentit do të duhej në mënyrë eksplicite të precizohej se Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve të saj dhe jo shoqëri shumetnike, shpresojmë dhe besojmë se kjo do të ndodhë në dokumentin final të z. Ahtisari, që do ta shpalojë para Grupit të Kontaktit dhe Këshillit të Sigurimit, se do t'i eliminojnë nga teksti final të gjitha ngarkesat që e dëmtojnë funksionimin e shtetit demokratik të Kosovës.

Grupi Parlamentar i PDK-së ka 5 rekomandime për Grupin Negociator.

1. Decentralizimi: **Kështu****shumë** pak është decentralizim standard, i pameritueshëm dhe i shpërputhshëm. Me prezencën e tyre numerike në aspektin ekonomik e financiar ky proces është i pa përbalueshëm, vështirë i realizueshëm dhe si i tillë nuk ofron shumë perspektivë të qartë për shumicën e as për pakicën në Kosovë. E kemi pranuar ashtu siç e kemi ofruar gjatë bisedimeve në Vjenë, sepse e kemi parë si çmim për shtetin e pavarur dhe sovran të njohur ndërkombëtarisht. Decentralizimi duhet të mbetet ashtu siç është ofruar nga Ekipi Negociator se oferta ishte në kufirin e standardeve më të larta për decentralizimin.
2. Mitrovica: Oferta e Grupit Negociator për Mitrovicën duhet të mbetet ashtu siç u është ofruar z. Ahtisari dhe ekipit të tij pa ndryshime në territor. Koha e administrimit nga administratori i ardhshëm duhet të ketë qëllim integrimin e qytetit e jo ndarjen e tij. Në marrëveshje duhet të jetë e thënë në mënyrë eksplicite si detyrë për përfaqësuesin civil ndërkombëtar se ai do ta bëjë integrimin e qytetit.
3. TMK-ja duhet të riformohet në ushtri profesionale mbrojtëse për nevojat dhe mundësitë që i ka Kosova në trupë profesionale që e di nga i merr detyrat dhe përgjegjësitë që udhëhiqen nga politika. Të tjerët që nuk i përmbushin kriteret që i kërkon një ushtri moderne ata duhet të shkojnë në pension të parakohshëm, kjo duhet të vlejë për pjesëtarët e UÇK-së, pjesëtarët në TMK që nuk i plotësojnë kushtet të mbesin aty mund të kalojnë në Shërbimin Policor të Kosovës.
4. Votimi i dyfishtë: Duhet të rishikohet dhe votimi i dyfishtë i 2/3 së pakicës në Parlament, vendet e rezervuara me votën e dyfishtë e bllokojnë punën e Parlamentit dhe kjo nuk do të duhej të ndodhte.
5. Rishikimi me afatizim: Në projektdokumentin e marrëveshjes thuhet se pas dy viteve duhet të rishikohet se çka është arritur dhe si ka funksionuar

përfaqësuesi civil ndërkombëtar. Ne mendojmë se duhet të rishikohet funksionaliteti i të gjithë marrëveshjes dhe duhet të bëhen afatizime dhe konkretizime.

Me këto vërejtje dhe rekomandime edhe një herë po e cek se për Grupin Parlamentar të PDK-së dokumenti i Ahtisarit është një dokument që ofron aspiratën dhe realizimin e ëndrrës së qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit z. Krasniqi. Për AAK-në Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – I nderuari z. president, z. kryeministër, z. kryetar i Kuvendit z. Thaçi dhe Surroi, ministra dhe deputetë të nderuar.

Aspirata e Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran tanimë është e njohur dhe daton shumë më herët. Esenca e kësaj aspirote është ndërtimi i shtetit dhe i shoqërisë moderne të Kosovës që do të funksionojë brenda aleancave perëndimore. Populli i Kosovës ka pritur një kohë të gjatë për plotësimin e saj. Me propozimin e presidentit Ahtisari hapet rruga për konkretizimin e kësaj aspirote, njëkohësisht fillon faza përfundimtare për përfundimin e procesit, prandaj ky moment është i veçantë dhe historik. Z. kryetar. Grupi Parlamentar i AAK-së e mirëpret debatin e sotëm për shqyrtimin e propozimit të presidentit Ahtisari. Dokumentin e kemi studiuar me shumë kujdes dhe në detaje. Grupi Parlamentar i AAK-së në tërësi e mbështet propozimin dhe zbatimin e tij në kuadër të pranimit të pavarësisë së Kosovës. Edhe pse dokumenti nuk përmend pavarësinë megjithatë përmban bazat e shtetësisë që është shumë e rëndësishme për sigurinë tonë politike, ekonomike dhe sociale. Nga përmbajtja e pakos veçojmë 4 elemente kyçe.

1. Kosova fiton të gjitha elementet e një shteti të pavarur me të drejtë të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare politike dhe financiare, himnin, flamurin, stemën, forcën mbrojtëse dhe njohjen e kufijve aktualë të Kosovës. Bazuar në këtë njohje të shtetit të Kosovës nga shtetet e tjera do të bëhet duke përfillur këta kufij të Kosovës, kështu tërësia territoriale është e siguruar.
2. Është e lidhur me rolin e fuqishëm të pranisë civile ndërkombëtare me një përfaqësues me autorizime dhe kompetenca të shumta për të siguruar zbatimin e marrëveshjes. Rolin qendror, pos BE-së e luajnë NATO dhe OSBE-ja.
3. Hapet rruga e ndërrimit të Rezolutës 1244 dhe e aprovimit të rezolutës së re të Këshillit të Sigurimit, duke krijuar kështu mundësinë që Kosova të vendosë vetë.
4. Ka të bëjë me pozitën e minoriteteve e kryesisht atij serb. Akomodimi i komunitetit serb është paraparë në tri segmente. decentralizimin e pushtetit, trashëgiminë religjioze dhe kulturore dhe përfaqësimin në Kuvendin e Kosovës përmes ulëseve të rezervuara dhe aplikimit të shumicës.....
gjatë procesit të votimit të ligjeve.

Pakoja përmban ,gjithashtu, elemente me të cilat jemi më pak të kënaqur, prandaj komentet tona do t'i ofrojmë në debatin e sotëm ashtu që përmes Delegacionit të Kosovës t'ua përcjellin z. Ahtisari dhe bashkësisë ndërkombëtare, por vlerësojmë se konsultimet

e mëtejme të pakos duhet të jenë të tilla që nuk mund të ketë ndryshim, gjegjësisht kompromis për elementet e rëndësishme për ndërtimin e shtetit stabil të Kosovës. Pjesët e pakos në të cilat kemi vërejtje janë:

Sa i përket dhënies së nënshtetësisë, data përcaktuese e propozuar si kriter për dhënien e nënshtetësisë është 1 janar 1998. Ky kriter konsiderojmë se është i mangët sepse është vetëm njëri nga kriteret që duhet marrë parasysh duke e përjashtuar praninë e pjesëtarëve të MUP-it, të ushtrisë Jugosllave dhe të refugjatëve nga Kroacia. Kështu deri sa kushtetuta votohet nga 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, ndryshimi i sajë propozohet të bëhet me aprovimin e shumicës së Badenterit, pra pos 2/3 e deputetëve duhet të përfshihen edhe 2/3 e deputetëve të komunitetit pakicë.

Për të siguruar funksionimin efikas dhe efektiv të institucioneve duhet siguruar se nuk do të ketë mundësi të komplikimeve në zbatimin e këtij mekanizmi.

Sa i përket sektorit të sigurisë ,pos përcaktimit të shpërbërjes së strukturave paralele. duhet definuar afatin. Propozojmë që kjo të bëhet gjatë fazës kalimtare të përfundimit të misionit të UNMIK-ut, pra brenda 3 deri 4 muaj.

Duhet të definohet qartë mekanizmi që integron qytetin e Mitrovicës. Nuk mjafton krijimi i bordit të përbashkët i cili zhvillon bashkëpunim funksional.

Vërejtja e fundit ka të bëjë me borxhin ndërkombëtar Besojmë se nuk duhet pritur një vit që çështja e borxheve ndërkombëtare të zgjidhet përmes bisedimeve në mes të përfaqësuesve të Kosovës dhe të Serbisë, por duhet të aplikohet menjëherë mekanizmi i arbitrit ndërkombëtar.

Siç e thashë më lartë, jo të gjithë janë të kënaqur me propozimin, por shprehja e pakënaqësisë duhet të bëhet me mjete demokratike që përjashtojnë dhunën. Në këtë moment jetik populli i Kosovës duhet të qëndrojë i bashkuar. Tani duhet të demonstrojmë pjekuri, maturi, mençuri dhe qetësi, veti këto që e karakterizojnë popullin e Kosovës.

Disa në Kosovë, përfshirë edhe minoritetet mund të jenë **anksiozë** ose të zhgënjyer, por pavarësisht sfidave ne i pranojmë përgjegjësitë tona për zbatimin e pakos për të siguruar dhe respektuar të drejtat e minoriteteve tani dhe pas statusit.

Angazhimet institucionale dhe ligjore që dalin nga pakoja të cilat Kosova duhet t'i përmbushë janë të larta, por Kosova është e gatshme për këtë hap të ardhshëm, si institucione marim obligimin me e zbatu marrëveshjen.

Jemi të bindur se shteti i Kosovës do të jetë në funksion të ndërtimit dhe të avancimit të vlerave demokratike të institucioneve që garantojnë të drejtat e njeriut, qeverisje të mirë dhe respektim të plotë të të drejtave të minoriteteve, prandaj përmbyllja e procesit duhet të përshpejtohet. Nuk duhet të ketë vonesë dhe pritje të tjera, pritjet e vazhdueshme shkaktojnë pasigurinë për të ardhmen.

Ekonomia e pazhvilluar, papunësia, problemet e stabilitetit të rajonit, e bëjnë më urgjente zgjidhjen e statusit të Kosovës. Pa dyshim se i tërë rajoni i Ballkanit dhe Evropa do të përfitojnë nga një Kosovë stabile dhe demokratike. Ky është një zhvillim pozitiv dhe i shëndoshë për tërë Kosovën.

Të nderuar deputetë! Grupi Parlamentar i Aleancës e rikonfirmon përkrahjen e Delegacionit të Kosovës në përmbylljen e fazës përfundimtare për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Po ashtu inkurajon Delegacionin e Kosovës që t'i marrë parasysh vërejtjet tona në evidentimin e elementeve të rëndësishme të pakos dhe të bëjnë sa më shpejt që është e mundur vlerësimin e duhur ashtu që të përcaktohet saktë agjenda e veprimeve të ardhshme në funksion të finalizimit të procesit të shtetësisë së Kosovës. Ju faleminderit.

KRYEETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të ORA-s Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA - Faleminderit z. kryetar.

Nga viti 1999, Kosova defakto është jashtë juridiksionit të Serbisë. Administrim ky i cili është paraparë të zgjatë diku 3 vite. Zgjatja e kësaj filloi ta pengojë Kosovën që të vazhdojë jetën e saj normale. Mosgatishmëria e institucioneve të ballafaqohen me probleme të mëdha dhe mosgatishmëria e marrjes së përgjegjësive edhe me këtë edhe e së drejtës dhe e privilegjit për formimin e shtetit me mosgatishmërinë e UNMIK-ut që të jetë partner në këtë rrugë, shkaktuan zgjatjen e statuskuos. Edhe pse funksionimi demokratik i institucioneve tona ende ishte larg funksionimit të institucioneve në shtetet me demokraci të konsoliduar ishte nevoja për ndryshimin kualitativ të statusit të Kosovës. Mosndryshimi i gjendjes, statuskuoja nisi të jetë pengesë e vazhdimit të jetës normale për qytetarët tanë. Dokumenti i Kai Aides hapi rrugën për fillimin e këtij ndryshimi. Formimi i Ekipit të Unitetit, fillimi i bisedimeve, një vit bisedime e treguan kompleksitetin dhe peshën e kësaj çështjeje kaq të rëndësishme, jo veç për kosovarët, por edhe për regjionin, për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për të gjithë miqtë tanë ndërkombëtarë.

Dokumenti i Ahtisarit është rezultat i punës së ekipeve, por edhe i të gjitha institucioneve tona prej vitit 1999 e deri më sot. Nga dokumenti burojnë kornizat apo konturat e shtetit dhe sa do të zgjat ky proces i shtetëformimit me të gjitha kompetencat, kjo është përgjegjësi dhe varet nga ne. Ky dokument mundëson kyqjen tonë në organizatat ndërkombëtare, monetare dhe në organizata të tjera ,të cilat janë karakteristikat e shteteve. Lejon mundësonë që kosovarët të nisin të jetojnë normalisht, të merren me probleme të zakonshme ,me të cilat mirren qytetarët e shteteve sikur edukimi, shëndetësia, pensionet, gjendja e rrugëve etj. Kjo pako krijon mundësinë që Kosova jo vetëm defakto, por de jure të jetë jashtë juridiksionit të Serbisë, prej nesh varet që Kosova të jetë shtet për qytetarët pa dallim feje, etnie, gjinie. Ne si grup parlamentar e përkrahim punën e Grupit të Unitetit dhe inkurajojmë deputetët që me komentet e tyre të ndikojnë që Grupi i Unitetit t'i marrë parasysht ato. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ Xhezair Murat.

POSLANIK DŽEZAIR MURAT – Poštovani predsedniče Kosova, poštovani premieru, predsedniče Skupštine, kospodo Thaqi i Surroi, gospodo ministri, kolege poslanici.

Iznosim mišljenje Parlamentarne Grupe 6+ o kojom dokumentat koji je pred nama pruža dobru osnovu za stvaranje jednog stabilnog društva. Predlog paketea g. Ahtisaria je vrlo složen ali sve obuhvatan dokumenat kojim se nudi rešenje za konačan status, regulisanje odnosa svih zajednica koje žive na Kosovu i u tom pogledu on je svakako historijski jer otvara put i korak Kosova ka učlanjenju u porodicu država, odnosno u različite međunarodne organizacija, asociacije, u delu atlantskih ujedinjene nacije, monitarni fond itd. Gospodo, da bi obaj predlog paket bio uspešan i prihvatljiv za sve građane Kosova, prijie svega treba da zadovolji potrebe većinske zajednice kao preduslov zadovoljenja potreba i drugih manjebrojnih zajednica, naravno na ovom dokumentu ima nedovoljno

definisanih sadržaja kao i nedovoljno predloga za razvoj privrede, investicija, socialno politike itd. Ovom prilikom bih pomenuo da je poveći prostor jednostrano posvećen jednostranom očuvanju kulturnog i vjerskog nasleđa za samo jednu zajednicu, drugim rečima u njemu je nejednak tretman svih zajednica, naravno mi iz parlamentarne grupe 6+ smo mišljenja i ako svjesni da se mnogo nemogu menjati njegove odredbe i sadržaj, da iznesemo neke od primedaba koje ćemo na vreme i u pisanoj formi priložiti i pregovaračkoj ekipi Kosova ali i ekipi UNOSEKA.

Kao flagrantnu primedbu koju ću ovom prilikom iznjeti je ta: da se ostale zajednice, ne albanske i nseerpske kako nas često nazivaju ni u jednom delu dokumenta ne pominju sem tamo gde su rezervisana mesta. Oni spadaju u autoktone ili kako negde piše, po meni neodređeno tradicionalne, one se jednako prisutne ovde kao i ostale koje se pominju.

Takođe bih izneo još jedan detalj kde u opštim principima u članu 1 stavu 1.1 Kosovo je multietničko društvo u stavu 1.6 to se ne gira tvrdnjom da su zvanični jezici Kosova albanski i srbski a da se ne pomenu recimo jezici ostalih zajednica koje se govore u nekim od opština gde oni čine značajan broj.

Ja bih takođe ovde izneo još jedan primer po meni kršenja prava nesrpskih i nealbanskih zajednica gde u članu 3 gde se govori o pravima zajednica i njihovih članova pod tačkom (b) se pominje da imaju javno obrazovanje na jednom od zvaničnih jezika Kosova po njihovom izboru na svim nivoima. Ako se dobro razmisli može se videti šta se ovde sugerše, mislim da je ova odredba suprotna zakonu o obrazovanju koji je usvojen ovde i zakonu o upotrebi jezika takođe usvojen u ovoj Skupštini.

Ja ne bih se dalje bavio svakako primedbama koje imamo ali ću pomenuti još jednu a to je da je u odeljku o decentralizaciji vrlo malo prostora se posvećuje ostalim zajednicama i ako su se one dogovorili i ovde u skupštini i sa institucijama da se o njima ovde odlučuje ali bih imao samo primedbu da je cenzus koji se pominje od 75% kao jedan od preduslova za osnivanje novih opština u stvari previsoki i treba smanjiti.

Mi ćemo sve naše primedbe koje imamo priložiti na vreme, i timu jedinstva i ekipi UNOSEK-a i da se u načelu s tim slažemo. Hvala!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Përfaqësuesi i Grupit për Integrim Numan Baliq.

POSLANIK NUMAN BALIĆ – Dozvolite mi najpre da vas selamim i da istaknem da ću govoriti i u ime grupe za integraciju, ali u svoju ime.

Nastaviću da govorim o nekim realnim problemima i o nekim konkretnim stvarima koji se tiču ukupnih preokupacija vezanih za albansku većinu, za manjinske zajednice i takođe za srbsku zajednicu ovde na Kosovu.

Mislim da trebamo biti svesni u situaciju koju nalazimo. Najgora stvar koja se može dogoditi jednom pojedincu i njegovoj porodici ili jednom narodu da nije svestan situacijom u kojoj se nalazi. Ja naravno pozdravljam cjeli optimizam koji smo slušali i sve govore pomalo patetične koje smo čuli ali je situacija veoma ozbiljna i ja bih istakao da je ona onakva kakvo mi je predstavio jedan od školovanih diplomata koje smo imali kao musafire ovih dana i koji je rekao da je situacija na Kosovu je delikatna. Situacija je delikatna i kompleksna, mi moramo svatiti svu njeno ozbiljnosti i moramo pogledati

istini u oči. Ono što želim da istaknem jeste da imamo nekoliko činjenica na koje trebamo obratiti pažnju.

Ahtisarijev dokumnet nije konačno rešenje, on je predlog rešenja. G. Ahtisari je rekao da je to kompromis, g. Ahtisari takođe je rekao ovih dana da je to dokument koji se može izmjeniti ili neko to želi porekne ili možda neko da kakže da g. Ahtisari ne govori istinu, to je pitanje kako za gospodina iz grupe Uniteta tako i za mene i sve odgovorne grupe u ovoj zemlji koji su duboko zabrinuti ili treba biti zabrinuti za sudbinu ove zemlje koja se nalazi na razmeđu. G. Solana je rekao više puta da veruje u dogovor i vjeruje o dogovor koje će obe strane biti zadovoljne, treba ozbilno razmilito o tome što to kaže, šta tč znači jer ja mislim da g. Sollana nikad ne govori uzalud. Takođe da juče i danas smo svedoci toga da se po drugi put vrši značajan ustup srbskoj strani, znači po drugi put se odlaže rešenje statusa Kosova, nakon što smo celu godinu čekali prošlo da on bude rešen, sada ponovno imamo odlaganje statusa Kosova za to što g. Tadić i družina u Beogradu traži da se to desi.

Pitanje da li će biti novog predloga, dali će taj novi predlog biti restriktivnijem za državnost Kosova i hoće li taj novi predlog biti novi ustup srpskoj strani, to je pitanje o kome mi treba ozbilno da se zabrinemo svi mi, institucija kosova, Parlament, Vlade, pregovarački tima i svih ostali. Ovo govorim naravno sa najboljim namjerama ako me osobno pitate imam li optimizma, naravno imam kao i svi kosovari i za izvoz, isto tako i strpljenja ali nije dovoljno imati, trebamo imati optimizma sa pokričem, i treba suočiti sa realnostima.

Pitanje koja se plasira u javnost, a koja glasi: Da li podržavate Ahtisarijev predlog prema meni je neadekvatno i dendenciozno, ja ne poznajem nekog zvaničnikog predstavnika koji bi bio danas ili koji makar koji faktor na Kosovu koji bi rekao da ja ne podržavam Ahtisarija, dakle nije pitanje da li mi podržavamo ili ne, nego je pitanje da li smo mi mogli učiniti mnogo više, i da li je grupa uniteta i svi mi zajedno mogli učiniti da taj dokument bude mnogo bolje nego što stvarno jeste, to je pravo pitanje. Mislim da i delovanje grupe uniteta i medija koji su servilno služili svih ovih meseci išlo je u tom pravcu da se obrati pažnja od stvarnih problema a da se pažnja usmeri prema nekim drugim problemima. Mislim da treba usred srediti na to šta je stvarno sadržaj Ahtisarijeveg predloga da se trebamo konačno okanutu neistinitih tumašenja i da trebamo narodu saopštiti istinu, ono što jeste u vezi sa tim rečiču nekoliko činjenica.

Pavaresia e plote, ose pavarsia e kushtezuar, koja se obečava mesecima, obečavala se i prva, a nije se htelo čuti zanema u Ahtisarijevem dokumentu, nema da budemo ozbilni i istiniti. Član 1 kaže veoma jasno. Citiram u albanskoj verziji.

Kosova do të jetë shoqëri shumëetnike, naravno da neču nikoga da plašim jer niti mogu niti hoću to da uradim, i nije to moj posao ali ako se gradi vrhunski dokument jedne teritorije koja hoće biti država onda tu obično stoji atribut i kaže da li je to država ili republika ili protektorat ili se spominje da li je nezavisna ili uslovno nezavisna, ili je kraljevina, ovdje ne stoji ništa. Kosovo je geografski pojav.

Potsetiču vas na ružna isnkustva iz Bosne, u famoznom Dejtonskom sporazumu u kome je stvorena fantomska Bosna koja i dan danas muči mukom za svoju ddržavnošću, Bosna i Hercegovina se upravo ovako se spominje kao geografskii pojav, a u svom sastavu ima federaciju i republiku, možete mmisliti kakav je to monstrum, a znažno opominjem na to da budemo oprezni da nam se to ne desi i u slučaju Kosova.

U vezi sa obećanjima koju smo slušali celu godinu dana da će Kosovo imati stolič u Ujedinjenim Nacijama, da će Kosovo imati vanjske posove, da će Kosovo imati Ministarstvo Odbrane, nema toga u Ahtisarijevem dokumentu, nema ni stolice u Ujedinjenim Nacijama, nema ni Ministarstvo Vanjskih posova, nema ni ministarstvo odbrane i mi moramo biti svesni te činjenice i pogledati u uči, naravno da se isazem sa time da dokument otvara vrata da ova neodređenost na jednoj strani otvara vrata da to u buduće bude država, ali takođe otvara vrata da to bude i nešto drugo, neodređenost i nedefinisanost može biti koliko obećavajuća toliko i rizična, se zavisi od budućeg predloga koji ćemo čuti, ja se bojim da će oni biti restriktivni i da će biti na račun državnosti Kosova a u povećanju autonomnosti srba na Kosovu.

Veoma je uznemirujući je član koji kaže ponovo citiram na albansku verziju član 6.1 koji kaže:

TMK-ja do të shpërbëhet, ovo je alarmantno opominjuće, radi se o zaštitim trupama Kosova u kojima ima jedan broj pripadnika svih zajednica i manjinskih zajednica i do koji je svima nama stalo da budem otvoren kao osoba, kao čovek uvijek sam pravio razliku između onih koji se bore rečima i oni koji se puškom borili, u tom TMK ima mnogo koji se puškom borili za ovu zemlju i mi treba ozbilno razmisliti oko tko šta će biti kada se formiraju nove bezbedne snage Kosova koji će imati 2.500 hiljade pripadnika, kojima je dozvoljena da imaju samo lako nauružanje, koji neće imati teško nauružanje sa prerogative armije, dakle bezbednostne snage Kosova neće biti armija da budemo jasni pred ovim narodom. TMK ima 3000 ljudi i ma 2000 rezervista, šta ćemo učiniti sa 2.500 ljudi, šta ćemo činiti sa mnogim familijama onih pripadnika TMK-a za kojima se postoji i Haške poternice ili se sudski gone ili se u napred su osuđeni na to da ne mogu biti članovi budućeg bezbednosnih snaga Kosova.

Ove su zajedničke zabrinutosti koje želim podeliti sa vama na drugoj strani radi se o tome da kao što je moj kolega Murati citirao postoji jedan član koji kaže član 1.6 da su zajednički jezici Kosova su albanski i srpski. Oprostite a to je put državotvornosti srpskog naroda, nema relativizirajućeg dodatke koji kaže da na Kosovu postoji i druge manjinske zajednice, srpska manjinska zajednica se stavlja uzamne sa većinskog zajednicom i verujte mi da ovo otvara put državotvornosti srpskog naroda i njegovo jedankosti za većinskim narodom.

U vezi sa decentralizacijom želim da isteknem to da je decentralizacija kao i najveći dio dokumenta u glavnom posvećen srpskim opštinama, da se da jako visoki stepen autonomije, da daje mogućnost srpskim opštinama da učestvuju ili imajući odlučujući reč u biranju u drugom kuku, komandira policije, da se takođe stvara 6 novih opština sa jako proširenim teritorijama koje su mini države, da se na teritoriji današnje Mitrovice grade dve Mitrovice, severne Djelovi ugovora koji govore o međuopštinskom partnerstvu su vrlo opominjući, nemojte da se u narednim predlogima rešenja za Kosovo ta međuopštinska partnerstva pretvore u etnitet srpski, ili autonomnu oblast, biće živi pa ćemo videti. Takođe pominjujući članovi su oni koji govore o saradnji opština, unutar decentralizovanih opština sa opštinama u Srbiji i vladinim institucijama u Srbiji i mogućnosti da Srbija investira u te opštine, da ulaže u njih i da naravno čak prave zajedničke komisije između republike Srbije i Kosova, naravno Republika Srbija ovde predstavljena kao država, Kosovo je predstavljena..... ono što drugi dio dokumenta je on koji govori o manjinskim zajednicama, drugim zajednicama, bošnjacima, romima, egipćanima, aškanlijama itd. Nažalost oni su u neravnopravnom položaju odnosu na

srpsku zajednicu koje dignete na stepen državotvornosti i uzramne sa većinskom zajednicom. Pogledajte definiciju u opštim odredbama član 3 koji govori o pravama zajednicma i njihovih pripadnika koja kaže jasno: Stanovnici koji pripadaju instoj nacionalnoj ili etničkoj jezičkoj ili vjerskoj grupi koja je tradicionalno prisutna, dakle o drugim zajednicima bošnjacima, romima, ekipčanima itd. Govori se samo kao tradicionalnim zajednicima, nigdje se izrekno se ne spominju osim u onom djelu dokumenta u kojem govore o rezerevisanim mestima u skupštionama, naravno pored dobrih drugih mesta koje su obećavajuća i optimističko za sve nas. Međutim u onom djelu kada se govore o odnosima sa opštinskim vlastima takođe ima jedan deo koji je voma važan i gde kaže da za te zajednice potreban dovoljan udiob, ako se uzme u obzir da su zvanični jezici albanski i srpski prema tome one zajednice po jednim opštinama neće imati dovoljan taj udio, onda se ostavlja jasno da mi imamo pravu na asimilaciju, to su stvari od koji moramo odbraniti, moramo štiti te manjinske zajednice, ako se uzme u obzir da su te manjinske zajednice neko manje neko više, neko od 90 a neko od sada, neko od drage volje a neko iz straha da su prihvatili realnost da podržavaju albansku većinu da javno danom i noću podržavaju albance za njihovu nezavisnost onda je zaista nepošteno, dozvoliti me da citiram jednog novinara koji juče nakon sjednice grupe etniteta za manjinskim zajednicama upitao g. Predsednika g. Predsedniče zar vam nije teško što pored 6 opština sa ogromnom ovlašćenjima nema ni jedne opštine koja se spominje u dokumentu a koja se odnose na bošnjake i rome itd. Bilo je to pitanje bez obzira na odgovora koji g. Surroi pukošao da odgovor ali nije mogao dati jer ga nema. U dokumentu o decentralizaciju ja vas molim mora jasno da se odrede stvari koji se tiču zahteva za opštinu Vitimiricu, Rečane, Dragaš, Rogozu, svugde tamo gde postoji, da ono što je moguće da se ne da ono što nije moguće, ono što bog ostavio prema pravu i da se učini ono što je dobro.

Šta bih predložio: Predložio bih da grupa Uniteta koja značajnim delom izgubila kredibilitet oko ovog pitanja ja iz pozivam u ime ovih zajednica i u ime svih ljudi dobrih ljudi, da obidu zajednice kojima sam uputio pre dva meseca ili više obavezno jedan predstavnik koji se razume u ovo pitanje

Predlažem da se grupa za Unitet proširi i da se u nju uključi najmanje jedan predstavnik, dakle još pet predstavnika, ima ih pet moja formula je 5+5, svi izlaze sa nekim formulama i eto ja izlazim sa nekim formulama. Dakle formula 5+5 neka bude jedan predstavnik Akademija nauka i umetnosti Kosova, jedan od eksperata albanaca i ljudi koji se razumeju u ovo pitanje.

Dalje drugi član da bude obavezno jedan predstavnik iz zajednica Bošnjaka, Roma i Egipćana prema dogovoru koji bi se postigao, treći koji bi svakako bio uključen nakon razgovora sa raznim udruženjima, Udruženjima ratnih veterana, Udruženjima nestalih, zašto da ne i sa Uduženjem „Vetvendosje“ moramo razgovarati sa svim ljudima, jer ćemo imati krizu, nered, probleme, imaćemo provalu nezadovoljstva, imaćemo provalu nezadovoljstva, najmanje sam skeptik, ali predviđam ozboljno da može biti problema. Da se uključi jedan njihov predstavnik, da bude jedan predstavnik iz malih albanskih partija i jedan od strane žena. Dakle sa ženama ćemo da završimo. Hvala vam lepo, Selejam alejkum!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

Shkojmë në pushim 30 minutësh për kafe.

KRYETARI, KOLË BERISHA- I lus deputetë t'i zënë vendet e veta. Radhën e kanë deputetin të flasin. Ftoj deputetin Fatmir Rexhepin ta marrë fjalën

DEPUTETI FATMIR REXHEPI – Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë dhe kolegë të Kabinetit qeveritar. Më lejoni të vlerësoj se plani i propozuar nga presidenti Ahtisari mbi statusin e Kosovës ka karakter historik dhe i hap rrugën në mënyrë të qartë krijimit të shtetit të Kosovës.

Në këtë plan shikëputen të gjitha çështjet jo mirë të definuara sa i përket sovranitetit dhe bartësve të tij në Kosovë dhe kjo i njihet popullit të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare. Z. Ahtisari në propozimin e tij njeh të drejtat dhe sakrificat e qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës për të ndërtuar një shtet të pavarur dhe demokratik. Ky plan vlerësoj se respekton investimin e gjatë të popullit të Kosovës për një të ardhme të qetë, stabile, demokratike, prosperuese, për një Kosovë të pavarur dhe në perspektivë për t'u integruar në familjen e madhe evropiane dhe institucionet Evropatlantike e ndërkombëtare. Po ashtu vlerësoj se pavarësia e Kosovës të cilës i hapet rrugë me këtë plan është garanci për stabilitet të brendshëm dhe stabilitet rajonal. Për rend dhe siguri publike më të mirë, për liri të lëvizjes, siguri të jetës dhe të pronës, siguri dhe integrim të minoriteteve, transformimin e strukturave paralele dhe mundësi për bashkëpunim dhe marrëdhënie të mira me vendet fqinje, në mbikëqyrjen dhe kontrollimin e kufijve, qarkullimin e mallrave dhe luftimin e krimit të organizuar.

Kështu duke shqyrtuar me kujdes planin e propozuar dhe në veçanti aneksin 8 mbi sektorin e sigurisë në Kosovë, Ministria e Punëve të Brendshme në këtë aspekt ka disa sugjerime, komente këto të cilat shpresojmë se do të mund të inkuadrohen në pakon finale të institucioneve kosovare mbi këtë plan. Propozimet tona në aneksin 8 mbi Sektorin e sigurisë kanë të bëjnë me pikat ku përfshihen institucionet dhe mekanizmat për siguri në Kosovë, organizimin, transformimin, tranzicionin siç janë Policia e Kosovës, TMK-ja, për çështjen e kufirit, Shërbimi inteligjent e të tjera.

Unë duke çmuar kohën tuaj komentet dhe rekomandimet e përgatitura këtu do t'i dorëzoj me shkrim, por më lejoni të ritheksoj se Qeveria në këtë fazë ka përmbushur të gjitha standardet të cilat janë kërkuar nga ana e Qeverisë, të drejtuar nga z. Çeku, për të cilat jeni të njoftuar dhe për të cilat i keni vlerësimet më të mira të Këshillit të Sigurimit gjatë gjithë fazave kur është vlerësuar çështja për të cilën flasim. Po ashtu unë vlerësoj se Grupi i Unitetit dhe Qeveria po punojnë pa vonesa për të kryer misionin mandatar në përfundimin e aktiviteteve në pajtim me vullnetin e popullit, vizionin e presidentit të ndjerë Rugova, së bashku me miqtë tanë, me Grupin e Kontaktit dhe Bashkësinë Evropiane që përherë e ka pasur përkrahjen edhe nga qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Maloku, le të përgatitet deputeti Xhavit Bislimi

DEPUTETI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit Z. kryetar, i nderuar, z. kryeministër, Kabinet qeveritar. Më lejoni t'i bashkëngjitëm parafolësve të mij në përkrahje Grupit të Unitetit dhe punës që e kanë bërë gjer më tani, përkrahje për Planin ose marrëveshjen e Ahtisarit mbi të cilën po debatojmë sot. Më lejoni i nderuari kryetar të përqendrohem në aneksin 8, pra në segmentet e sigurisë të parapara me Planin ose marrëveshjen e Ahtisarit.

Kosova nga kjo marrëveshje del me të drejtën e ngritjes së të gjitha kapaciteteve të sigurisë si shtet, duke përfshirë: Policinë e Kosovës, forcën mbrojtëse të Kosovës pra Ushtrinë e Kosovës dhe Shërbimin Inteligjent të Kosovës. Këto kapacitete të sigurisë kanë ingerenca dhe do të kenë ingerenca të plota në tërë territorin e Kosovës, por pa kufizim dhe kjo dua ta theksoj se është shumë e rëndësishme për të funksionuar Kosova si shtet.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të shpreh përkrahje duke mirëpritur angazhimin e forcës së NATO-së në Kosovë dhe mbajtjen e saj edhe për një kohë të gjatë si një prej faktorëve të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Mirëpres monitorimin dhe angazhimin e faktorit ndërkombëtar të BE-së në segmentet e sigurisë në Kosovë, në polici, Shërbimin inteligjentë dhe Ushtrinë e Kosovës për dy arsye. E para, ne jemi ende në ngritje të kapaciteteve të sigurisë apo në zhvillim të kapaciteteve të sigurisë. E marrë shembull Policinë e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, të nderuar deputetë ka bërë hapa të rëndësishëm në ngritjen e infrastrukturës organizative të Ministrisë, në ngritjen dhe aftësimin e Shërbimit Policor të Kosovës, por duhet ende punë për ta arritur nivelin që kjo polici dhe Ministri të jenë me kompetenca të plota në kryerjen e detyrave në tërë territorin e Kosovës dhe një angazhim i faktorit ndërkombëtar dhe pas statusit, në formë të monitorimit dhe të ndihmës së këtij segmenti është më se i nevojshëm.

Të nderuar deputetë, dy mekanizma të rëndësishëm të sigurisë që parashihen me këtë marrëveshje- forca mbrojtëse e Kosovës dhe Shërbimi inteligjentë ende nuk janë në fazën e fillimit të ndërtimit të tyre. Pra, neve na duhet përkrahja e faktorit ndërkombëtar në ngritjen e këtyre mekanizmave.

Grupi i Unitetit, të nderuar deputetë, mendoj se në procesin e ngritjes së këtyre mekanizmave duhet ta parashohë në afate, pra të parashihen dhe të përcaktohen afatet kohore të procesit të ngritjes së këtyre mekanizmave dhe të kalimit të kompetencave të këta mekanizma vendorë.

I nderuar z. kryetar i Kuvendi më lejoni të mirëpres faktin se parashihet se Forca Mbrojtëse e Kosovës të jetë në partneritet për paqe me NATO-në, të jetë pjesë e mekanizmit dhe normalisht Kosova përmes këtij mekanizmit të rëndësishëm të marrë pjesë edhe në misionet ndërkombëtare që i ndërmerr kjo forcë, pra forca e NATO-së jashtë territorit të Kosovës, në mënyrë që Kosova përmes kësaj force të jetë pjesë e proceseve dhe nëpërmes kësaj force pra të marrë pjesë në misionet paqësore ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë, më lejoni që të them edhe disa rezerva në lidhje me afatet dhe me procesin e mëtejshëm të definimit të statusit përfundimtar të Kosovës dhe me faktorët të cilët mund të ndikojnë negativisht në nivelin e sigurisë në Kosovë. Nën një, afati i

këtij procesi ,pra deri në definim dhe deri te Rezoluta e Këshillit të Sigurimit, nuk duhet të zgjatet.Zgjatja e këtij procesit mund të ndikojë negativisht në nivelin e sigurisë në Kosovë dhe këtë mendoj duhet që Grupi i Unitetit ta shfaqë edhe në Vjenë. Nën dy, duhet të merremi seriozisht me Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Fjalja: **shpërbërje pas një viti**, ose nuk është përkthyer mirë, përndryshe nuk mund të pranohet si e tillë. Ne duhet të punojmë bashkërisht si institucione të Kosovës në transformimin e kësaj strukture, ne duhet të merremi seriozisht me secilin pjesëtar të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës. Ftoj Qeverinë e Kosovës që sa më parë të procedojë në Kuvend Ligjin për pensionim të parakohshëm të pjesëtarëve të TMK-së dhe normalisht, bashkërisht edhe unë si kryetar i Komisionit Parlamentar për Siguri, Komisioni për Siguri i Kuvendit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria të punojmë dhe të angazhohemi për secilin pjesëtar të Trupave Mbrojtëse të Kosovës që ta gjejë vendin e vet në këtë proces. Më lejoni që nga kjo foltore t'i ftoj të gjithë pjesëtarët e TMK-së të jenë të qetë dhe të sigurt se Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria do të merren për secilin rast veç e veç dhe normalisht të jenë në nivel të përgjegjësisë dhe bashkëpunësues në procesin e transformimit të kësaj strukture në Forcë Mbrojtëse të Kosovës.

Më lejoni të them se edhe procesi i krijimit të dy komunave në Mitrovicë duhet të jetë qartë i definuar dhe këtë Grupi i Unitetit duhet ta ketë parasysh. Duke i mbështetur edhe një herë, të nderuar deputetë ,Grupin e Unitetit dhe marrëveshjen e Ahtisarit , me kaq po e përfundoj. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, përgatitet deputeti Bajram Kosumi

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Ju faleminderit z. kryetar, zotërinjë deputetë, qeveritarë dhe ndërkombëtarë të gjithë sa jeni të pranishëm këtu.

Unë z. kryetar e kërkoja fjalën që në fillim të seancës, sepse kisha dy propozime, mendoj unë konstruktive. Propozimi i parë ishte që para se t'ua jepni fjalën atyre ose ta mbanin fjalën e tyre, anëtarët e Grupit të Unitetit, shefat e grupeve , të flisnin deputetët, sepse tash pas fjalës së tyre, deputetët ndihen pak sa të ndrydhur, të shtrënguar, sepse del sikur edhe dikush është kundër kryetarit, dikush kundër anëtarit, dikush kundër shefit, dikush e tjera e tjera, kështu që në një mënyrë bëhet njëfarë ndrydhje e demokracisë, njëfarë presioni demokratik që nuk është mirë të bëhet herave të tjera.

Këta minuta mos i llogarit se janë për hyrje. Propozimi i dytë kishte të bënte me Rezolutën për kufirin, që e bëra edhe dje. z. Kryetar. Ky Kuvend ka miratuar një rezolutë që po ta lexoni do të bindeni se duhet edhe një here të hyjë në rend dite ose të rivotohet ose të shfuqizohet dhe ky Kuvend ta mbajë përgjegjësinë e tij. Tash po merremi me dokumentin, me dëshirën më të vogël për me u marrë me te, por meqë tani e kemi si dokument edhe të karakterit ndërkombëtar, mendoj se secili deputet është mirë t'i thotë mendimet e tij rreth këtij dokumenti, sepse ka çështje vërtetë që nuk janë krejt të qarta, nuk janë krejt të saktësuar dhe mund të lënë shteg edhe për interpretime të ndryshme edhe për keqkuptime në të ardhmen.

E para, Kosova multietnike dhe këtu unë mendoj se e kanë burimin ato pikat që unë mendoj se nuk janë të pranueshme për Kosovën. Në pikën e parë të këtij dokumenti thuhet Kosova do të jetë shoqëri multietnike. Unë nuk e kuptoj se si do të bëhet multietnike Kosova e cila përbëhet 90% nga populli shqiptar, pos nëse është menduar

siç ka ndodhur shumë herë gjatë historisë sonë që shqiptarët të shpërngulen, sepse procesi i shpërnguljes së shqiptarëve po vazhdon edhe sot dhe të rikthehen ish-kolonët ose kolonët e rinj në Kosovë. Kjo mund të bëhet kështu, ndryshe nuk e shoh. Unë konsideroj se Kosova historikisht kurrë nuk ka pasur problem me pakicën serbe as me një pakicë tjetër, siç u mundua dikush ta zhvendoste problemin te pakica serbe dhe sjellja jonë pas luftës ndaj tyre. Të jeni të sigurt që vështirësitë që ka pasur pakica serbe sidomos pas luftës kanë qenë përgjegjësitë direkte e Beogradit, sepse ishte Beogradi ai që i instrumentalizoi dhe e shpërdoroi këtë pakicë për qëllimet e tij shoviniste gjakatare në Kosovë dhe sigurisht që kjo pakicë është ndier keq mbas lufte dhe do të ndihet edhe më tej nëse vazhdon Beogradi të ndërhyjë në punët e Kosovës. siç po ndërhyt. Nuk kam dhe sigurisht asnjëri prej juve nuk ka askush diçka kundër të drejtave edhe të pakicave tjera, sepse edhe në dokument është thënë që ne do të pranojmë të gjitha dokumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e pakicave dhe kjo është punë e kryer, sepse e thashë edhe më herët se nuk kemi pasur problem me ta. problemi është te krijimi i territoreve serbe në Kosovë dhe me këtë, unë mendoj që edhe ky dokument hap rrugë që Kosova kurrë më të mos jetë pjesë e Serbisë, por Serbia në Kosovë mbetet edhe më tej, gjithmonë sipas këtij dokumenti. Krijimi i këtyre territoreve serbe në Kosovë për mua është i papranueshëm edhe në kuptimin që bie ndesh me parimet dhe me filozofitë e Bashkimit Evropian për integrimin e popujve. Në këtë dokument, me këtë ndarje krijohen mure midis shumicës shqiptare dhe pakicës serbe. Pakicat e tjera pothuajse nuk janë përfillur fare.

Një problem tjetër janë edhe kishat. Në dokument thuhet edhe në gjuhën shqipe edhe në gjuhën angleze republika e kishës ortodokse serbe në Kosovë, se çfarë do të na dalë nga kjo republikë a do të korrigjohet a çka do të bëhet nuk e di, ju e keni besoj të gjithë dokumentin.

Tjetër: pronat e kishës, unë mendoj se është mirë të saktësohet në dokument për të cilat prona është fjala, të cilës periudhë, sepse nëse hyjmë te pronat ne kemi këtu një bashkësi shqiptare që e quajmë edhe sot e kësaj dite muhaxhirë pas 100 vjetësh dhe që kanë pronat e tyre dhe i mbajnë edhe mbiemrat e fshatrave të tyre deri në Toplicë, Leskovc e fshatrave të Nishit, prandaj është mirë të saktësohet të mos hapen konflikte të reja të na kthejnë mbrapa atje se kush e di se çka del. Nuk është marrë parasysh ose nuk është treguar asnjë respekt ndaj kishës ta zëmë katolike shqiptare. Kisha katolike shqiptare në Letnicë është futur nën juridiksionin e komunës serbe të Verbovcit ose të Klllokotit, gjë që do të jetë e papranueshme, por shqiptarët e konfeksionit krishter-katolik në komunën e Vitisë.

Problem tjetër, ose çështje që nuk i shkon për shtat popullit shqiptar është edhe çështja e refugjatëve dhe i atyre që llogariten banorë të Kosovës dhe vitit kur është saktësuar kjo punë. Ne me këtë dokument dhe në të gjitha propozimet tona nuk do të harrojmë ose nuk është dashur ta harrojë ky grup që na ka përfaqësuar jo fortë denjësisht që nga '81 të paktën nga '81 janë diku 1 milion shqiptarë të shpërngulur nga Kosova dhe në dokumentet e tyre kudo që janë ju shkruan refugjatë dhe në qoftë se ne nuk i konsiderojmë të tillë dhe në qoftë se këto institucione nuk bëjnë një përpjekje të vogël, nuk ndaj fonde të paktën për aq sa po tregohen të përkushtuar për pakicën serbe për kthimin e të gjithë atyre që dëshirojnë të kthehen, sepse janë shpërngulur nga represioni dhe dhuna serbe në Kosovë dhe këtë e dinë e gjithë bota, Nuk kemi nevojë me fshehë ne shqiptarët dhe t'i quajmë tash diasporë punë e mbyllur, ju koftë për hair le të rrinë

rrugëve të botës, dyerve e strehëve se ka mija shqiptarë që janë edhe pa asnjë dokument, pa asnjë të drejtë të qëndrimit në vendet ku janë dhe bëjnë jetë qeni po e them me keqardhje për të gjithë ata që janë në këtë situatë jashtë vendit tonë, në botën e huaj. Ky dokument nuk ka paraparë ose nuk është marrë fare me çështjen e shkatërrimeve që ka bërë Serbia jo vetëm gjatë kësaj lufte, bile na ka qitë borxh mbi një miliardë duhet të paguaj Kosova që i paska borxhe Serbisë.

Çështje tjetër është TMK-ja. TMK-ja siç e dimë të gjithë është krijuar, është ndërtuar, është strukturuar me një marrëveshje ndërkombëtare, në mes nesh dhe ndërkombëtarëve. Nëse edhe kjo nuk pranohet dhe janë shpenzuar miliona euro për të, unë nuk e di se çfarë do të pranohet në Kosovë, e cila do të jetë ajo forcë e sigurisë që do të bëhet nga hiqi dhe kujt do t'i shërbejë ajo forcë e sigurisë nga hiqi. Po e shpërbën, po e shkatërron një forcë që e ke ndërtuar me shumë mund, veçmas kryeministri që është këtu dhe të gjithë ata që janë atje dhe po krijon diçka nga hiqi, pse? Kujt i duhet? Ku na qon kjo logjikë apo nga pesë vitesh do të bëhet një bilanc edhe do të thuhet kjo forcë e re e sigurisë në Kosovë e përmbushi misionin e vet – mirë u pafshim.

Prania civile ndërkombëtare nga kryetari i Kosovës është thënë shumë herë dhe nga Grupi i Unitetit një prani e lehtë, unë nuk e di çfarë pranie më e rëndë mund të ketë se kjo prani. Ma thoni një mbret në botë, ma thoni një president në botë, që e ka pushtetin që e ka përfaqësuesi civil ndërkombëtar. Ma gjeni një rast, pos diktaturat e Kilit e Pinoçetit çka kanë qenë përpara. Ky do jetë defakto e dehure, siç thuhet edhe në dokument, fjala e fundit e pushtetit në Kosovë, do jetë sulltani i Kosovës në daç cari, ndaç krali çka të doni thoni edhe duke pasur parasysh gjithë këto kompromise, lëshime që i ka bërë edhe Grupi Negociator në bisedimet që janë mbajtur, unë propozoj të zëvendësohet ky grup i burrave me një grup të grave, sepse vërtetet besoj se gruaja historikisht ka qenë më e lidhur me tokën dhe do ta mbrojë më me dinjitet dhe krejt në fund të shqyrtohet edhe opsioni për një referendum të mundshëm që ky dokument, meqë nuk ka kaluar nëpër Kuvend të kalojë të paktën nëpërmjet një referendumi. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi

DEPUTETI BAJRAM KOSUMI – Ju faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit, i nderuari kryetari i Kosovës, kryeministër dhe z. Surroi anëtar i grupit të Delegacionit të Kosovës.

Më lejoni fillimisht t'i shpreh bindjet e mia për përmbajtjen e dokumentit të z. Ahtisari. Dokumenti është një bazë e mirë fillestare për ndërtimin e shtetit të Kosovës. Kosova ka të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë si të brendshme ashtu edhe të jashtme të një shteti. Kosova e ka territorin e vet të definuar qartë dhe unik, ka kufijtë të njohur ndërkombëtar, ka kontrollin mbi këtë territor dhe kontrollin mbi hapësirën ajrore të vetën. Kosova ka simbolet e veta shtetërore, ka pushtet të plotë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, ka ushtrinë e vet dhe mekanizmat e tjerë të sigurisë së brendshme dhe të jashtme, ka Kushtetutën dhe sistemin e vet politik, ka të drejtën e krijimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka të drejtën e përdorimit të valutës së vet dhe të politikës së vet ekonomike. Në këtë formë qysh e kemi sot në dorë, dokumenti edhe pse nuk e përmban fjalën pavarësi i përshkruan të drejtat dhe kompetencat e një shteti të pavarur

dhe sovran. Ky shtet qysh po e konceptojmë në bazë të këtij dokumenti nuk ka kushtëzime, por ka mbikëqyrje, mbikëqyrje për një periudhë të caktuar, por si të tillë, me qenë se dokumenti e krijon bazën për shtetin e ardhshëm të Kosovës ne e pranojmë kështu si është, por ky dokument është dokument i kompromisit. Këtë e ka thënë z. Ahtisari dhe si i tillë ka ofruar zgjidhje të kompromisit, dhe me të drejtë qytetarët e Kosovës, por edhe ne politikanët i shikojmë me shqetësim disa prej paragrafëve dhe zgjidhjeve që janë ofruar në këtë dokument. Këto dyshime tona te paragrafët e dokumentit shkojnë në tri drejtime: drejtimi i parë apo dyshimi i parë ka të bëjë me funksionalitetin e pushtetit në shtetin e ardhshëm të Kosovës dhe këtu po i përmend disa prej fakteve: krijimi apo zhvillimi i komunave të reja vetëm në bazë të kriterit etnik e vështirëson funksionalitetin e pushtetit në shtetin e ardhshëm të Kosovës.

Krijimi i komunave apo zgjerimi i territorit mbi kriteret etnike do të vazhdoj të prodhoj të njëjtat pasoja që ka krijuar deri me sot enklavizimi i serbëve në territoret ekzistuese. Ne do të ballafaqohemi me të njëjtat pasoja edhe në vitet e ardhshme dhe me të njëjtat kritika nga bashkësia ndërkombëtare për këtë çështje. Unë edhe sot, dy vite më vonë, shpreh me të vërtetë keqardhje që para dy viteve nuk ka pasur një mirëkuptim të gjerë për projektin e Qeverisë së Kosovës për themelimin e komunave të reja serbe me shumicë serbe, por komunave multietnike psh. Graçanica bashkë me Ajvalinë të jetë një komunë ku mund të jetë përbërja 60 me 40 ose 70 me 30 me të vërtetë derivati i këtij moskuptimi politik para dy viteve sot ka sjell te formimi i komunave mbi një territor etnik që do të ketë pasoja.

Çështja e datë, lidhja e komunave me mekanizma të ndryshëm dhe me institucionet e Serbisë do të ketë pasoja në të ardhmen jo për shkak vetë faktit sepse marrin ndihmë donacioneve, komunat mund të marrin donacione prej shumë kujt jashtë, por për shkak se politika e Serbisë ndaj Kosovës është e mirënjohur dhe gjatë shtatë viteve të kaluara politika serbe ka ndikuar negativisht proceset në Kosovë dhe serbët e Kosovës, gjithmonë i ka instrumentalizuar dhe i ka përdorur për qëllime të veta politike. Lejimi i këtyre lidhjeve jashtë kontrollit më të rreptë të Qeverisë do të krijojë bazë të mirë që edhe në të ardhmen Beogradi zyrtar të manipulojë dhe t'i përdorë për qëllime të veta duke i shkaktuar dëm procesit të gjithmbarshëm në Kosovë. Dyshimi i dytë ka të bëjë me Mitrovicën. Në dokument askund nuk thuhet ose nuk është paraparë me asnjë fjali për shpërbërjen apo ndalimin e veprimit të institucioneve dhe mekanizmave tjerë të ashtuquajtur institucional të financuar nga Serbia në shtetin e Kosovës. Duhet të qëndroj kjo nëse tash nuk flasim më hapur për Mitrovicën e kjo si duket as në dokument nuk flitet hapur, as në diskursin e politikanëve tonë të Kosovës po as ndërkombëtarët nuk flitet hapur për Mitrovicën gjë që mendoj është një bllokim i procesit dhe një gabim. Duhet të hapet ventili për këtë çështje sepse problemi i parë serioz me të cilin do të ballafaqohet shteti i Kosovës në momentin kur do të krijohet, nëse sot krijohet, të nesërmen ka me qenë Mitrovica. Ka gjasa se Mitrovica në praktikë edhe nëse marrin ndonjë veprim radikal liderët serb atje edhe nëse Këshilli i sigurimit ose Grupi i kontaktit mund ta anulojë një vendim të tillë në praktikë të vazhdoj për afërsisht kështu siç është sot. Kjo do të thotë të jetë njëfarë territori jashtë kontrollit të gjithkujt, nuk e kontrollon Qeveria e Kosovës plotësisht, nuk e kontrollon qeverisa e Serbisë, është një territor jashtë ligjit. Mund të themi lehtë se janë serbët atje, por barra do t'i bie Kosovës. Aty mund të krijohet një oazë e krimi, një oazë e qysh deri diku është edhe sot në pjesën veriore të Mitrovicës, mund të ketë një oazë e krimi, e korrupsionit, e trafikëve të ndryshme me

njerëz etj. dhe përgjegjësinë për këtë nuk e bartë Mitrovica as qeveria e Serbisë po Qeveria e Kosovës dhe Kosova do të jetë gjithmonë në tabelat të sulmeve nga bashkësia ndërkombëtare pse po lejon në territorin e vet një lulëzim të tillë të krimin me efekte ndërkombëtare.

Dyshimi i tretë lidhet me zonat mbrojtëse rreth monumenteve kulturore dhe fetare. Nuk do të flas shumë për këtë se u fol tepër, por vetëm dëshiroj ta them se interesi për të mbrojtur objektet kulturore dhe fetare gati se është harruar. Ky dokument dhe është shndërruar në një luftë për territor rreth objekteve fetare, nëse e ndien vetën më rahat personeli i kishave në një territor, në një zonë të mbrojtur dakord e pranojmë edhe pse në parim mund të mos jetë kjo edhe më e qëlluara, por ndarja e 600 hektarëve rreth manastirit të Deçanit nuk është më interes për siguri, është interes për territore. Sa i përket prezencës ndërkombëtare më lejoni të shpreh mirëpritjen dhe mirëkuptimin për prezencën e Bashkimit Evropian në proceset e ardhshme në Kosovë. Kosova ka nevojë në disa segmente të veta siç janë drejtësia, policia, të drejtat e komuniteteve pakicë ose funksionaliteti i demokracisë, të ketë përkrahje edhe mbikëqyrje edhe një ndihmesë në proceset e ardhshme, por është pak për t'u habitur fakti se nuk përmendet një rol i ri i Bashkimit Evropian në përgatitjen e Kosovës në aspektin e kapaciteteve njerëzore edhe në aspektin e kapaciteteve ekonomike për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Gjatë tërë kohës është folur për këtë rol të Bashkimit Evropian. Mund të thuhet se e bëjmë më vonë, por do të ishte shumë me rëndësi në një dokument të tillë ndërkombëtar të figurojë përgjegjësia e Bashkimit Evropian që të përgatisë Kosovën për disa vite për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Është i mirëseardhur roli i NATOS në Kosovë dhe misioni i NATOS në krijimin e sigurisë së jashtme të Kosovës, por një çështje që krijon pakënaqësi është misioni i përfaqësuesit civil ndërkombëtar. Besoj plotësisht se Kosova nuk e ka merituar një zgjidhje si të Bosnjës. Edhe arkitektët e Bosnjës sot janë tepër të pakënaqur me veprën e tyre, ndoshta rreth 50% të projektit për Bosnje llogaritet edhe sot i dështuar, por ende nuk ka vendosmëri për t'i tejkalluar këto zgjidhje kushtetuese në Bosnje që janë bërë që nga DEJTONI e këndej. Kosova nuk e ka merituar një fat të tillë me pasur një përfaqësues civil ndërkombëtar që ka të njëjtat kompetenca çfarë i ka përfaqësuesi civil ndërkombëtar në Bosnje. Në Kosovë ka progres shumë të madh gjatë kësaj periudhe. Unë nuk di a është diskutuar kjo çështje me Delegacionin e Kosovës, nuk di a ka pasur Delegacioni i Kosovës rol në këtë çështje, por e di se dy vjet më herët në raportin e ambasadorit Aide të dërguarit të posaçëm të sekretarit gjeneral për vlerësimin, për procesin e përgjithshëm në Kosovë disa politikanë të Kosovës çfarë roli kanë pasur. Ambasadori Aide ka qenë i hutuar, madje ka qenë shumë i shqetësuar që disa politikanë në Kosovë kanë kërkuar të fusë vlerësime negative për procesin në Kosovë.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Nëse vazhdojmë kështu mbesim një javë, ju vazhdoj edhe juve, por le të mbetet këshillë për tjera herë. Urdhëroni. I vazhdohet edhe një minutë

VAZHDIM – BAJRAM KOSUMI – Ju faleminderit, unë po i kaloj çështjet që kisha, unë vetëm të ndalem te vërejtjet. Besoj se Delegacioni i Kosovës duhet t'i evidentojë të gjitha vërejtjet që ka në dokument dhe t'ia dorëzojë në formë të shkruar z. Ahtisarit, por të mos kërkojë të humbim kohë në këto, të ndajnë një, dy ose tri çështjet themelore që të futen në dokument. Një prej këtyre çështjeve propozoj të jetë që 120 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje të pushojnë së vepruari të gjithë mekanizmat dhe

institucionet që nuk janë në pajtim me këtë marrëveshje dhe nuk janë në pajtim me Ligjin e Kosovës.

Dhe propozim i dytë është: dy vjet pas implementimit të kësaj marrëveshjeje, Grupi Drejtues Ndërkombëtar, në bashkëpunim me përfaqësuesin civil ndërkombëtar dhe Qeverinë e Kosovës. t'i rishikojnë edhe një herë provizionet e kësaj, e këtij dokumenti të cilat në praktikë nuk kanë funksionuar mirë, ndërsa për Qeverinë e Kosovës dhe për Grupin Negociator më lejoni të jap këtë propozim: Qeveria e Kosovës ,bashkë me Delegacionin e Kosovës ta bëjnë një plan të veprimit dhjetëmuor me të gjitha veprimet e mundshme që nga hartimi i Kushtetutës së Kosovës, dokumentet e reja civile deri tek hapja e ambasadave të Kosovës dhe të bëjë një plan që të veprojmë në këta dhjetë muaj, që është koha më e artë për Kosovën, tash që të veprohet në këtë drejtim.

KRYETARI, KOLË BERISHA- Fjalën e ka Nekibe Kelmendi, përgatitet deputeti Sabri Hamiti

Ju lus që ta keni parasysh kohën të gjithë deputetët.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - Mos ma llogarit kohën e përshëndetjes. I nderuari z. president, i nderuari z. kryeparlamentar dhe Kryesi e punës, i nderuari z. kryeministër, Grupi i Unitetit dhe ju deputetë e mysafirë që gjendeni në këtë sallë.

Tashmë e kemi në duart tona "Pakon" e z. Ahtisari, të cilën kemi pasë rastin ta studiojmë dhe të njihemi detajisht me përmbajtjen e saj. Plani që përmban pakoja në fjalë është një fillim i mbarë i procesit të pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës dhe është rezultat i diskutimeve të Vjenës, te të cilat pala kosovare ka treguar kooperativitet të plotë dhe sens të veçantë demokratik, si dhe sens për respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në përgjithësi dhe të të drejtave të komuniteteve pakicë në veçanti dhe është meritë e Grupit të Unitetit dhe e z. Ahtisari që dokumenti në këtë aspekt është shumë pozitiv sa u përket të drejtave të komuniteteve pakicë, sidomos të pakicës serbe, gjë që nuk mund të thuhet për zyrtarët e Beogradit, të cilët pothuajse kanë qenë krejtësisht indiferentë për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit serb në Kosovë. Për më tepër, pala kosovare ka shkuar edhe një hap më larg me aplikimin e diskriminimit pozitiv, krahasuar me dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve. Me këtë rast duhet vlerësuar lart edhe qëndrimin dinjitoz dhe gjithë gatishmërinë e popullatës shumicë në Kosovë për akceptimin e diskriminimit pozitiv në favor të komuniteteve pakicë, sidomos për komunitetin serb, përkundër sakrificave të mëdha që kjo popullatë ka dhënë për pavarësinë e Kosovës, andaj dua të besoj se bashkësia ndërkombëtare do t'i vlerësojë drejt dhe lart të gjitha këto rrethana dhe pozicionin e palës kosovare dhe do ta respektojë vullnetin politik të popullit të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur e sovran.

Përndryshe, dokumenti në fjalë ia hap derën pavarësimit, sovranitetit, identitetit dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, ndonëse në pjesën politike të tij nuk përmendet fare fjala pavarësi. Por, nga konteksti dhe përmbajtja e këtij dokumenti, rezulton se Kosovës i njihet e drejta për t'u anëtarësuar në OKB dhe shumë të drejta të tjera për të cilat u diskutua këtu dhe nuk dua ta humb kohën time. Megjithatë kam disa komente në pjesën politike dhe disa anekse të dokumentit të cilat do të doja t'i theksoja në

diskutimin tim. Krejt kjo me qëllim më të mirë që dokumenti vërtet të jetë i pranishëm për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Shkoj radhazi:

Vërejtja e parë

Neni 5 , te personat e zhdukur

Lidhur me këtë çështje, që është e përmbledhur në vetëm dy pika, kam vërejtje serioze. Mendoj se për personat e zhdukur duhet të përdoret norma e plotë juridike dhe të sanksionohet në mënyrë imperative që Kosova dhe Republika e Serbisë në pajtim me normat dhe me standardet vendore dhe ndërkombëtare detyrimisht t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të përcaktuar dhe ofruar informata, sa u përket identitetit, vendndodhjes dhe fakteve të personave të zhdukur në bashkëpunim të plotë me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe me partnerët tjerë relevantë ndërkombëtarë, duke caktuar edhe afate kohore për heqjen e velës së fshehjes së vendndodhjes së vendndodhjeve të të zhdukurve qofshin ata të varrosur në varrezat masive, deri më tash të fshehura apo të karbonizuara në furrat e minierave të ndryshme siç po tregojnë për këto vetë organizatat humanitare në Serbi.

Vërejtja e dytë

Neni 8, çështjet ekonomike dhe pronësore. Po kështu edhe lidhur me çështjen e borxhit kam vërejtje. Këtu po i referohem vetëm borxhit. Kjo për faktin se me nenin 8.2 të pjesës politike të statusit është paraparë se të gjitha borxhet e Republikës së Serbisë. të cilat i ngarkohen Kosovës si rezultat i procesit të alokimit të borxheve ,siç parashihet me aneksin 6 të kësaj marrëveshjeje , do të konsiderohen detyrime financiare të Kosovës. Kjo nuk më duket zgjidhje e mirë, duke pasur parasysh faktin se ndërmarrjet publike dhe shoqërore të Kosovës që nga viti '90 deri në qershor të vitit '99 i ka menaxhuar Serbia dhe të gjitha **kreditë debi** nuk kanë pasur lidhje me popullatën shumicë të Kosovës, kurse për institucionet të mos flasim se ato nuk kanë ekzistuar fare dhe nuk dihet se si janë disponuar ato mjete apo ato borxhe të krijuara, të cilat ndoshta edhe janë përdorë për financimin e 45.000 policëve për përdorimin e dhunës e torturës dhe në dy vitet e fundit edhe për financimin e luftës kundër popullatës shumicë në Kosovë, prandaj çështja e borxheve do të duhej të mbetet pjesë e suksesionit.

Sa i përket pikës 8.3 prona e luajtshme dhe e paluajtshme e RF të Jugosllavisë apo e Republikës së Serbisë. e cila ndodhet brenda territorit të Kosovës në momentin e marrëveshjes do t' i kalohet në pronësi Kosovës. Nuk ka çka tejkalohet kur atë e ka tjetërsuar me Ligjin mbi kushtet dhe procedurat e shndërrimit të pronës shoqërore në forma të tjera të pronës (Gazeta zyrtare e Serbisë nr. 48/91) prej të cilave 51% e kapitalit është derdhur në Fondin për zhvillimin e Serbisë. Për rrjedhojë Kosova nuk duhet t'i përmbushë as borxhet e jashtme të Serbisë për Kosovën meqë ajo jo vetëm që nuk ka ndërtuar apo investuar asgjë në Kosovë, por përkundrazi i ka shkatërruar ekonominë dhe bazën ekonomike të Kosovës duke plaçkitur tërë pasurinë e saj.

Mendoj se kërkesat lidhur me pronën e paluajtshme, lidhur me kërkesat për të drejtën e pronës së paluajtshme private, duhet t'i zgjidhin gjykatat kompetente, duke përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale e jo Agjencioni Kosovar i Pronave, i përbërë ekskluzivisht nga ekspertët ndërkombëtarë, meqë me sa di edhe Grupi i Kontaktit është pajtuar që tri çështje të monitorohen nga ndërkombëtarët: siguria, drejtësia dhe doganat, kurse prona e paluajtshme private nuk bie në këto kategori.

Vërejtja e tretë

Neni 6, Gjykata Kushtetuese dhe sistemi i drejtësisë, aneksi 1. Gjykata Kushtetuese duhet të përbëhet prej 9 gjyqtarëve, prej të cilëve 6 me propozim të Kuvendit të Kosovës i zgjedh kryetari i Kosovës, dy gjyqtarë zgjidhen nga radhët e komuniteteve me pëlqimin e shumicës së deputetëve nga radhët e deputetëve që kanë vendet e garantuara në Kuvend, kurse një gjyqtar ndërkombëtar do të emërohet nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut me konsultimin e përfaqësuesit civil ndërkombëtar në Kosovë. Në vend të dhjetë apo më shumë deputetëve, neni 6.2 aneksi 1, prapë të Kuvendit të Kosovës, më e pranueshme do të ishte të parashihen 20 deputetë, të cilët mes tjerash do të kenë të drejtën që ta kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji apo vendimi të miratuar nga Kuvendi i Kosovës para Gjykatës Kushtetuese si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në aspektin procedural. Pra fjala në vend të dhjetëve do të duhet të shtohet në njëzetë.

Para parashtrimin të një çështjeje nga kjo që thamë më sipër, për të cilën është kompetente Gjykata Kushtetuese duhen të jenë të konsumuara të gjitha procedurat e rregullta administrative në shkallë të dytë në Ministrinë për Pushtetin Lokal apo për ministritë e tjera gjegjëse e mëpastaj t'i drejtohen deputetët në fjalë Gjykatës Kushtetuese.

Vërejtja e katërt

Neni 14, regjistrimi i popullsisë, aneksi 3. Neni 14, regjistrimi i popullsisë do të duhej të bëhet gjatë këtij viti dhe atë para zgjedhjeve lokale dhe atyre të përgjithshme. Regjistrimi i popullsisë do të kryhet nga Enti i Statistikës në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe do t'i nënshtrohet vëzhgimit ndërkombëtar, njësoj do të veprohet edhe me regjistrimin e refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në Republikën e Serbisë apo në shtetet e tjera fqinje.

Vërejtja e pestë

Neni 1, struktura e gjykatës, aneksi 4

Me ligj duhet të rregullohet organizimi i gjykatave e jo nga ana e Këshillit gjyqësor të Kosovës, që të mos na ndodhë, që në çdo 5-6 kilometra të kemi gjykata komunale, varësisht nga themelimi i komunave të reja, sepse kështu rrezikohet se gjyqtarët të bien nën ndikimin e komunave. Mendoj se në sistemin gjyqësor nuk mund të aplikohet decentralizimi, parimi i decentralizimit sikur te pushteti lokal, gjë që në dokument ka

tendenca të tilla. Kjo aq më parë meqë komunat e reja kanë distancë minimale nga gjykatat **ekzistuese** themelore apo komunale si do të quhen me ligj, **kështu mendoj se ekziston...**

KRYETARI, KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, të përgatitet deputeti Gani Koci.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit, z. kryetar i Kosovës, z. kryeministër, z. Surroi - Ne këtu kemi pritur që ashtu si e keni emrin Grupi i Unitetit që ja keni vënë vetes dhe është bërë popullor, këtu të paraqiteni si Grupi i Unitetit. Nga fjalimet tuaja unë kam parë shumë nuanca që mund t'i shohë një njeri i zakonshëm, por edhe një deputet i Kuvendit të Kosovës. Mendoj që në këtë rast dhe në këtë moment ka mundur të jetë shumë më i strukturuar mendimi i Grupit të Unitetit dhe unë pres që mbas kësaj seance, do të jetë vërtet i strukturuar, sidomos kur të paraqitemi me kërkesa para instancave vendimmarrëse ndërkombëtare.

Kjo është vërejtja numër një dhe vërejtja numër dy, prapë për këtë ekip të unitetit kam frikë se harrojnë shpejt dhe nuk është dashur të harrojnë qaq shpejt që është një strukturë e patentuar dhe e sjellë para Parlamentit nga presidenti Ibrahim Rugova. Më kanë çuditur të gjithë, prej të parit e tek i fundit që kanë harruar t'ia përmendin emrin, e pra nëse bisedohet për pavarësinë e Kosovës, promovues i kësaj ideje prijësi një lëvizje për këtë dhe njeriu që ka bërë përpjekje që këtë kërkesë ta bëjë legale dhe legjitime i pari në mesin tonë është Ibrahim Rugova.

(aplauzë)

Unë vërejtjet e mia do t'i nis me një venerim që prapë më ka çuditë shumë që askush që e ka hetuar e është shumë **indikative .. themelore**. Në dokumentin e Ahtisarit që në variantin shqip i ka 64 faqe asnjëherë në asnjë vend kurrë nuk është shkruar emri shqiptar. Keni kujdes kjo është shumë indikative. Unë i përgëzoj minoritetet që thonë joserbe, që e kanë hetuar dhe ata janë përmendur të gjithë, veç një herë, shqiptarët kurrë në asnjë vend në 64 faqe nuk janë përmend, ndërsa serbët janë përmendur aq sa ka pasur nevojë ka dhjetë herë në faqe. Kjo është shumë me rëndësi të thuhet, sepse në kuptimin elementar kemi të bëjmë me një dokument i cili i referohet një vendi si Kosova që pretendon të bëhet shtet, i cili e dimë të gjithë se përbëhet 90% me shqiptarë. Kjo është vërejtja hyrëse. E dyta është që ka të bëjë me çfarë kërkojmë ne dhe çfarë presim. Normalisht që Grupi i Unitetit që e kemi mandatuar që të punojë në bazë të një rezolute të Kuvendit për pavarësinë e Kosovës, ka të drejtë të kërkojë që në rekomandimin final të dokumentit të Ahtisarit të artikulohet që Kosova është shtet i pavarur, (**presë**) pastaj mund të shkruhet shoqëri multietnike. Shtet dhe shoqëri në bisedimet për problemet konstitucionale janë dy nocione që mund të lidhen, por janë larg njëri-tjetrit por nuk kanë lidhje. Pra, këtu unë e përkrah kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së z. Krasniqi dhe unë them që pika 1.1 e dokumentit të Ahtisarit do të duhej të ishte formuluar kështu, dikush mund të thotë: po ne nuk mund t'i rekomandojmë Ahtisarit. Mundemi, mundemi, sepse ne kemi krijuar një ekip i cili ka punuar me Ahtisarin, mundemi sepse u tha këtu edhe nga kryetari Sejdiu që ky nuk është dokument inicial i qartë, por është parafinal- i qartë. Nëse është

parafinal dhe nëse po planifikohen tubime që quhen jonegociuese, por konsultative, s'ka lidhje termi, është relativizues nuk thotë gjë, atëherë ky ekip e ka të drejtën të bisedojë për elemente të cilat mendon që nuk i kënaqin nevojat e vullnetit politik të shqiptarëve. Këtu, unë nuk dua të radhis shumë probleme, se unë e di, është thënë edhe këtu edhe u përsërit në forma të ndryshme se ne nuk kemi fuqi të madhe për ndërrim të dokumentit, por ne e kemi fuqinë përmes Grupit të Unitetit të ndikojmë, bile në pikat ku ky Grup ka qenë bashkëkrijues Z. Surroi e pranoi, tha që te minoritetet jemi bashkëpronar nëse e kam dëgjuar mirë. E pra, nëse te minoritetet jemi bashkëpronarë, te decentralizimi jemi bashkëpronarë me ofertat e tyre, nuk di a jemi të pajtimit të plotë, flas për Ekipin jo për mua dhe në dy pikat e tjera tek ekonomia dhe te problemet e kulturës, atëherë bile në katër pikat ku është diskutuar, Grupi i Unitetit e mban të drejtën që të diskutojë deri në pikën e fundit për problemet që nuk kanë gjetur zgjidhje adekuate, nëse jo, për praninë ndërkombëtare që nuk i ka pyetur kush që e kemi shkruar letrën që na kemi qejf ta kemi një prani të lehtë, e kemi marrë një prani sa kilëshe Veton, një prani të rëndë ndërkombëtare dhe masive do të thosha unë. Pra, çka mund të bëjmë ne, duke pasur dëshirën e jashtëzakonshme që t'i ndihmojmë Ekipit të Unitetit, sepse ne aventura nuk jemi të zotët të bëjmë dhe nuk kemi arsye si njerëz logjikë që jemi. Unë them më në fund se e kemi një ekip i cili që ditën e parë me dy ka thënë që e pranon dokumentin në tërësi, përgjithësisht. Këtu dëgjuam edhe shefat e grupeve parlamentare që e përsëritën pak a shumë të njëjtin problem.

Unë them që, megjithatë, janë tri- katër probleme, në të cilat duhet të insistojë Grupi i Unitetit në ato biseda që priten e që po quhen konsultative. E para është pra: kërkesa që të definohet, të kërkohet qoftë si rekomandim në letër të veçantë që Kosova duhet të jetë e pavarur, përndryshe krejt bisedimet e Vjenës, krejt betimet e Grupit të Unitetit që do të punojnë sipas rekomandimeve të Parlamentit bien në ujë dhe krejt bisedimet nuk nënshkruhen, sepse na është thënë mija herë që ne bisedojmë për probleme të veçanta si kushte për pavarësinë e Kosovës. Ky është diskursi parlamentar këtu. Kjo nën një. Në dy, problemi i përfaqësimit të sforcuar të minoriteteve në të gjitha vijat e pushtetit të projektuar në Kosovë, legjislativ në Kuvend, në Qeveri dhe në gjyqësi. Kudo përqindja është rritur me arsyetimin se duhet të kemi kujdes për të drejtat e minoriteteve. Është e vërtetë të drejtat e minoriteteve në Kosovë duhet të garantohen me elemente kushtetuese, veçse nëse në Kushtetutën e Kosovës instalohet përfaqësimi joproporcional i minoriteteve dhe nëse u jepet e drejta që çdo ligj i rëndësishëm të kalojë përmes dy të tretave të tyre si votim i dyfishtë, mundësia e bllokadës mbetet në vullnetin e tyre. Pra, ne ua japim një veto pa e ditur që po japim dhe kjo është bllokim i funksionimit të sistemit në Kosovë, siç është një tip i bllokimit që e zhvilloi në variantin e vet Z. Surroi fuqia e përfaqësuesit civil ndërkombëtar, qysh është përshkruar në dokument. Nëse nuk i caktohen afati dhe mënyra e përdorimit të autorizimeve që ia jep vetit ai, ju garantoj se jo që e ndihmon ndërtimin e institucioneve të Kosovës, por do t'i dobësojë dhe do të lërë të brishtë edhe më të brishta që janë sot, pra të kërkohet definimi i kohës së tij dhe mënyra e shfrytëzimit të atij mandati, sepse një përfaqësues civil ndërkombëtar i cili i përcakton vetë rregullat për bashkëpunim me autoritetet vendase dhe të njëjtën kohë i gjykon, gjykon a po i ndjek ato rregulla ti edhe të përjashton: Kjo më nuk ka lidhje me demokraci as me përkujdesje. Dhe e treta, decentralizimi, nëse decentralizimi e ka derivuar ndërtimin e komunave etnike dhe

nëse komunat etnike mund të jenë në një kujdesje edhe politike edhe financiare të Beogradit , atëherë ne kemi elementin e tretë të pushtetit ose më së paku e kemi një sovranitet të pjesëtuar me Serbinë. E pra, në zhargonin tonë dhe popullor të gjithë kemi thënë pavarësia e Kosovës për ne ka kuptim në rend të parë tue hjekur sovranitetin e Serbisë prej Kosovës, sovranitetin Kosova është e gatshme ta pjesëtojë me bashkësinë ndërkombëtare dhe në integritet, por jo me Serbinë. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Gani Koci, përgatitet deputeti Mark Krasniqi

DEPUTETI GANI KOCI – I nderuari z. kryetar, i nderuari Ekipi i Unitetit. duke dëgjuar paraqitjet e juaja sikur u bëra gati të dal të festoj për pavarësinë e Kosovës, por megjithatë u durova, nuk shkova, sepse kisha para veti dokumentin të cilin e keni pasur edhe ju.

Jam i bindur se qëndrimet tona sot këtu dhe vendimet, në qoftë se do të ketë vendime dhe nuk besoj se do të ketë, do të jenë objekt i vlerësimit dhe i gjykimit qoftë për të mirë, qoftë për keq, nesër nga qytetarët dhe nga brezat tanë që do të vijnë. Neve na kujtohen kuvende të tilla, nuk dua të krahasoj këtë me Kuvendin e Prizrenit të '45 as me Kuvendin e Kosovës të '89, sepse objektet që shqyrtohen nuk janë shumë të ngjashme, por do të dëshiroja që vërtet të jemi shumë transparentë para qytetarëve dhe të themi atë që vërtet thuhet në dokument dhe të mos i bëjmë nga një here qefin vetit. Unë e them se dardha e ka bishtin mbrapa, por nuk jam nga ata që ta gjuajmë dardhën për shkak se e ka bishtin mbrapa, por që ka bisht, ajo është e evidente. Para vetes kemi një dokument me anë të cilin projektohet e ardhmja e Kosovës. Për mua nuk di se cilat janë ato projeksione të kësaj të ardhme. Diskursi politik dhe jo vetëm politik është ndarë në dy ekstreme të veta. Ne e pamë këtu, ndoshta edhe nga Grupi i Unitetit e tha profesori Sabri këtë unitetin e tyre dhe njëri ekstrem është mohimi i gjithë kësaj që u arrit deri këtu dhe ekstremi tjetër është pranimi i këtij dokumenti anbllok me një entuziazëm po ashtu ekstrem nga lidhshipi i Kosovës. Asnjëra palë nuk na ka sjellë argumentet që burojnë nga ky dokument për këto dy qëndrime. Në radhë të parë unë konsideroj se ky dokument nuk është dokument për statusin e Kosovës dhe as që e përcakton se cili do të jetë ai status. Në rastin më të mirë ky dokument do të mund të quhej jo marrëveshje për statusin e Kosovës, por marrëveshje për statusin e minoritetit serb në Kosovë. Së dyti, ky dokument do të duhet të kuptohet më shumë si kornizë e një prezence të re ndërkombëtare që do të jetë jomonitoruese e proceseve që do të zhvillohen në të ardhmen në Kosovë, por rexhimore dhe aktore kryesore e këtyre proceseve, thënë më troç jo vërtet prezencë e lehtë, por prezencë shumë e rëndë me kompetenca që tejkalojnë në një shkallë, ndoshta edhe kompetencat që ka pasur UNMIK-u këtu. Unë mund të them se prezenca e UNMIK-ut dhe e përfaqësuesit special nuk e ka pasur atë të drejtë , që ta marr për krahu për shembull presidentin e Kosovës dhe ta largojë nga zyra, ndërsa kjo e drejtë i jepet kësaj prezence ndërkombëtare këtu në Kosovë.

Për mendimin tim janë tri çështje që do të duhej të mendoheshin mirë para se të pranohet një marrëveshje të tillë. Së pari, në ç' shkallë është respektuar sakrificat dhe vullneti i qytetarëve shumicë të Kosovës me anë të këtij dokumenti? Së dyti, me çka

garantohet statusi i pavarur i shtetit sovran të Kosovës, dhe së treti çka mund dhe duhet të bëjnë qytetarët shumicë të Kosovës për pakicat e në veçanti për atë serbe. Ky dokument për dy çështjet e para na ofron zgjidhje të mjegulluar. Në mjegull gjithëherë ka shumë rrugë, por vështirë të gjendet ajo kryesorja. Kam shpresë se Grupi i Unitetit e ka gjetur këtë rrugë, por është mirë të na e tregojë edhe neve taman ashtu siç është. Ndërsa, hiq pjesën e përgjithshme i gjithë dokumenti i kushtohet asaj se çka duhet të bëjnë institucionet e Kosovës, qytetarët e saj si shumicë dhe misioni i ri ndërkombëtar për pakicën serbe. Po e theksoj për pakicën serbe dhe jo për pakicat e tjera që jetojnë në Kosovë dhe për qytetarët në përgjithësi të Kosovës.

Me zgjidhjet që i ofron ky dokument sidomos në çështjen e vetëqeverisjes lokale dhe të decentralizimit, çështjen e trashëgimisë kulturore, arsimit dhe të drejtave dhe të lirive qytetare dhe ato pronësore, propozuesi nuk ka pasur për pikënisje qytetarin e Kosovës, por qytetarët e pakicës serbe në Kosovë dhe kishën ortodokse serbe. E kuptoj nevojën për të drejta shtesë për minoritetin serb, por këto të drejta duhen të jenë në përputhje me të gjitha konventat ndërkombëtare dhe se në këtë drejtim është dashur që propozuesi t'i ketë pasur për bazë standardet dhe parimet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve. Askush nuk mund të japë më shumë se atë që e ka për veti. Nëse 10% të qytetarëve të Kosovës e përbëjnë pakicat etnike, duke përfshirë edhe atë serbe këtu, atëherë zgjidhjet që ofron ky dokument janë larg asaj që do të mundësonte një stabilitet politik dhe një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe kulturor për Kosovën në të ardhmen.

Konsideroj se Grupi i Unitetit e ka pasur dhe ka parasysh se me anë të decentralizimit dhe të drejtave shtesë për komunitat serbe si dhe me parimin e votimit të dyfishtë në nivel qendror, kështu siç është ofruar po krijohet rreziku i krijimit të pushteteve asimetrike. Në të gjitha nivelet, e me këtë do të instalohet jostabiliteti dhe jofunksionaliteti i shoqërisë dhe i institucioneve kosovare. Dua të përmend vetëm një fakt: në rast të kontestit eventual në mes të pushtetit lokal dhe atij qendror, jo që vijnë në shprehje procedurat ligjore dhe nënshtrimi sipas fuqisë së akteve ligjore, por duhet të formohen komisionet e arbitrazhit dhe kjo nënkupton atë fuqinë e pushtetit qendror ndaj fuqisë së pushtetit lokal, kur është fjala ekskluzivisht për komunitat serbe. Mënyra e projektimit të zonave mbrojtëse dhe mënyra e kufizimit të së drejtës pronësore në këto zona, konsideroj se do të duhej të shqyrtohej mirë, sepse kështu siç është nuk do të jenë zona të sigurisë, por zona potenciale dhe të pasigurisë dhe revoltës qytetare. Dikush e përmendi këtu edhe faktin se nuk është quajtur kishë ortodokse serbe, por në të dy dokumentet është republika e kishës ortodokse serbe, kush dhe çka ka menduar rreth kësaj është mirë të na sqarojë. Do të dëshiroja që të ishte vetëm një gabim teknik. Në çështjen e rikthimit të pronave të Kishës Ortodokse Serbe duhet përcaktuar qartë se për cilat prona dhe për cilën periudhë bëhet fjalë, sepse ashtu siç thuhet në dokument ekziston mundësia e rikthimit të mesjetës kishtarë në Kosovë.

Kur është fjala për, po ashtu rikthimin jo vetëm për pronat e kishës ortodokse serbe, atëherë duhet të përcaktohet saktë se prej cilës gjendje duhet filluar dhe për cilat prona bëhet fjalë. Kisha ortodokse serbe asnjëherë nuk ka qenë e cenuar në asnjë regjim në pronën e saj, nuk është as sot, nuk ka qenë e cenuar as gjatë kohës kur kemi bërë luftë këtu në Kosovë.

Për çështjen e së ashtuquajturës dy nënshtetësi duhet të merret për bazë gjendja e vitit 1989 dhe jo janari i vitit 1998. Dua të përkujtoj se po qe se merret për bazë gjendja e vitit '98 dhe jo ajo e vitit '89 mbi 500 mijë shqiptarë të ikur nga dhuna serbe në këtë dhjetëvjeçar do të jenë njerëz pa atdhe, të cilin në fakt nuk do duhej ta prananim, kurse në anën tjetër do t'u mundësojmë me një automatizim që të bëhen qytetarë të Kosovës 100 mijë kolonë që kanë qenë të vendosur gjatë kësaj periudhe në Kosovë plus 80 mijë forca aktive ushtarake e policore serbe të kësaj periudhe dhe vërtet, kjo do të duhej të ishte edhe për Grupin e Unitetit edhe për neve një çështje që duhet të diskutohet.

Është plotësisht i papranueshëm propozimi lidhur me shpërbërjen e TMK-së. Asnjë institucion tjetër në Kosovë nuk ofron bazë më të mirë mbi të cilin do të ngritet forca e re e Kosovës dhe është shumë e çuditshme në vlerësimin e standardeve, në raportin e Kai Aides TMK-ja si institucion vlerësohet më së larti në përmbushjen e standardeve dhe për një çast na vjen propozimi që të shpërbëhet TMK-ja. Rreth kësaj çështjeje u tha shumë, prandaj vërtet, nëse nuk duam të krijojmë probleme, revolta të ndryshme, duhet pasë parasysh këtë fakt. Kuptohet reformimi i saj edhe për arsyen se vërtet duhet të ruhet kontinuiteti i kësaj force mbrojtëse. Në qoftë se shpërbëhet dhe krijohet një forcë e re, ne po humbim një argument shumë të fuqishëm të kontinuitetit të forcës ushtarake në Kosovë dhe krejt në fund misioni i ardhshëm në Kosovë duhet të ketë një fillim dhe një mbarim. Duhet të ketë të ndarë edhe shkallën e vet të përgjegjësisë në implementimin e marrëveshjes në raport me institucionet vendore. Kështu siç është në dokument, ky mision mund të jetë i pambarim. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e merr deputeti Mark Krasniqi, përgatitet Fadil Geci

DEPUTETI MARK KRASNIQI - I nderuar kryesues i Kuvendit, i nderuar kryetar i Kosovës, kryeministër, ministra dhe deputetë. Ju përshëndes të gjithëve përzemërsisht. Sot Parlamenti i Kosovës ka për detyrë ta shqyrtojë Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, të paraqitur nga i autorizuari i Kombeve të Bashkuara, zotëri Ahtisari. Megjithëse shqyrtimet tona nuk do të mund të ndryshojnë asgjë në këtë projekt, siç na është thënë me kohë, prapë ne duhet me shumë seriozitet e me shumë përgjegjësi t'i japim vërejtjet e sugjerimet tona për këtë dokument, në bazë të cilit do të zgjidhet problemi i Kosovës, përkatësisht pavarësia e sovraniteti i saj. Meqenëse shumë deputetë do të marrin pjesë në këtë rast, dhe koha për diskutim është e kufizuar, unë do të përpiqem që shkurtimisht t'i paraqes disa vërejtje parimore dhe konkrete.

I jemi mirënjohës zotit Ahtisari për mundin dhe kontributin që e ka bërë bashkë me stafin e tij, në formulimin e këtij projekti, i cili megjithatë ka shumë mangësi të cilat janë në kundërshtim me të drejtat universale të njeriut dhe me parimet gjithashtu universale demokratike, siç janë e drejta e vetëvendosjes kryesore e drejtë e çdo kombi dhe e drejta demokratike e votës së shumicës. Edhe kjo na mohohet këtu në këtë rast, është në kundërshtim me barazitë kombëtare, fetare e sociale dhe me parimet për integrim, duke përkrahur dezintegrimin me formimin e enklavave etnike serbe në formë të komunave të tyre. Me të gjitha këto në mënyrë drastike shkelen dhe injorohen duke i

dhënë të drejta e privilegje të tepruara minoritetit serb në Kosovë, duke dëmtuar e diskriminuar në këtë mënyrë shumicën absolute shqiptare, e cila nuk përmendet fare dhe të gjitha minoritetet e tjera në këtë vend. Serbët të cilët paraqesin një minoritet gjithsesi të vogël u sigurohen 10 vende në Parlamentin e Kosovës plus vendet që i fitojnë me vota, madje edhe disa ministri, ministra e zëvendësministra, pastaj e drejta që ta bllokojnë aprovimin e disa ligjeve, e drejta që të mos paguajnë taksa e tatime, e drejta e përfaqësimit të tyre në gjyqe, në arsim etj. në mënyrë enorme në krahasim me numrin e popullsisë së tyre.

Decentralizimi i pushtetit qendror, është paraparë në fillim në mënyrë që komunave t'u jepen më shumë kompetenca dhe mjete materiale. Me insistimin e Serbisë, është deformuar rrënjësisht ky qëndrim dhe do të formohen komuna etnikisht të pastra serbe me territore të zgjeruara, me kompetenca të posaçme politike, juridike e kadrovike, me lidhje direkte me Serbinë në disa fusha, p.sh. në arsim, në financim, shëndetësi etj. Decentralizimi në këtë mënyrë është mënyra e rrezikshme për paqen e stabilitetin në Kosovë dhe më gjerë dhe shkelje flagrante e të drejtave të komuniteteve të tjera, pra edhe të shumicës së popullsisë, d.m.th. ne jemi vetëm shumicë e nuk jemi shqiptarë. Komunitet e tilla serbe do të jenë disa Serbi të vogla nëpër Kosovën e vogël, rrezik i përhershëm dhe i paevitueshëm i konflikteve serbe me pjesën tjetër të popullsisë së Kosovës, sidomos me shqiptarët dhe diskriminim i të tjerëve.

Serbët në këtë mënyrë në enklavat e tyre do t'i kufizojnë të drejtat e tyre njerëzore, ata nuk do të kenë mundësi që të qarkullojnë lirisht nëpër Kosovë, sepse janë të ngujuar nëpër enklavat e tyre ku paraqesin një politikë gjithmonë serbe, serbomadhe dhe antikosovare.

Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë, me kompetencat e parapara në këtë propozim, gjithashtu do të shkaktojë shumë probleme e konflikte ndëretnike. Numri i tyre nën mbrojtje të posaçme është krejtësisht i paarsyeshëm dhe zonat e tyre mbrojtëse krejtësisht të padrejta dhe të panevojshme dhe se do të jenë gjithmonë "mollë sherri" mes kishës serbe dhe popullsisë rreth saj. Prona private, siç dihet, është e shenjtë për gjithkënd, pra edhe për shqiptarët. Nuk mund të bëhen kurrfarë kufizimesh në pronën private për hir të apetiteve dhe komoditetit të "popave" ortodoksë dhe të kujtdo tjetër, të cilëve madje u sigurohet edhe roja personale, si t'ishin ministra d.m.th. serbët i paraqesin si kisha të veta edhe shpellat e eremitëve, popave të mesjetës, madje edhe një vërimë të vogël në mur ose shkëmb guri. Rast i tillë konkret është Prizreni, të cilin e mbaj në mend edhe vetë ku në një **vërimë** të tillë, sipas traditës, ku kanë vënë një ikonë para së cilës ndezin një qiri. Edhe kësaj "kisha" ortodokse ia kanë caktuar zonën mbrojtëse e cila përfshin krejt Marashin, që është një zonë e njohur turistike e Prizrenit, ku qytetarët shkojnë të pushojnë e të argëtohen. Por tash më, sipas Propozimit që e kemi përpara veti, prizrenasit aty nuk mund të këndojnë as të flasin më zë të lartë që të mos e zgjojnë nga gjumi shekullor shenjtin e **vërimës** dhe të mos fiket qiriri tij. Kishave serbe ortodokse le t'u jepet mbrojtja, me qenë se po kërkohet megjithëse është krejtësisht panevojshme, por mbrojtjen më të mirë atyre ua kanë dhënë shqiptarët, madje edhe gjatë sundimit otoman në këto vise me qindra vjet. Varet nga qëndrimi i autoriteteve fetare serbe ndaj popullsisë fqinje a do të vazhdojë kjo traditë e hershme edhe sot. Kosova multietnike me 90% të popullsisë shqiptare është një anakronizëm që nuk ekziston në botë. Gjuha serbe gjuhë zyrtare në gjithë Kosovën e serbet dihet se sa përbëjnë në Kosovë mund të përbëjnë 5 ose 7, por jo me tepër do të jetë një diskriminim i minoriteteve të

tjera edhe një gjë krejtësisht e panjohur në botë. Le të jetë gjuha serbe gjuhë zyrtare në të gjitha komunat, ku serbët janë shumicë siç janë sot në 5-6 komuna të Kosovës. Që të mos keqkuptohemi duhet theksuar e konfirmuar se gjithmonë e themi dhe e konfirmojmë se të gjithë jemi për barazi, tolerancë e bashkëpunim me të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim feje, kombësie, regjioni etj. Jemi për të drejtat e plota nacionale e të gjitha komuniteteve, pra edhe të komunitetit serb, por jemi gjithashtu kundër privilegjeve të tepruara të çdo komuniteti, pra edhe të komunitetit serb megjithëse ky është kundër pavarësisë së Kosovës dhe kundër të drejtave dhe barazive në qoftë se ata nuk janë të privilegjuar. Madje serbet në Kosovë nuk duhet të kenë më shumë të drejta se shqiptarët në Luginën e Preshevës. Shqiptarët nuk duhet të pajtohen që të jenë populli i diskriminuar, popull i dorës së dytë në Serbi. Më në fund në këtë propozim nuk përmenden fare kufijtë e Kosovës se ata kufi se na kanë thënë shumë herë edhe ndërkombëtarët duhet të jenë të vitit 1998, por përkundrazi theksohet tash në këtë propozim se një pjesë e territorit të Kosovës e cila përfshin 2500 hektarë që Serbia ia ka falur Maqedonisë duhet të jetë akt i kryer, gjë me të cilën shqiptarët në asnjë mënyrë nuk do të pajtohen siç nuk do të pajtohen me ndarjen e Mitrovicës ose çdo pjesë tjetër e Kosovës.

Emrimi i Përfaqësuesit civil ndërkombëtar, për ta qeverisur Kosovën, së cilës mund t'i jepet pavarësi formale, nuk është në pajtim me premtimet e vazhdueshme ndërkombëtare për pavarësinë e plotë të Kosovës. Shtatë vjet e më tepër kanë qenë mjaft për kohën tranzitore, nuk ka kurrfarë nevojë që kjo kohë të zgjatet pakufi. Përshëndesim praninë e pakufizuar të NATO-së e të formacioneve të tjera ndërkombëtare e vendore në Kosovë për sigurinë e sajë dhe më gjerë, si edhe prezencën e autoriteteve civile ndërkombëtare të Evropës dhe të Amerikës, këto të Amerikës po e theksoj dy- tri herë si miq e këshilltarë në qeverisjen sa më të mirë të Kosovës demokratike, Shtet i Pavarur dhe Sovran, i bashkuar dhe i integruar në të gjitha institucionet relevante demokratike, ushtarake dhe ekonomike për të mirën e të gjithë qytetarëve të saj dhe për stabilitetin e paqes e të prosperitetit në këtë pjesë të Evropës.

Ky është qëndrim i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, të cilën unë, si kryetar i saj, e përfaqësoj në këtë Parlament. Falemnderit.

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Kolegë të nderuar ju njoftoj që për të folur për këtë temë janë të paraqitur 37 veta Mendoni mirë dhe mos kërkoni me ua shty kohën se një minutë për vetveten është i vogël për secilin, por për të tjerët po duket ma i madh. Fjalën e ka Fadil Geci, bëhet gati deputeti Xhavit Haliti

DEPUTETI, FADIL GECI – Të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit, të nderuar deputetë

Pakoja e Presidentit Ahtisari për Kosovën është pritur me shumë shpresë dhe me besim të plotë që njëherë e përgjithëmon do të zgjidhet drejt çështja e Kosovës, duke u përmbyllur kjo plagë shekullore që nisnin me okupimin serb të Kosovës në vitin 1912.

Kemi mbajtur shpresa në Ekipin tonë të Unitetit dhe në trupat e tij punuese, që në bisedimet e Vjenës do të prezantojnë dokumentacion të bollshëm dhe argumente të

mjaftueshme që siç deklaronte Presidenti ynë historik dr. Ibrahim Rugova ,Kosova të bëhet shtet sovran dhe i pavarur me njohje formale nga bashkësia ndërkombëtare, anëtar me të drejtat e plotë të Bashkimit Evropian dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të nderuar deputetë

Pakoja e Ahtisarit për statusin e Kosovës hap rrugën që Kosova të bëhet shtet dhe që Rezoluta 1244 e KS të OKB të kapërcehet me të gjitha të mirat dhe të këqijat e saj që ne patëm rastin t'i shohim gjatë këtyre shtatë viteve.

Ekipi i Unitetit i Kosovës i dha përkrahje të plotë këtij dokumenti që do të thotë se pjesa më e madhe e propozimeve , nëse jo të gjitha, të palës kosovare janë futur në dokumentin që ne sot e kemi këtu përpara. Ne si Kuvend i Kosovës do të duhej t'i kishim sot të gjitha propozimet e palës kosovare, të gjithë dokumentacionin komplet, sepse Qeveria e Kosovës për të mbërrijtë këtu ku jemi ka ndarë shumë prej afro dhjetë milion eurosh, për angazhimin e ekspertëve dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet e Ekipit të Unitetit.

Të nderuar deputetë

Dokumenti i Ahtisarit askund nuk e përmend fjalën pavarësi e Kosovës dhe as që e garanton atë, mirëpo ky dokument si thonë anëtarët e Ekipit të Unitetit "e përfshin substancën e pavarësisë, substancën e shtetit të Kosovës". Kjo duket sikur është e ngjashme me premtimet e dhëra këtu dhe publikisht, se Ahtisari do të propozojë pavarësinë e plotë të Kosovës, por jo të kushtëzuar jo gjysmake, por shtet sovran dhe të pavarur.

Të nderuar deputetë Presidenti historik i Kosovës dr. Ibrahim Rugova, angazhohej për Kosovën shtet të pavarur, për njohje de jure nga bashkësia ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, që Kosova të jetë shtet normal si edhe të gjitha shtetet e tjera dhe që të marrë të gjitha obligimet dhe standardet ndërkombëtare për pakicat. dhe në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ngjashëm është thënë edhe në Platformën e këtij Kuvendi.

Pakoja e Ahtisarit si dokument i pranueshëm dhe i dalë nga Bisedimet e Vjenës duhet thënë se i ka edhe disa mangësi që po të mbesin në versionin final, Kosovën do ta bënin një shtet jo funksional.

Po i numëroj disa :

1. Të drejtat e minoriteteve sidomos të drejtat e serbëve i tejkalojnë edhe të drejtat e popullit shumicë. Aplikimi i koncesusit nacional në vendimmarrje për një periudhë të shkurtër do t'i bllokojë institucionet. Unë jam që të gjitha komunitet e Kosovës t'i kenë të drejtat e garantuara sipas standardeve më të larta evropiane ,por jo që Kosova dhe shumica të mbetet peng i pakicës.

2. Monumentet kulturore e historike nuk kanë nevojë të shpallen zona të mbrojtura edhe me ushtri ndërkombëtare. Ato janë trashëgimi e Kosovës që mbijetuan dhe që kanë të ardhme pikërisht në saje të përkrahjes që i dha populli i Kosovës.

3. Trashëgimia në Kosovë nuk është vetëm ortodokse serbe. Të gjithë popujt janë të barabartë, të gjitha besimet janë të barabarta. Historia e Kosovës nuk fillon me mesjetën dhe trashëgimi nuk është vetëm ajo që është serbe dhe ortodokse. Në dokument përmenden mbi dyzet objekte, vetëm serbe.

4. Decentralizimi nuk duhet të vihet në baza etnike. Tash janë krijuar gjashtë komuna të reja etnike serbe krahas pesë me shumicë serbe që i kishim, pra njëmbëdhjetë. Kjo çon te ndamja etnike dhe te ndamja e Kosovës e jo te integrimi i saj. Situatë e rëndë do të bëhet në Anamoravë ku komunat serbe janë krijuar pa asnjë kriter, duke e prishur traditën e mirë të bashkëjetesës e integriteteve të popullatës.

5. Ndarja e Mitrovicës në Komunën Veriore dhe Jugore e jep simboliken e keqe të ndarjes së dy Koreve dhe do të thotë legjitimim i dhunës dhe i pastrimit etnik. Është e patolerueshme që shqiptarët e shpërngulur me dhunë na Veriu të mbesin pa asnjë të drejtë, pa asnjë përkrahje shtetërore e ndërkombëtare ashtu si janë tash e shtatë vjetë.

Të nderuar deputetë, diskutimi im ka përqëllim përmirësimin e dokumentit për të ardhmen e Kosovës. Nuk duhet harruar se këtu kishim një luftë, një gjenocid dhe një intervenim ndërkombëtar kundër regjimit okupues serb. Nëse nuk merren parasysh gjaku i dëshmorëve, reparacionet e luftës dhe dënimi i agresorit, atëherë të gjithë e dini se nuk do të ketë zgjidhje të drejtë, ashtu sikur që nuk pati që nga gjeneza e kësaj çështje që kap një shekull vuajtje dhe dhunë. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti , le te pergatitet deputetja Melihate Tërmkollli

DEPUTETI XHAVIT HALITI - Z. kryetar i Kuvendit. Z. kryetar i Kosovës. z. kryeministër. z. Surroi, z. Thaçi. Të nderuar kolegë deputetë – padyshim që dëshiroj t'i përshëndes punën e mundimshme dhe të gjatë të Grupit Negociator, të përshëndes punën e trupave gjithëpërfshirëse që kanë bërë mund në përgatitjen edhe të negociatave edhe të dokumenteve pavarësisht sa ka qenë influenza, pavarësisht se sa kanë pasë mundësi që të ndikojnë në propozimin e bërë nga Ahtisari.

Dëgjova me vëmendje anëtarët e Grupit Negociator, vërtet i kam dëgjuar dhe përcjellë deklaratat e tyre edhe më herët dhe shqetësimi im është te ju uniteti në deklaram, deklaratat politike, qëndrimet lidhur me të arriturat, pengesat, punën që është bërë dhe situatën në të cilën gjendet Kosova nuk e shoh që është një qëndrim unik i Grupit Negociator, prandaj mendoj që ne sot e kemi për obligim ashtu siç e kanë për obligim Grupi Negociator që t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre politike kur prezantojnë çështjen para publikut, të paktën para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Po dëgjoj me

shumë vëmendje pothuajse gatishmërinë për të filluar me fishkëzjarre për ta festuar pavarësinë e Kosovës, jam skeptik se pavarësia e Kosovës do të vijë kaq shpejt dhe kaq lehtë qysh po e trumbetojmë ne nganjëherë, por besoj dhe nga dokumenti i Ahtisarit shihet qartë se substanca e ndërtimit të shtetit, substanca e ndërtimit të pavarësisë së Kosovës të cilën e kemi për obligim që ta ndërtojmë bashkë, të gjithë është dhënë dhe për këtë dua t'i përgëzojë edhe Grupin e Unitetit edhe deputetët e Kosovës edhe Qeverinë edhe qytetarët e Kosovës, të cilët janë treguar të pjekur politikisht, të përgjegjshëm para domosdoshmërisë për të ndjekur me durim hap pas hapi procesin në të cilin kemi hyrë.

Tani kemi një çështje tjetër, e cila nuk u prek çështjen e pengesave që mund të bëjë Qeveria e Serbisë lidhur me shtyrjen e mundshme të procesit të negociatave ose lidhur me mundësinë e shtyrjes së propozimit për të nxjerrë rezolutë të re. Mendoj që Grupi Negociator dhe strukturat politike të ndërtuara nga grupi politik dhe strategjik do të duhej ta ndiqshin hap pas hapi situatën dhe kurthet që është duke i vënë diplomacia serbe dhe politika serbe për t'i penguar dhe për t'i prolonguar sa më shumë e sa më gjatë qoftë bisedimet në Vjenë, qoftë propozimin e Ahtisarit Atisarir dhe nxjerrjen e Rezolutës së re, në Këshillin e Sigurimit dhe përpjekjen për të lobua dhe ndoshta për t'u përdorë vetoja e ndonjë shteti, për ta penguar rezolutën e re. Unë jam i vetëdijshëm që Ahtisari nuk do të propozojë rezolutë, përmes rezolutës së tij që, Kosovës t'i njihet pavarësia në Këshillin e Sigurimit, por uroj që propozimi i Ahtisarit për rezolutën re të miratohet në Këshillin e Sigurimit dhe na mbetet ne që ta shpallim pavarësinë e Kosovës në Parlamentin e Kosovës.

Shqetësim i madh për mua ka qenë dhe është deklarimi i Grupit të Unitetit, që pranon të gjitha borxhet të cilat i faturohen Kosovës. Mendoj që Kosova nuk ka kapacitete ekonomike, me këtë buxhet të vogël që e ka, me këtë absorbim të hyrash kaq të vogël, që t'i kthej gjithë ato borxhe prej rreth 1 miliard dollarësh i cili është pranuar pa asnjë lloj rezistence, në bisedimet e zhvilluara në Vjenë.

Sipas paralogarive i bie që në momentin që marrëveshja të hyjë në fuqi, Kosova në emër të kamatave për këtë borxh të paguajë në ditë rreth 100-mijë €. Prandaj, mendoj që Ekipi i Unitetit duhet të përqendrohet, me mekanizmat ndërkombëtarë, me ndërmjetësin ndërkombëtar, me të gjitha shtetet mike, të cilat mund të na ndihmojnë që të paktën, të ushtrojnë influencë te Banka Botërore, te borxhlinjtë që mund të jenë, Kosova mund të ketë borxhe ndaj tyre që, këto borxhe të falen. Përndryshe, me gjendjen ekonomike që e ka Kosova, është një barrë shumë e rëndë për neve të gjithëve.

Prandaj edhe një herë dua që, vërtet mesazhi ynë sot nga ky takim, të jetë mesazh shprese për qytetarët e Kosovës, mesazh garancie për komunitetet ose t'i quajmë pakicat kombëtare në Kosovë, pavarësisht se cilat janë ato, të vogla apo të mëdha, për të gjithë qytetarët dhe një mesazh për të gjithë neve, për të gjithë ata që presin pavarësinë e Kosovës se ky Parlament i Kosovës do ta shpallë dhe jetësojë pavarësinë e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Melihate Tërmerkollit, le të përgatitet deputetja Sala Ahmetaj.

MINISTRESHA -DEPUTETJA, MELIHATE TËRMKOLLI – Ju faleminderit zotëri kryetar, i nderuari kryetari i Kosovës, të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, të nderuar deputetë e ministra!

Unë isha përgatitë që fjalën në fakt ta hap me atë që, zotëri Sabri Hamiti e tha në mënyrë të shkëlqyeshme se, është e palejueshme që Parlamenti i Kosovës në veçanti anëtarët e Grupit Negociator, në asnjë rast të mos përmendin punën dhe kontributin e pakontestueshëm historik të presidentit Rugova, në rrugën tonë për liri dhe pavarësinë e vendit. Kjo besoj se nuk do të përsëritet më dhe kujtoj që është diçka që është në nderë edhe të këtij Parlamenti, po është edhe në nderin e anëtarëve të Grupit Negociator edhe të gjithë neve bashkërisht. Janë edhe disa çështje të cilat vërtet kanë krijuar ndoshta ngapak huti edhe konfuzion. Fjala e kryetarit kujtoj që është qëndrim edhe i Grupit Negociator, edhe duhet ta përgëzoj vërtet një fjalë kujtoj që, kishte elemente të domosdoshme të trajtimit të dokumentit, edhe të gjithë procesit, mirëpo kjo nuk doli edhe në qëndrimet e anëtarëve të tjerë të Grupit, që do të thosha me një paqartësi dhe një jo-koherencë, të krejt zhvillimit të procesit. Më vjen keq ta them, por është hera e dytë, në fakt vazhdimësia e saj që ka ndodhë edhe në takimin e parë kur kemi debatuar për procesin e negociatave dhe po përsëritet prapë.

Anëtarët e Grupit disa nga ata, e përdorin këtë foltore për nevoja partiake, apo për propagandë partiake, edhe për propagandë personale, që unë kujtoj nuk është e mirë dhe thjeshtë nuk u bën nder as atyre edhe as Parlamentit të Kosovës. Parlamentit të Kosovës i duhet një qëndrim unik, i duhet një qëndrim kredibil, një qëndrim i fuqishëm dhe koherent, i anëtarëve të Grupit të Unitetit apo Grupit Negociator si e kemi quajtur.

Përndryshe disa nga deklaratat këtu, janë ndoshta të denja për ndonjë ligjërim dhe ndonjërin nga degët e partive politike, të cilat ata i përfaqësojnë, aq më tepër do të thosha këtu ndoshta fjala e zotit Surroi, nuk e kam të qartë, ajo besoj që absolutisht nuk është qëndrim i Grupit të Unitetit, rreth përzënies të minoriteteve nga Kosova, nuk e kam të qartë për çfarë periudhe kohore ka folë atje. Ndoshta do të ishte mirë të sqarohet, sepse diçka e tillë është e papranueshme për Kosovën dhe për shqiptarët si shumicë.

Para luftës ka qenë Serbia, regjimi i Beogradit, ai që është përpjekë t'i përzë shqiptarët nga Kosova, në periudhën e pasluftës ne e kemi shumë qartë që, asnjë veprim i tillë as nuk ka ndodhë, as nuk ka pasur rast të ndodhë, përkundrazi, është përpjekja e plotë e shumicës shqiptare që të punojë në integrimin e plotë të minoriteteve. Mirëpo ndoshta kjo për zotin Surroi nuk është shumë, do të thotë, nuk është ndonjë dert i madh, sepse nëse përkujtojmë vitin 2000, na pat quajt fashist, edhe për mua është shumë e pa qartë një person që e quan popullin e vet të tillë, sa ka mundësi të punojë edhe të veprojë për pavarësinë e këtij vendi dhe të këtij populli.

Do ta doja një seriozitet të plotë të të gjithë atyre, të cilët bartin barrë dhe thjesht kanë marrë përsipër përgjegjësi shumë të mëdha, që të mos lëshohen në përkufizime, ose të mos të lëshohen në definime ose formulime, të cilat e dëmtojnë procesin.

Unë do të thosha që thjesht, pakoja hap rrugën dhe dyert për njohjen formale të pavarësisë së Kosovës dhe ky nuk është ndonjë konstatim i ri që kam bërë, janë edhe shumë nga ata që e kanë trajtuar e kanë lexuar dhe e kanë përcjellë procesin në përgjithësi.

Me këtë rast dua ta theksoj edhe një kontribut të jashtëzakonshëm të Qeverisë së Kosovës, që asnjë herë nuk është përmend, edhe mund ta them që këta ministra të mirë e të këqinj, këta që janë, në punën e tyre është bërë një shtytje vendimtare për procesin e zhvillimeve që jemi deri tani, edhe procesin e njohjes së pavarësisë së Kosovës. Natyrisht ka çështje të cilat ne do t'i trajtojmë, ani pse të them të drejtën prapë kemi pasur konfuzitete. Ndonjë anëtar i Grupit Negociator thotë se nuk është mirë me bë propozime, tjetri thotë se nuk ka me pasë asnjë ndryshim të qëndrimeve, apo te dokumentet e tjera, megjithëse unë kujtoj që ky Parlament sigurisht do të duhet të thotë edhe duhet ta thotë fjalën e vetë jo për ta kontestuar dokumentin e presidentit Ahtisari, po për të dhënë vërejtjet me qëllim të funksionimit më të mirë, të institucioneve dhe të pushtetit në Kosovë.

Unë do të thosha një çështje e rëndësishme, që besoj Grupi Negociator po, duhet të besoj që edhe presidenti Ahtisari, do ta ketë parasysh, së paku ka paralajmërua edhe dje në Organizatën e Kombeve të Bashkuara që, në momentin kur do t'i dërgohet dokumenti Këshillit të Sigurimit, do të jetë gjithësi fjala pavarësi.

Ne kemi dëgjuar dhe po dëgjojmë vazhdimisht që, gjatë gjithë debateve ne po flasim për ingerenca shtetërore, se janë ato ingerenca, se Kosova, po ky dokument përmban substancën e shtetit të pavarur etj. por mungon fjala pavarësi. Unë sinqerisht them, ne mund të themi që, janë të gjitha këto por, kur mungon fjala pavarësi, ajo mungon, edhe Grupi Negociator edhe të gjithë të tjerët si propozim gjithësi unë kujtoj që duhet ta bëjnë që në dokument të jetë fjala pavarësi. Na ka kushtuar shumë gjatë historisë, edhe në kësaj historinë më të re që ne e njohim, të një ish- periudhe kur kemi qenë, kur ishin do arsyetime se Kosova ka qenë njësi, s'po dua me bë ndoshta krahasime se janë më së paku krahasime, po së paku në formë se Kosova është njësi e barabartë etj. i mungon fjala republikë. Ajo mungesë e fjalës republikë, na ka kushtua shumë. Na ka kushtuar jashtëzakonisht shumë dhe kemi pasur pasoja të cilat edhe sot e kësaj dite ne po i bartim pasojat e tilla.

Unë dua të besoj që fjala pavarësi, gjithësi do të jetë, sepse ka, ose nuk ka pavarësi. Një dokument që nuk do ta përmbajë këtë fjalë, sigurisht që do të jetë i mangët, për një çështje shumë esenciale, po them duhet të besoj që kjo gjithësi do të jetë dhe do të jetë po ashtu edhe propozim i Grupit Negociator.

Te simbolet, po ashtu unë do të thosha, nuk di a ka qenë çështje e bisedimeve të tjera të Grupit, së paku ne edhe si deputet edhe si ministra, nuk e kemi pasur të qartë, a është biseduar, a ka pasur ndonjë marrëveshje etj. natyrisht që është diçka shumë e mirë, se përmendet që, Kosova do të ketë simbolet e veta shtetërore, etj. mirëpo unë kujtoj që formulimi pak duhet të reduktohet, sepse mjafton me thënë që Kosova duhet t'i ketë simbolet e veta, për faktin se, nuk ka asnjë përkufizim, që në mënyrë artificiale, ka me

legjitimua një strukturë, e cila nuk ekziston në Kosovë. Faktet janë shumë më kokëforta, realiteti është shumë më kokëfortë, se çdo formulim të cilin mund ta bëjmë, pavarësisht ne ose ndërkombëtarët, kushdo që të bëjë, qoftë për strukturën etnike etj. qoftë për çfarëdo tjetër.

Kështu që në këtë drejtim kujtoj që nuk ka asnjë arsye që të mos jetë kështu dhe mos të jetë një kërkesë që, mjafton të përmendet çështja e simboleve, mënyra etj. si do ta bëjmë është çështja e institucioneve të cilat do të merren me të. Dhe do të them që, tek regjistrimi i popullsisë, në veçanti do të ndalem dy- tri fjalë do t'i them. Unë edhe me shkrim e kam bërë do t'ja paraqes Grupit të Unitetit, në fakt ia kam paraqitur Grupit të Unitetit, zyrës së UNOSK-ut, edhe të gjithë të tjerëve të interesuar, vërejtjet dhe propozimet që lidhen me pikën rreth regjistrimit të popullsisë.

Në dokumentin e presidentit Ahtisari thuhet që regjistrimi mbahet një vit pas fuqizimit të dokumentit, marrëveshjes në fakt, unë kujtoj që, formulimi duhet të jetë brenda vitit, sepse, pse e them këtë ka arsye të plotë, Kosova është e përgatitur plotësisht që regjistrimin ta mbajë në vjeshtë të këtij viti dhe po ashtu në dokumentin e presidentit Ahtisari. Ne kemi edhe çështje të tjera të cilat në një mënyrë, qoftë direkt apo indirekt, lidhen me regjistrimin dheme rezultatet e regjistrimit të popullsisë. Është çështja e zgjedhjeve, pra nacionale e lokale që parashihet të mbahen në bazë të këtij dokumenti dhe çështja e rishikimit të decentralizimit.

Prandaj insisto që regjistrimi, gjithsesi të insistohet të mbahet në këtë vit, sepse ka edhe një arsye tjetër,- pas mbajtjes së regjistrimit , së paku gjashtë muaj nevojiten për t'i publikuar rezultatet e regjistrimit të popullsisë. Dhe një element tjetër, që kujtoj se është shumë i ndjeshëm dhe shumë i rëndësishëm, të cilin në asnjë mënyrë besoj se edhe Grupi edhe ne si institucione nuk do të mund të pranohej, është formulimi menjëherë pas kësaj pike, pra i pikës tjetër, ku thuhet që republika e Serbisë dhe shtetet tjera fqinjë, do të autorizojnë regjistrim përmes një agjencie ndërkombëtare të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, që dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Unë kam propozuar që kjo fjalë të hiqet nga teksti. Dhe duhet të hiqet. Po të mbetet kështu vërtetë do të jetë problem shumë serioz, në procesin e regjistrimit e popullsisë dhe të dhënave dhe krejt kredibilitetit këtij procesi.

Së pari është një formulim që është në kundërshtim me vetë standardet ndërkombëtare. Është në kundërshtim po ashtu me Ligjin për regjistrimin të cilat mbahen në gjitha vendet evropiane. Kjo në një farë mënyrë do të thotë standard i dyfishtë, jo në njëfarë mënyrë ,por në fakt, do të thotë standarde të dyfishta, një standard për njërën pjesë të qytetarëve dhe standard tjetër për qytetarët e tjerë. Dhe së treti **është një rast ...**

KRYETARI, KOLË BERISHA –Edhe një minutë!

Vazhdon – është pra një rast i paprecedent,sepse nënkupton informimin e një shteti tjetër në regjistrimin e popullsisë në Kosovë, gjë që është e një gjë e pa lejueshme dhe e patolerueshme. Askund në botë nuk ka ndodhë që një shtet tjetër të ndërhyjë në regjistrimin e shtetit tjetër. Unë besoj që këto do të jenë të pranueshme dhe thjeshtë nuk e

ndërrojnë esencën e dokumentit të presidenti Ahtisari po e përshpejtojnë dhe e lehtësojnë procesin e realizimit të asaj që ne jemi përcaktuar si institucion. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Sala Ahmetaj, le të përgatitet deputeti, replikë, urdhëroni zotëri Surroi.

DEPUTETI, VETON SURROI – Meqenëse u përdor emri replikë e thjeshtë, unë kur fola për minoritetet dhe verën e vitit 1999, fola për përndjekjen e minoriteteve në Kosovë, të gjitha komuniteteve pakicë, që nga serbet deri te romët, endi qëndroj pranë kësaj fjale, do të ishte joserioze, në raportet me bashksinë ndërkombëtare e cila jo vetëm që na ka lutur, që të krijojmë marrëdhënie të reja, por i ka dokumentuar këto dhe do t'ia përkujtoja ministres se ekziston raporti i OSBE-së, lidhur me këtë çështje.

Ne i kemi shpenzuar kot 8 vjet, duke e bindur veten në atë çka kemi mundur të bëjmë që në fillim, që në vitin 1999, është se të krijojmë marrëdhëniet e reja në mes shumicës dhe pakicës, mendoj se i bën nderë shumicës që t'i respektojë të drejtat e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, urdhëroni, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni

DEPUTETJA, SALA AHMETAJ - Të nderuar anëtar të Ekipit Negociator, të nderuar ministra dhe të nderuar deputetë

Dokumentin për statusin e Kosovës e kemi në duar, është e mundshme që të hapësirë edhe për të dëshiruarën. E kemi vështirë të bëjmë debat për disa arsye,

1. Mundësia e interpretimit të fakteve në mënyra të ndryshme,
2. Shpërfillja e fakteve, që mund të shkaktojnë paqartësi dhe vështirësi gjatë zbatimit,
3. Cilat kritere ose standarde janë përfillur sa u përket të drejtave të komuniteteve?

Sa i përket mënyrës së interpretimit të fakteve, duam të besojmë se argumentet dhëna nënkuptojnë pavarësinë, këto janë fakte që nuk mund të shpërfillen, besojmë. Kjo do të nënkuptohet se ndërtimi i shtetit, tani është në duart tona.

Ne pra e kemi edhe privilegjin, po edhe përgjegjësinë për këtë. Madje përgjegjshmëria duhet të jetë arma jonë më e fortë. Dokumenti duhet të trajtohet me realizëm, as me glorifikim, as me shpërfillje. Në rrafshin politik, ky dokument duket të jetë i pranueshëm, sepse e përgatit Kosovën për t'u shndërruar në shtet të pavarur sovran dhe funksional. Për të ndodhur kjo, disa korrigjime në rrafshin teknik janë të nevojshme me qëllim të funksionalizimit të shtetit dhe të sovranitetit të brendshëm të tij. P.sh. tek neni 7. aneksi 5. që trajton trashëgiminë kulturore dhe fetare, kemi disa vërejtje konkrete:

Objektet e kultit dhe monumentet e kultit janë vlera kulturore që nuk do të duhej të njëjtësoheshin vetëm me një komb, në këtë rast me kombin serb.

Kisha është shtëpi e Zotit, Zoti nuk ka përkatësi kombëtare, ato janë kisha ortodokse jo vetëm serbe, siç janë: kishat katolike protestante, që nuk i përkasin vetëm një kombi. Edhe në dokumentet e UNESCO-s, shkruan dhe qartësohet, se kishat nuk duhet të emërtohen ekskluzivisht me emrin etnik. Pastaj monumentet e tjera kulturore, janë pasuri dhe vlerë e Kosovës. Siç janë monumentet nga antika, kështjellat, vendbanimet antike etj. Kjo duhet të korrigjohet në dokument, sepse këto nuk janë monumente serbe siç shkruan aty, por janë monumente dhe pronë, pasuri e Kosovës.

Neni 6.1, tek kthimi i pronës shkruan: kthimi i pronës përfshinë edhe ato që kanë të bëjnë me kishën ortodokse serbe. Kjo mënyrë e formulimit, lejon mundësinë për manipulime. Propozojmë që të saktësohen datat, epokat, vitet e jo të shkaktohet paqartësi, ne nuk mund të merremi as me mesjetën, as me antikën, por me të ardhmen. Në Kosovë ka pasur konfiskime të pasurisë dhe të tokave, nga pushtuesit por jo të pronës serbe e as të kishave të tyre. Edhe caktimi i zonave mbrojtëse, është bërë me privilegj vetëm për kishat ortodokse.

Këto janë elemente që e zbehin stabilitetin dhe e vështirësojnë funksionalitetin e shtetit. Në këtë mënyrë shqiptarët dhe pakicat e tjera diskriminohen në aspektin fetar dhe kulturor. Propozojmë që për monumentet kulturore dhe për monumentet fetare, të merret parasysh legjislacioni aktual i Kosovës. Ne kemi Ligjin për planifikimin hapësinor dhe Ligjin për trashëgimin kulturore, të hartuara me standardet më të avancuara bashkëkohore dhe ne do të pyesnim pse nuk janë marrë për bazë këto ligje në dokument?

Disa nene të këtyre ligjeve, që ne i kemi e rregullojnë qartë dhe drejt çështjen e hapësirave të mbrojtura, pastaj Ligji për trashëgiminë kulturore parasheh edhe këshillin kombëtar për trashëgimi. Vlerat afetare dhe kulturore, duhet të kultivohen njësoj, pa privilegje dhe pa diskriminim, në këtë mënyrë, do të shmangen veprimet devijonte, që bëhen duke u fshehur nën petkun e ndonjë aktiviteti fetar ose kulturor.

Kemi edhe disa vërejtje të tjera të shumta po, u thanë po do t'i përmendim disa prej tyre:

Mandati i përfaqësuesit ndërkombëtar në Mitrovicë, askund nuk shkruan dhe nuk është precizuar, se mandati i tij është që të integrojë qytetin. Propozojmë që të saktësohet kjo në dokument!

Pastaj, mandati i TMK-së, TMK-ja duhet të jetë, bartëse e procesit të transformimit dhe në kontinuitet, në dokument duhet të përcaktohen edhe kriteret, për pjesëtarët e ri të cilët do të angazhohen në forcën mbrojtëse, dhe çështje tjetër është Për implementimin e kësaj pakoje, nevojitet ndërtimi i shumë mekanizmave të cilat janë të kushtueshme për buxhetin e Kosovës. Sa do të jetë kjo marrëveshje e qëndrueshme, duke pasur parasysh edhe parametrat ekonomik që ka Kosova. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, përgatitet deputeti Lulzim Zeneli

DEPUTETI, HYDAJET HYSENI – Zoti kryetar, më lejoni që duke përshëndetur gjithë deputetët, të përshëndes veçanërisht anëtarët e Grupit të Unitetit dhe po ashtu veçanërisht i falënderoj për prezantimet e tyre, që na e kanë lehtësuar debatin, ata e morën atë pjesën pozitive të dokumentit. Bile folën aq shumë për atë pjesën pozitive sa druaj se po të ishte këtu zoti Ahtisari do ndiejë siklet. Do të mund të thoshte aman na kurseni pak, se unë nuk jam “Shën Nikollaj”, nuk jam babadimri që të sjell pako me dhurata, unë jam arbitri, dhe si arbitër kam sjellë një propozim, është e juaja që ta bëni punën tuaj, arbitri e sjell topin, e gjuan .por nuk e gjuan në koshin, as në portën e tjetrit, është pjesë e lojtarëve që ta bëjnë këtë.

Dokumenti që ne po diskutojmë dhe është mirë që po fokusohemi te dokumenti, është ashtu siç është, ka anët pozitive, por ka edhe këtë anën tjetër. Ne na ka mbetur më shumë që të flasim për këtë anën tjetër, por megjithatë dua ta theksoj se si dokument për bindjen time ai është ambiguent, mund të çojë në pavarësi dhe unë i mbështes gjitha atë që çon në këtë drejtim, edhe ata që kanë kontribuar, por mendoj, gabojmë rëndë nëse harrojmë se ky dokument po ashtu mund të çojë në vartësi të Kosovës. Në vartësi të sofistikuara dhe të dy rrugët janë të hapura për bindjen time, uroj që ta kem gabim.

Mendoj që jemi ngutur që ta mbështesim .Apriori, krijohet përshtypja bile ende pa e lexuar mirë, p.sh. u dha mbështetje edhe pa e sqaruar a është edhe kompetencë e komunave dhe grumbullimi i doganave apo jo, u sqarua se ishte gabim teknik. Edhe këtu ne po e diskutojmë këtë dokument si marrëveshje, gjitha versionet shqipe është përkthyer shprehja setëllment-anglisht si marrëveshje. Nëse është ky kuptimi në gjuhën shqipe shtrohet çështja me të drejtë çfarë marrëveshje, në mes kujt marrëveshje. Por shprehja (**setëllmen**) më së keqi mund të përkthehet si marrëveshje, është një zgjidhje , një propozim zgjidhje që si e tillë ajo edhe e lë mundësinë e diskutimit dhe e ndryshimit. Prandaj më lejoni që unë të fokusohem në disa nga vërejtjet që mendoj se duhet ti adresojmë në procesin e mëtejshëm.

Dokumenti në fakt ka brenda një zgjidhje gjysmake, me shumë anomali, me shumë defekte që janë vërtetë non sens dhe pa presedan. Kjo zgjidhje gjysmake ne na ka kushtuar shumë siç thanë parafolësit, mua më lëndon një prirje e jona për të fol tash për elementet e shtetit, për substancën e shtetit edhe pse ai nuk e ka emrin, pse të mos e ketë emrin. Edhe Kushtetuta e 74-ës, ka pasur do elemente të shtetësisë, gati të gjitha këto që janë këtu, i ka pasur në një formë ose tjetër, por ne e pamë se nuk mjaftonte, prandaj nuk guxojmë të lejojmë të njëjtin mashtrim, sepse me pajtimin paraprak ne edhe mund të çojmë konkluzione të gabuara.

Dokumenti në fakt siç u tha, jo vetëm që nuk e përmend askund popullin shqiptar, por në fakt jam munduar t'i shikoj me thjerrëz, nuk ka asnjë dispozitë të vetme e cila do të mund të vlerësohej si e njëanshme në favor të shqiptarëve. Ma gjeni ju lutem një. Nuk ka, më së shumti që mund të thuhet ka qëndrime korrekte, të arsyeshme reale, të cilat i mbështesim, por nuk ka asnjë që mund të jetë e njëanshme në këtë drejtim. Kurse ka shumë, tepër shumë, deri në absurd shumë, që janë vërtet të tepri në anën tjetër.

Shtrohet pyetja pse? Unë e di dikush do të thotë, po na duhej kjo si tagër për pavarësinë. Diskriminimi pozitiv dhe e di nëse unë flas për diskriminimin pozitiv fitoj shumë poena politike Dhe më besoni jam shumë i interesuar që të lë përshtypje të tillë dhe di ta bëj. Por dua të theksoj se, deri tash përvoja jonë ka dështuar se një qasje e tillë nuk shpije gjëkund, bash gjëkund nuk shpie.

Nuk ndihmohet në këtë mënyrë Kosova, nuk ndihmohet paqja, dhe nuk ndihmohet as komuniteti serb në Kosovë. Komuniteti serb në Kosovë është dëmtuar pikërisht duke e favorizuar, duke e favorizuar artificialisht dhe duke e instrumentalizuar në emër të favorizimit. Është detyrë e kolegëve tanë serbë që ta konstatojnë këtë, edhe të mos e lejojnë edhe një instrumentalizim të ri. Por dokumenti zonja dhe zotërinj, ka plotë mangësi të tilla. Dokumenti nëse më lejoni është një koncesion që u bëhet jo serbëve të Kosovës. Do të ishin në favor të çdo avancimi të drejtave të tyre. Dhe konsiderojnë këtë pjesë të projektit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës dhe e bëjmë jo me hipokrizi, po e bëjmë sinqerisht. Por ama ky është koncesion në funksion të Beogradit shovinist, që në funksion të instrumentalizimit të serishëm të tyre dhe kjo e theksojë përsëri nuk i ndihmon atyre.

Është koncesion që i bëhet prirjes së Beogradit shovinist për paraqitur problemin e Kosovës, çështjen e Kosovës si problem ndëretnik. Gjithë teksti përshkohet nga kjo. Nuk është e vërtetë, nuk ka bazë për të ardhur një konkluzion të tillë dhe për pasojë nxirren gjithfarë zgjidhjes që janë artificiale jofunksionale dhe dëmtojnë të ardhmen e pajtimit në Kosovë. Është koncesion ndaj prirjes së Beogradit përsëri për ta paraqitur problemin në Kosovë, si konflikt ndër-fetar. Dhe gjithkush e di është theksuar sa e sa herë nëpër raporte se nuk është i tillë, Kosova është shembull i tolerancës ndëretnike dhe ndër-fetare dhe do të jetë edhe më shumë në të ardhmen.

Nuk mund të justifikohet ta zëmë trajtimi i monumenteve fetare në Kosovë si ekskluzivisht etnike siç u tha. Por sidomos nuk mund ta kuptoj si ka mundur ekipi ynë të pajtohet ta zëmë që monumente si Kalaja e Novobërdes të konsiderohen se janë monumente etnikisht, ekskluzivisht etnike serbe. Ose ura në Vushtrri, ose kala e Zveçanit ose të tjera dhe nëse janë të tilla, pse nuk janë edhe monumentet e tjera të feve tjera të konsideruara të rëndësishme së veçantë etj.

U tha këtu me të drejtë, ne kemi siguruar zgjidhje me ligj të çështjeve të raporteve fetare, pse nuk janë marrë zonja dhe zotërinj. Ai ligj nuk është kontestuar nga askush, ka marrë notë pozitive në të gjitha vlerësimet, kurse dokumenti me të vërtetë prish zgjidhjet që i kemi rregulluar ne me ligj.

Ky dokument përveç tjerash çon në bosnizimin e Kosovës, unë dëshiroj që ta kem gabim. Por çon në ndarje etnike me sherr për Kosovën. Kuazi-decentralizimi që thuhej se nuk do të jetë etnik, nuk do ta pranojmë të jetë etnik, e është tërhequr vërejtja në fillim se atje po shkohet, doli se është puro etnik dhe është kuazietnik. Është huazi decentralizim. Nuk ndihmon serbët e periferisë së Gjilanit nëse lidhen me Artanë (Novobërdë).

Është sakatuar Anamorava zotrinj. Përse, pse ky dënim veçanërisht për Anamoravën. Është dënuar fryma e tolerancës e pajtimit në Anamoravë dhe pasojat do t'i shohim bashkërisht. Është dëm që këtu nuk është zëvendëskryeministri i cili i ka kontribuar pikërisht prodhimit të pasojave që, druaj se do ti kushtojnë edhe atij personalisht në karrierën politike etj.

Nuk e kuptoj pse nuk është insistuar në ekuivalencat që janë të pa anashkalueshme, pse harrohet ta zëmë çështja e shqiptarëve jashtë Kosovës, nëse flitet për komuna këtu të reja, pse nuk ka edhe komuna jashtë Kosovës.? Nëse flitet për të zhvendosurit që duhet të kthehen, në Kosovë, pa shqyrtuar a janë aty edhe paramilitarët, ushtarët e policët, etj. pse nuk flitet për kthimin e shqiptarëve nga Medvegja e Sijarina. Pastaj nuk u përmend nga askush çështja e shtetësisë, është përmendur këtu edhe njëfarë dy shtetësie. Dokumenti thotë se shtetësinë e Kosovës mund ta aplikojnë ata që duan, nuk ka qenë kështu në asnjë nga ish- republikat e Jugosllavisë, nuk ka qenë as në Mal të Zi, dhe çka do të ndodhë me komunat në të cilat nuk do të aplikohet për shtetësinë e Kosovës.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Zoti Hyseni, 37 veta i kemi të lajmëruar për diskutim, prandaj ju lutem një minutë

Vazhvon – kam edhe shumë për të thënë ,pr nuk dua të zgjatem, dua të them vetëm një gjë, thotë një fjalë e jona, 100 vetë po të të lidhin zgjidhesh vetë, por po u lidhe vetë edhe 1000 vetë nuk do të zgjidhin.Të mos të lejojmë të lidhemi,por le të ngritet ky Kuvend në nivelin historik që ka dhe të mos lejojmë që çështjet që nuk i themi ne t'i adresojë pastaj populli i Kosovës në forma të tjera. ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, do të duhej ta kishte radhën tash Lulzim Zeneli po nuk di a mundet . Urdhëroni Lulzim, përgatitet deputeti Milazim Haliti.

DEPUTETI, LULZIM ZENELI - I nderuar zoti kryetar i Kuvendit, të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, të ekipit të unitetit, i nderuari zoti president, zoti kryeministër, tashmë pas debatit që patëm gjer tani, rreth këtij dokumenti, vijmë në përfundim se debati është lokalizuar në shumë çështje. Mirëpo, prapëseprapë, propozimi i presidentit Ahtisari, për zgjidhjen e statusit të Kosovës, krijon ndjenjë të përzier dhe kjo mund të reflektohet në tri pika kryesore:

E para, e dihet që pas një rrugëtimi të gjatë, kemi ardhur në një fazë kur pritet finalizimi i këtij projekti me përkrahjen e pakursyer të faktorit ndërkombëtar, që besojmë se do të jetë në përputhje me vullnetin politik të popullit të Kosovës për shtet të pavarur. Mirëpo ajo çka dua të theksoja se, pakoja e Ahtisarit, hap rrugën për krijimin e shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë, ne kemi ardhur në këtë fazë si rezultat i një procesi negociator dhe i tillë çfarë është, mirëpo në anën tjetër, nëse ky dokument analizohet, atëherë mund të vijë në përfundim se, ekziston një diskrepancë e madhe në mes asaj çka është proklamuar në këtë fazë, në fazën e negociatave dhe asaj çka përmban draft-dokumenti. Mirëpo, këtu patëm rastin edhe të dëgjojmë, edhe pjesë të tjera, në pjesë tjera të diskutimit se, edhe ne jemi bashkëpronarë në disa pika të këtij dokumenti. Prandaj edhe veç debati rreth kësaj

çështjeje është lokalizuar mjaft. Elementet kyçe që mendoj, që edhe për ne do të jenë sfiduese, në këtë projekt, nën një është decentralizimi mbi baza etnike që në fakt është inkurajim për dezintegrim, me madhësi të territorit që në asnjë mënyrë nuk përkon me realitetin dhe as me nevojat e komunitetit minoritar.

U përmendën këtu edhe lidhjet e tjera direkte, mirëpo të gjitha këto me një fjalë nuk japin garanca shpresë për funksionalitet dhe e pamundëson integrimin e komunitetit serb, në shoqërinë dhe shtetin e Kosovës. Në të drejtë, ose pa të drejtë, deri më tash mbetet që kjo të reflektohet në fazat e mëvonshme, Ekziston një drojë te qytetarët e Kosovës. Nëse është numër i madh i objekteve, apo i zonave të mbrojtura, një prej efekteve që mund të prodhojë efekte të kundërta në fazën e implementimit, atëherë unë mendoj se ky është si rezultat i një trajtimi jo të duhur.

Në fazën e procesit që po e lëmë pas, këto të drejta që kryesisht i atribuohen komuniteti serb, nuk garantojnë prapëseprapë një pjesëmarrje aktive dhe konstruktive në fazat e mëvonshme, që priten të ndodhin pas statusit.

Trajtimi ekskluziv dhe në këtë dokument i nënvizuar dhe garancionet kushtetuese për komunitetin serb, mund të presim që të ngjallin edhe reagime në fazat e mëvonshme për komunitete të tjera, të cilat nuk janë përfshirë në këtë pjesë të dokumentit. Mirëpo ajo çka unë do të fokusoj, që do të mbeten sfida kryesore e këtij projekti, është shpërbërja e TMK-së dhe paragrafi për çështjen e kufirit me Maqedoninë. Do të jenë sfidat kryesore. Edhe pse është premtuar në kuadër të kësaj pakje, se kjo çështje do të negociohet, me UNOSEK-un, por praktikisht e deritanishme mund me ardhë në përfundim se, kjo çështje do të mbetet shumë e diskutueshme. Edhe anës tjetër nëse ia shtojmë kufizimet apo kornizimet juridike dhe në aspektin e strukturimit institucional këtij dokumenti, atëherë kjo mbetet një çështje mjaft shqetësuese për të ardhmen.

Kur jemi në këtë fazë dhe tash mbetet që në fazën që po hymë, ekipi i unitetit konceptualisht duhet t'i qartësojë shumë çështje, nëse është thënë mjaftë dhe është përfol për çështjen e prezencës së ardhshme të Bashkimit Evropian, mu nuk më mbetet shumë t'i shtohet kësaj, mirëpo me të vërtetë është diçka që ose ne nuk e kemi paramendua, ose prej kësaj mund me ardhë në një përfundim tjetër. Thënë troç si rezultat i krejt këtij diskutimi, pakoja e Ahtisarit nuk është ajo që e kemi pritur, por është minimumi i diçkahje, çka mund të pranohet si dokument kornizë për çështjen e zgjidhjes së statusit final të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalë e ka deputeti Nexhat Rexha, përgatitet deputeti Ragip Zekolli.

DEPUTETI, NEXHAT REXHA- Ju faleminderit kryetar, i nderuari president, të nderuar anëtarë të Grupit të Unitetit, ministra dhe kolegë deputetë!

Ne kemi mirëpritur këtë dokument të nevojshëm dhe të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës. Mendoj se është bërë mirë që edhe ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës të japim pikëpamjet tona, rreth këtij dokumenti edhe pse jam i vetëdijshëm se vështirë mund të ndryshojmë këtë dokument që vërtetë është shumë politik, e sa është juridik këtë e dinë

më mirë ekspertët me njohuri të thella, të kësaj fushe. Por sidoqoftë, ne e kemi obligim, të ndajmë mendimet tona rreth këtij projekti kapital dhe shumë domethënës për ne dhe për të ardhmen e vendit tonë. Mirëpo pritja e gjatë i ka edhe shqetësimet e veta të arsyeshme, prandaj kemi arsye edhe të brengosemi sepse kërkesat e vazhdueshme të Serbisë për shtyrje të negociatave deri në trivialitet, me qëllim që të neglizhojë çështjen e zgjidhjes së pavarësisë së Kosovës dhe për çudi edhe më tej a thua do të bie në këtë karrem, e tërë bashkësia ndërkombëtare.

E siç po shihet, nga këto skenare të politikës së Serbisë, nuk shihet qëllimi që edhe më tutje të mbetet Kosova në terr, edhe me ekonomi të varfër dhe jo funksionale për të mbetur edhe më tej popullata në skajshmërinë e varfërisë. Në tekstin e këtij dokumenti, disa nene janë formuluar mjaftë mirë, e në disa kemi shtesa të pakuptimta, unë do të ndalem në disa nga këto, neni 1. pika 1.7 ku thuhet, citoj:

Kosova do t'i ketë simbolet e veta të veçanta kombëtare, përfshirë flamurin, stemën dhe himnin,. të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj. Mendoj se pjesa e fundit pas presjes është e panevojshme, pastaj askund nuk figuron çështja e dëmeve të luftës, të shkaktuara nga Serbia në Kosovë. Është lënë anash fati i personave të pagjetur të Kosovës, dhe obligimet që duhet të marr Serbia ndaj Kosovës dhe familjarëve të të pagjeturve. Çështje tjetër që vlen të përmendet është edhe neni 4 pika 4.1 në të flitet në mënyrë të përgjithshme për refugjatët dhe personat e zhvendosur nga Kosova. Pa caktuar kohë prej cilës ose deri kur. Konsideroj se, këto çështje të shtruara në këtë mënyrë mund të krijojnë pasoja për të ardhmen e Kosovës.

Aneksi 1. dispozitat kushtetuese: neni 1.6. parashikon të drejtat e të gjithë qytetarëve të ish RFJ-së, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës deri me 1. janar 1998. nuk është caktuar afati kohor, për këtë të drejtë për të gjithë qytetarët e Kosovës, mendoj se mosafatizimi për këtë çështje krijon probleme për shtetet me traditë, e të mos flasim për Kosovën që po presim të bëhet shtet.

Aneksi 5. trashëgimia fetare dhe kulturore: neni 1.pika 2. thuhet citoj: Kosova do ta njohë Kishën ortodokse serbe të Kosovës duke përfshirë manastiret kishat dhe objekte tjera që shfrytëzohen për qëllime fetare si pjesë integrale e kishës ortodokse serbe, me seli në Beograd. Mendoj se do të duhej të kishte formulim tjetër, sepse të gjitha institucionet fetare në Kosovë, janë të Kosovës dhe selitë e tyre janë çështje tjetër dhe jo kështu siç është thënë në dokument.

Kthimi i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike, neni 6.1. teksti i parashtruar në këtë nen ka afat për Serbinë, 120 ditë, por nuk mund të thuhet se Serbia, nëse Serbia nuk i kthen këto eksponante arkeologjike me vlerë kombëtare cili është mjeti apo mekanizmi konkret për zbatimin e tij e që duhej të ishte në dokument.

Aneksi 7, puna dhe prona, prona dhe arkivi, neni 7.2. afati prej 6 muajve është i rëndësishëm, por nëse Serbia qe 7 vjet nuk i ka kthyer këto dokuemtne, vështirë se ajo do t'i përmbahet kësaj marrëveshje, pra përsëri qytetari ynë do të pësojë. Marrë në tërësi dokumenti që kemi para vetës shtron shumë çështje pozitive për të ardhmen e Kosovës

së pavarur. por njiherit ky dokument lë hapësirë dhe dilema ,si dhe sa kohë do të pritet e do të ndërrohen datat për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës. Kur dhe në ç'mënyrë do të njihet pavarësia e Kosovës, cili do të jetë vendi i Kosovës në OKB, e shumë dilema të tjera, që janë duke pritur zgjidhjen. Kush mund të thotë se në këto shtatë vite udhëheqësit politikë vendorë dhe ata ndërkombëtaë, i kanë ofruar diçka më afër se sot këtij vendi. Por procesi edhe më tej vazhdon, prandaj ka dilema.

Mirëpo kush ka njohuri më të thella të thotë se viti 2007 është vit i zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës dhe fjala pavarësi do të ngërthejë në vete gjitha dokumentet e shtetit të Kosovës. Ky propozim gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin e Kosovës i 2. shkurt 2007 të jep shumë, e të merr më shumë dhe ne duhet ta pyesim vetën si kuvendarë, çka mund të vendosim për të. Shpresoj se Ekipi i Unitetit është i vetëdijshëm për barrën e rëndë që ka mbi supet e veta dhe të këtij populli, të bartur nëpër shekuj gjatë historisë. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, po shihet se kemi filluar ta humbim durimin dalim për një kafe, 15- 20 minuta.

Pauza

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju lutemi të fillojmë punën. Sa për njoftim 35 kandidatë janë paraqitur për diskutim!

Mbledhja duhet të përfundojë sonte, nuk kemi mundësi ta shtyjmë për tjetër ditë.

Po e përsëris edhe një herë, 36 kandidatë janë lajmëruar për diskutim! Ne duhet ta përfundojmë sonte mbledhjen, rrimë sa të doni, sa të keni dëshirë, vazhdojmë, fjalën e ka Ragip Zekolli, le të përgatitet deputeti Nait Hasani.

DEUTETI, RAGIP ZEKOLLI – Ju faleminderit zoti kryetar i Parlamentit, i nderuar kryetar i Kosovës, kryeministër, ministra dhe të nderuar mysafirë!

Në këtë kohë kur po bëjmë edhe vlerësimin e pakos së Ahtisarit që është dokumenti më i rëndësishëm e që i hap rrugë shtetësisë së Kosovës, kisha dashur që të paktën të merremi me 2 – 3 gjëra të cilat nuk janë përmendur gjer më tani dhe mendoj se mund të ndryshojnë në aspektin pozitiv.

Në faqen 5 të këtij dokumenti, neni 5.1 kur flitet për personat e zhdukur, kjo gjendje ka mbetur tejet e rëndë në Kosovë, po i referohem dokumentit të Zyrës së UNMIK-ut për personat e pagjetur, që në fund të këtij viti kanë mbetur edhe 2139 persona. Ndërsa, 582 trupa të pa jetë, ndodhen në murgun e Kosovës të cilët presin analizën e ADN-së, konsiderohet që 400 deri 800 trupa janë djegur në furnaltat në Serbi dhe Kosovë. Mbetet të hulumtohet për-rreth 1200 trupa e që në këtë rast rolin më të rëndësishëm do ta luanin dëshmitarët dhe përveç tyre familjarët, të cilët duhet ende të japin analizat e gjakut. Dëshmi për këtë është i vetmi raport që gjer më tani është bërë nga bashkësia ndërkombëtare, gjegjësisht monitorimi që u është bërë të gjitha vendndodhjeve, gjegjësisht varrezave masive në territorin e vendeve të ish Jugosllavisë, e pikërisht këta ekspert kanë publikuar një punim në Sarajevë, në prill të vitit 2004, e që unë do t'ia lë në

dispozicion grupit të unitetit se vërtet flitet për një situatë tejet të rëndë dhe për gjendjen e kufomave dhe pikërisht të këtyre 1200, të pa identifikuarve si tejet të papranueshme.

Një falënderim dua të shkojë për arkeologun Gjorgj Stremberg, pastaj antropologun Mark Skinner dhe hulumtuesin e njohur arkeolog Huj Tajllër, të cilët kanë hulumtuar Batajnicën dhe anën tjetër çka është për të pasur një kujdes të veçantë në këtë punë është se më shumë se kurrë, nëse nuk do të zbardhet ky fat, atëherë do të mbetet gjithsesi pa u zgjidhur ky proces.

Sa i përket decentralizimit, në faqen 24, neni 4, flet për kompetencat e zgjeruara vetanake , ndërsa neni 4 1.1, kur flitet për komunën e Mitrovicës Veriore, thotë se do të ketë kompetencë në arsimin e lartë, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, që është në kundërshtim me të gjitha konventat ndërkombëtare.

Ndërsa faqe 26. neni 7, flet për arsimin duke përfshirë edhe nenin 7.1,2,3, dhe 4, ku thuhet se shkollat në gjuhën serbe mund të zbatojnë plan-programe dhe tekste nga Republika e Serbisë me kusht që Ministria e Arsimit e Kosovës të mund ta formojë një komision në **përbërje tre, tre një**.

Vërtet nëse përmendet ky komision edhe në këtë përbërje, 3,3,1 atëherë të japë me kuptua se komisioni parashihet me tre vetë, me ulëse rezervë në Parlament dhe të caktuar nga Ministria e Arsimit, plus një ndërkombëtar që mendoj që nuk mund të ketë lojë të mirë me lojtarë rezervë. Andaj do të ishte mirë që këtu të jetë një kujdes më i madh dhe vërtet mund të ndryshohet diçka në këtë dokument. Ndërsa Universiteti i Mitrovicës Veriore dhe zonat mbrojtëse për kishat e manastiret janë një çështje që përfshihen në dokument, mirëpo në nenin 7,2,2, është në kundërshtim me të gjitha standardet ndërkombëtare mbi arsimin e lartë, pasi thuhet se pikërisht komuna është ajo që mund të bëjë akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë. Në faqen 40. neni 4. flet për zonat e mbrojtura në Kosovë, që vlejnjë për kishat dhe objektet fetare ortodokse.

Të nderuar kolegë, në raportin e këshillit konsultativ drejtuar Kuvendit, me 31 gusht 2006. parashihen 14 zona, ndërsa në pakon e zotit Ahtisari janë të paraqitura 44 dhe manastire. Në faqen 42, të nenit 4.1. 5, nën numrin rendor 4, përmendet zonë e mbrojtur edhe manastiri i Shën Markut në Korishë, a duhet të jetë në Kabash, ku burimet e kohës tregojnë se, në marsin e vitit 1913, në oborrin e këtij manastiri janë masakruar 60 shqiptarë, kokat e të cilëve kanë rënë diku 300 metra në lumë, ndërsa në anën tjetër, përveç tyre numri i të vvarëve ka qenë rreth 102. Për shkak të kujtesës historike, është mirë ky manastir të shlyhet nga harta, sepse edhe si i tillë nuk figuron fare.

Si mund të jetë zonë e mbrojtur pikërisht një lokalitet i tillë kur është përdorur një dhunë aq e madhe e paparë e ndoshta edhe gjenocid.

Në faqen 44, të nenit 6, kur flitet për kthimin e artefakteve arkeologjike dhe etnografike, të cilat ndodhen në Serbi, përsëri po i referohem dokumentit të cilin ne e kishim në Kuvend, më 31 gusht 2006, që i është drejtuar Kuvendit të Kosovës, lidhur me bisedimet në Vjenë, për thesarin arkeologjik të Kosovës, që duhet përfshirë periudhën kohore nga

neoliti, bronzi, antika dhe mesjeta e hershme, janë marrë gjithsej 676 eksponate ,ndërsa afati i kthimit ka qenë 30, shtatori i vitit 2006. Në dokument thuhet: Republika e Serbisë, brenda 120 ditësh pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes do të kthej artefaktet arkeologjike dhe etnografike të cilat janë marrë nga muzetë e Kosovës dhe dërguar në Beograd gjatë vitit 98-99. Të paktën mendoj se këtu duhet të tregohet një vullnet! Unë këtu para vetes kam një dokument i cili pikërisht i përmban të gjitha ato dokumente dhe të paktën nëse nuk janë kthyer as me 30 shtator e ishalla kthehen po them pas afatit 6-mujor të hyrjes në fuqi të dokumentit, lutja ime do të ishte për Ministrinë e Kulturës, që të paktën ky të votohet dhe të kemi një dokument që është tejet i rëndësishëm për Kosovën, sepse në dokumentin pako vërtet paraqitet Kosova si pjesë mesjetare që në te ka vetëm kisha dhe manastire dhe nuk ka kulturë tjetër.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit,
Fjalën e ka deputeti Nait Hasani, le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.
Ju lutem edhe një minutë! - profesor nuk është ora e historisë!

DEPUTETI, NAIT HASANI - I nderuar kryetar i Kuvendit, i nderuari Ekip i Unitetit, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra,
Me vjen keq që nuk e kemi zotin Surroi këtu. Desha ta falënderoj për misionin e tij që ne si shqiptar jemi fashistë dhe na ka ndihmuar ne që kemi qenë në burxhet e Serbisë, pikërisht në atë kohë na përshëndetnin gardianët në emër të Veton Surroit.

Më në fund dhe qytetarët e Kosovës morën një paketë të Propozim Marrëveshjes për të Ardhmen e Banorëve të Kosovës. Pra dhe bashkësia ndërkombëtare dha propozimin e saj, për të ardhmen e Kosovës. Po para se të jepte këtë propozim Ahtisari që e kemi ne përpara, këtë apo kështu thuaja veçse e kishte dhënë Ekipi i Unitetit dhe këtë kishte miratuar në heshtje me dije po duke u treguar të pafuqishëm, në mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Kosovës.

Përparësi e Ekipit të Unitetit është se për gjithë kohën e bisedimeve dhe negociatave me Serbinë e bashkësinë ndërkombëtare, mundën të mbajnë në pritje e heshtje me ankthe e shpresa të mëdha se Kosova po e arrinë qëllimin final, vullnetin e popullit shumicë pavarësinë e saj.

Të gjithë politikanët po thonë se Paketa është dhe ka elemente të shtetit të Kosovës. Nëse është kështu shumë mirë dhe nëse besohet se ka këso elemente. Por këso elementesh të shtetit të Kosovës ka pasur që 15 vjet që nga Deklarata Kushtetuese e 2 Korikut dhe në vazhdimësi. Pra nëse paska elemente të shtetësisë së Kosovës, unë ju pyes juve i nderuar Ekip i Unitetit; Pse u zhvillua lufta në Kosovë dhe UÇK-ja dhe bombardimi i Serbisë nga NATO-ja, derisa paska pasur elemente të shtetit dhe për këto elemente të ashtuquajtura shtetërore ?

Unë kam një qasje e përshtypje të vlerësimit të ndryshëm të kësaj projekt-marrëveshjeje nga ju, qe e vlerësoni të arritur të jashtëzakonshme në vlerësimet tuaja. Unë në këtë marrëveshje shoh në aspektin juridik një ndarje të Kosovës në dy etnitete dhe prodhimet e të gjitha derivateve të saj, të një **zgjidhje siamike** ambiojgene mes Serbise dhe Kosovës.

Te nderuar koleg deputetë, kjo Projekt marrëveshje qe në nenin e parë bën gabimin thelbësor të ndarjes së Kosovës në dy etnitete, gjë që është gabim fatal.

Ne nenin 1 të Projekt- Paketës në dispozitat e përgjithshme mohon zgjidhjen e statusit final të Kosovës dhe neni 1.1, thotë: Kosovado të jetë shoqëri shumetnike. Pra, që në fillim Kosova nuk trajtohet drejt dhe rrezikon të ardhmen e saj. Unë insistoj forcërisht, që ashtu siç e kanë shtetet e tjera të Evropës se dhe ne jemi pjesë e Evropes, t'i bashkohemi konceptit politikë të ndërtimit të shoqërisë evropiane e në këtë drejtim, ne si pjesë e Evropës duhet që në dispozitën e përgjithshme në nenin një (1) të shkruhet: (rekomandim).

Kosova është shtet i qytetarëve të saj , pa dallim etnie, race, feje, gjinie etj. i qytetarëve të Kosovës dhe të fshihet kjo dispozite siç është, e cila në të ardhmen ka me prodhu krizë në Kosovë. Sepse si shoqëri shumëetnike, Kosova, nuk ka qenë, nuk është edhe nuk mund të jetë kurrë multietnike me këtë prbërje të popullësisë që ka tash, sepse në Kosovë jetojnë mbi 90% shqiptarë dhe më pak se 10% pakicat e tjera, si serbe 6 %, 1 % turq , 1% boshnjakë e 1% romë, egjptas e ashkali . Se në të gjitha vendet e botës, ka përqindje të ndryshme të popullsisë në shtete të ndryshme dhe nuk janë shtete multietnike , por shtete që në kushtetutat e tyre i kanë të rregulluar shtetet e qytetarëve të vendit të caktuar, e jo shtete etnike, sepse etniciteti nuk është më koncept politik i Evropës.

Popullsi kompakte me shumicë shqiptare, si në Kosovë, pra ku shumica është absolute, nuk ka askund ne botë dhe Kosova duhet të jetë shtet i qytetareve te saj. Nëse kjo nuk bëhet e ardhmja do të tregojë se kemi gabuar shumë dhe pasojat do t'i bartin politikanët e jo qytetarët e saj, sepse për kënaqje të ineresave të Serbisë, nuk duhet rrezikuar të ardhmen e qytetarëve të Kosovës.

Tjetër që kjo paket na sjellë për t'u gëzuar thuhet se në nenin 1 pika 1.5, Kosova do të gëzojë të drejtën e negociimit dhe lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të drejtën për të kërkuar anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Pra Kosova na thotë Ahtisari do të ketë mundësinë e negociimit të lidhë marrëveshje dhe të kërkojë anëtarësim në organizata të ndryshme ndërkombetare. Po unë do të pyes Grupin e Unitetit a ka vende të tjera me këso marrëveshje? Po a ka vende të tjera në këtë formë si është propozuar për Kosovën e që janë pjesë e një shteti tjetër dhe kanë mundësi vet të lidhin marrëveshje të tilla tregtare në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në asosacione ndërkombetare? Po ka dhe shumë e për më tepër hollësi të këso lloj marrëveshjesh këto i thotë profesori i marredhenieve nderkombetare Enver Hasani, tani rektor i UP- së në një shkrim të vetin,

"Hong - Kongu është një nga ato, Tajvani, ish- republikat sovjetike të Bello Rusisë dhe Ukrainës, pastaj Kvebeku në Kanada dhe kështu me radhë, janë entitete gjysmësovrane dhe kanë kapacitet të kufizuar ndërkombëtar, por që statusi i tyre është i përhershëm. Ka shumë gjasa që edhe në rastin tonë po synohet formula "një shtet, dy sisteme, ose dy juridiksione", me darjen e Kosovës dy etnicitete kjo është faktike, çfarë është rasti me Hon- Kongun.

Me fjalë të tjera për të mundësuar zhvillimin ekonomik e politik të Kosovës dhe për t'i ruajtur iluzionet e kosovarëve për pavarësi, mund të lejohet që Kosova të ketë një status gjysmë-sovran, kvazi të pavarur, duke i lënë mundësinë e anëtarësimit të kujdesshëm të Kosovës nëpër disa institucione ndërkombëtare, kryesisht financiare, si dhe marrja e kredive për zhvillim ekonomik të Kosovës" Kjo është formula që e ka planifikuar Ahtisari që Kosova të ketë të drejtën të marrë kredi ,por të mos jete sovranë.

Ndërsa në 1 pikë 1.6 thotë: Gjuhë zyrtare në Kosovë do të jenë gjuha shqipe dhe serbe. Në këtë pikë janë futë standarde të dyfishta nga Marti Ahtisa, sepse gjuha serbe me 6 % është gjuhë zyrtare në tërë territorin e Kosovës, ndërsa në shtetin fqinj në Maqedoni, ata që e kanë përjetuar dhe e kanë parë , e dinë, atje jetojnë një popullsi me 29 % shqiptare dhe vlerësimi është që 20% e popullsisë duhet flas gjuhen për me qenë gjuhë zyrtare në ato komuna.

Nuk ka gjuhë zyrtare në gjuhen shqipe në tërë territorin e Maqedonisë, por shqipja është gjuhë zyrtare në ato komuna ku popullsia e asaj komune ka 20 %, të folësve të asaj gjuhe. Pra kjo pikë në këtë Paketë të Ahtisarit me 5% të popullsisë serbe në Kosovë, e shpall gjuhë zyrtare në tërë territorin e Kosovës dhe atje ku nuk ka asnjë serb, është diskriminim negativ, politik i konceptit evropian mbi gjuhën.

Neni 1, paragrafi 1.8, i kësaj Paket -marreveshje thote:

Kosova nuk do të ketë pretendime territoriale ndaj asnjë shteti apo pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë bashkim me asnjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti. Ky është një nen i paqarte në vetë, sepse në asnjeher nuk kemi pas pretendime territoriale ndaj askujt, ndaj asnjë shteti, sepse vet kemi qene të shtypur nga Serbia. Dhe paragrafi në fjalë nuk e shpëton Kosovën nga Serbia ai e le Kosovën ende pjesë të Serbisë, sepse kjo shpjegohet se Kosova si pjesë e Serbisë nuk do të kërkojë të shpëtohet nga Serbia dhe as të bashkohet me asnjë shtet tjetër dhe të mos ketë qellime territoriale ndaj asnjë shteti tjetër.

Neni 7 paragrafi 7.2 . i kësaj marrëveshje thotë :Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë (KOS), përfshirë klerin dhe pjesëtarët aktivë, aktivitetet dhe pronat e saj do t'u ofrohen siguri shtesë dhe masa të tjera mbrojtëse për gëzimin e plotë të të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të tyre, siç parashihet me aneksin V të kësaj Marrëveshjeje.

Ky nen për Kishën Ortodokse serbe dhe përshkrimi në aneksin e tij është me pasoja kulturore për qytetarët e Kosovës. Ahtisari me këtë nen si qytetarë të Kosovës, na ndalon që të jemi pjesë e zgjedhjes së besimit dhe na ndalon të hyjmë në Kishë ortodokse. Ai i ndan fen ortodokse serbe, po në kemi dhe mjaftë ortodoksë në Kosovë, që nuk janë serbë, a thua duhet të ndërtojmë kisha të tjera ortodokse për ta? Në këtë rast Ahtisari i ka bashkuar Serbinë dhe popullin serb me kishën ortodokse. Në bazë të parimit të besimit thotë se kisha është e gjithë qytetareve të atij besimi që i takojnë në atë vend. Al thotë se nuk është zyrtare asnjë fe, në Kosovë ndërsa Kishën Ortodokse e vendos në fe zyrtare.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Nait nëse vazhdojmë kështu ndërhyrje 10 minuta i ke harxhuar, sa duhet, polemikë, mund ta shfrytëzoj edhe një minutë!

Kisha ortodokse duhet të jetë kishë e qytetarëve të Kosovës e jo kishë serbe. Ata që e ndien veten ortodoks le të shkojnë në atë 15% ose këtë kishë, pra Ahtisari e ndan dhe zotin për shqiptarët dhe serbët. Dhe më tej Ahtisari lejon dhe privilegje ekonomike, heq nga tatimi dhe dogana jep imunitet të paprekshëm nga të gjitha organet qeverisëse të Kosovës, lejon menaxhimin e pronave të veta pa i dhënë llogari askujt, asnjë organi, veç Serbise dhe pranon donacione nga Serbia, lejon zonat e mrojtura të kishave dhe manastireve të cilat janë në dëm të zhvillimit të Kosovës.

Pakete- Marreveshja parasheh në nenin 6 për TMK-në, në paragrafin 6.1 ku thotë : TMK-ja do të shpërbëhet. **PUN, në konsultim me PCN-në dhe** Kosovën, do të ushtrojë mbikëqyrje ekzekutive të TMK-së, dhe do të vendosë rreth kohës së shpërbërjes së saj. Shpërbërja do të bëhet brenda një viti të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Procesi i demobilizimit dhe i ri-integrimit do të zhvillohet nga bashkësia ndërkombëtare për këta pjesëtarë të TMK-së. Pakete-Marreveshje thotë të shkaperderdhet TMK ja, sepse e ka kry misionin e saj stabilizues. Dhe thotë se këta oficerë e ushtarë të TMK-se që kanë shërbyer për sa vjete rreshte të dalin në rrugë se nuk na duhen më.

Po a e di Grupi i Unitetit apo Ahtisari se pa këta djemë të radhitur dhe në Ushtrin Çlirimtare të Kosovës, sot në TMK, nuk do të kishte liri në Kosovë dhe këta janë krenaria e Kosovës dhe frymë e gjalle e jetes së lire në Kosovë. TMK ja ka mundësi të transformohet në Forcë të Sigurisë dhe duke e kaluar testin profesional, por të shpërbehet TMK-ja, është e rrezikshme, sepse kjo është shkëputje nga e kaluara jonë nga ato vlera tona të shenjta të krijuara me gjak.

KRYETARI, KOLË BERISHA - I vazhdohet edhe një minutë.

Vazhdim:

Mendoj se nuk do të ketë politikanë e ekip që do të marrë guximin me marrë vendim me shpërndarje TMK-ne. Ata që do të marrin guximin me be këte veprim, do të lujnë me të kaluarën e ndritshme e trashëguese të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si trashëguese e saj e drejtperdrejtë- TMK-ne.

TKM-ja mund të shndërrohet në forcë të sigurisë, por të shpërbehet nuk do të jete e drejte as politike e as historike. Në nuk do të heqim dorë nga e kaluara jonë e ndritur e UCK-se e transformuar në TMK. Kjo pikë e kësaj marrëveshje duhet të hiqet dhe as që duhet të diskutohet. TMK ka qenë Ushtri Çlirimtare e Kosovës dhe do të jetë Ushtri e Kosovës. Ushtrinë Çlirimtare Shqiptarët nuk e kanë krijuar nëpër kabinete, por ajo është krijuar nëpër betejë për çlirim të Kosovës nga Serbia dhe shkatërrimi i saj do të thotë të heqësh dorë nga e kaluara jonë çlirimtare, do të thotë të heqësh dorë nga flijimi biblik i Jasharajve dhe i komandantit legjendar, Adem Jashari.

Ndërsa mjerimi politik ne skenen politike te ne eshte se ajo çka nuk eshte e pranueshme per serbin eshte e mire per ne. Kjo tregon se serbia me qellim politik dhe me nje strategji afatgjate ka arrite te mbaje Kosoven perseri pjese te veten te sanksionuar me nje marrveshe politike nga bashkesia nderkombetare me Paketën e Ahtisarit. Per Kosoven e qytetarët e saj, përderisa nuk sanksionohen fjalët në këtë projekt marrëveshje: sovranitet e pavarësi per shumicen shqiptare të Kosovës, eshte e papranueshme, sepse në të kundërtën çon në lidhje me Serbine , .Prandaj në fund të nderuar deputetë , Ekipi i Unitetit çdo lidhje me Serbinë do te thotë prodhim krizash të reja në Kosovë e rajon.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori,

DEPUTETI, EMRUSH XHEMAJLI – Zoti president i Kosovës, zoti kryetar i Kuvendit, kolegë deputetë, zotërinj të Ekipit Negociator, ju përshëndes të gjithëve!
Subjekti që përfaqësoj Lëvizja Popullore e Kosovës, e ka shqyrtuar tekstin e propozuar nga presidenti Ahtisari, me vëmendje i kemi përcjellë dhe qëndrimet që janë mbajtur, lidhur me te, para kësaj seance dhe gjatë kësaj seance, nga deputetët dhe pajtohem me vërejtjet esenciale, që kanë lidhje me pakon.

SEANCA PLENARE E 9.2.2007

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI - Zonja dhe zotërinj. Në nëntor të vitit 2006 me kërkesën e Serbisë është shtyrë dalja me propozimin gjithëpërfshirës që po e trajtojmë tash. Ndërkohë tepër natyrshëm shumë deputetë kemi kërkuar që ju Ekipi Negociator i Kosovës të vini dhe të jepni informata ose raport si do që ta quani, para këtij Kuvendi që ju ka zgjedhur, ose që keni dalë nga ky Kuvend, por ju e dini se zotërinjtë e Grupit Negociator i ikën përgjegjësisë dhe nuk patën pranuar të vijnë këtu. Sot kur është koha që të diskutohet se çka duhet bërë më, më tepër se kaq, Ekipi Negociator ka ardhur dhe në një formë në fillim të kësaj seance raportoi, edhe pse u përfshinë në disa fjalime emotive. Por ky raportim megjithatë e pranojmë ishte spontan, kanë ardhur pa kurrfarë përgatitje të përbashkët me shkrim dhe pa kurrfarë propozimi për Kuvendin.

Megjithatë, edhe kështu unë e pranoj këtë raport të tyre si të tillë në dritën e pakos së Ahtisarit, se këtu nuk kanë ardhur si deputetë, por si ekip dhe e vlen që të ndalet në disa pika në të cilat ata u ndalën. Ata sot erdhën këtu sepse kanë bindjen e plotë se puna përfundoi dhe qëllimi u arrit ,por në fakt nga diskutimet e deritashme u panë të meta nga të cilat kanë mundur të evitohen, po të vinin me kohë të tregonin se ku kanë vështirësi edhe pengesa më tepër dhe ku duhet të ndihmohen, sepse edhe Kuvendi ka mundur diçka të ndihmojë. Por ata patën zgjidhur metodën e anashkalimit të Kuvendit dhe për këtë mbajnë dhe do të mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e disa pjesëve të pakos pasi siç tha në raport z. Surroi, se në disa pjesë është bashkautor edhe Ekipi Negociator.

Z. presidentë tha se pakoja e Ahtisarit e çon vendin në pavarësi dhe në sovranitet. Pakoja u tha edhe këtu, nuk thotë ashtu dhe aspak nuk përmendet as fjala pavarësi edhe nuk është serioze të komentohet në këtë formë pakoja e Ahtisarit. Unë e ftoj z. president që të punohet me përkushtim në formë tjetër nga kjo që keni punuar që vërtet të ndodhë si ka dëshirë Kosova.

Gjithë folësit që këmbëngulën në atë që dëshirat e mira t'i shndërrojmë në bindje dhe Kuvendit të Kosovës edhe të popullit, mendoj se nuk ndihmojnë gjë, përkundrazi, paraqesin përhapjen e iluzioneve.

Z. negociatorë nga sjelljet tuaja jotransparente shumica e qytetarëve të Kosovës janë befasar, ndërsa janë të shqetësuar për fatin e vendit me ato që kanë parë në Pakon e Ahtisarit, prandaj, ata edhe kanë thirrur me organizimin e Lëvizjes së Vetëvendosjes-protestë nesër në orën 14 kundër kësaj çka po ndodh sot, jo vetëm qytetarët, por edhe Kuvendi është i shqetësuar. U pa edhe nga diskutimet e deritashme, u pa edhe nga fakti, se pasi foli presidenti i Kosovës askush nuk duartrokiti, megjithëse ai nuk tha diçka të paktë, ai tha se fituam pavarësinë dhe sovranitetin, por a e di çfarë entuzazmi do të shpërthente në Kuvend ose jashtë tij sikurse ne të ishim bindur vërtet për këtë. Në raportimin e tij fillimisht ishte shumë i matur z. Thaçi. Substanca e pavarësisë dhe sovranitetit -tha ai -është në Pakon e Ahtisarit, jo krejt në hava si presidenti, por më vonë e mbuluan emocionet dhe pasaktësitë gjatë pjesës së fjalimit që çonte deri në ekstatë. Edhe unë them të drejtën u emocionova dhe prita se tash deputetët duhet të **trokasin**, por as kjo nuk ndodhi. Si duket drojën e deputetëve dhe të popullit e ka kuptuar shumë ma mirë z. Surroi. Ai në paraqitjen e tij tha: Nuk duhet të kemi frikë nga Pakoja e Ahtisarit, Pakoja ajo vetëm flet kalimthi për pavarësi, nëse nuk gabojmë kështu me u shpreh, dhe në këtë mënyrë e mohoi presidentin, por edhe Thaçin, që në fillim thanë se në pako është pavarësia, pavarësisht substanca e tij. Z. Surroi në raportin apo paraqitjen e tij si ta merrni shtoj se Serbisë me pako po i merret sovraniteti dhe me sa më kujtohet më tha pronarit Kosovës, por në pjesën e fundit e mohoi me të drejtë vetë ai dhe doli ashtu si është me të vërtetë, pakoja nuk sqaron, Ç'u bë, ku mbeti sovraniteti i Serbisë, u hoq apo s'u hoq, kjo mbetet për t'u interpretuar, por është e qartë se së paku edhe për disa vite sovraniteti i Kosovës do të kalojë nga UNMIK-u te misioni i ardhshëm ndërkombëtar.

Madje ju përgëzoj z. Surroi vënien në pah të të metave katastrofike për Kosovën që ka misioni i ardhshëm ndërkombëtar. Ajo që tha në fillim presidenti Sejdiu se gjoja kemi të bëjmë me një emision të lehtë ndërkombëtar, e hodhi në tokë z. Surroi duke deklaruar se në Kosovë do të ketë instrumente të forta të pranisë ndërkombëtare. Besoj e citova saktë.

Pajtohem plotësisht me atë që tha Thaçi lidhur me luftën çlirimtare 20- vjeçare të popullit tonë dhe pajtohem gjithë dhe nuk pajtohem aspak me pjesën vetakuzuese të fjalimit të tij që mbajti Surroi. Nuk mund të ndiqet politika e një ore e balancimit të krimit të organizuar, po them krimit të organizuar shtetëror të Serbisë nga viti 1912 dhe veçanërisht nga viti 81 me krimet individuale që fatkeqësisht kanë ndodhur krime individuale të pa organizuara që ndodhen në Kosovë pas hyrjes së NATOS. Aq më pak të bëhet përgjegjës populli i Kosovës lidhur me to kur nuk ka pasur kompetenca të sigurisë

që i dimë të gjithë. Dhe çdo raportim i OSBE-së që u cek këtu është vetëm për ta hequr fajin nga vetvetja, nga përgjegjësia që kanë pasë ata që kanë pasur përgjegjësi për siguri dhe hedhjen e fajit pa adresë te populli i Kosovës.

Madje këtu u tha për shkak të këtyre krimeve individuale ka pasë dënim kolektiv për Kosovën me moskalim të kompetencave dhe me dhënien e lirisë për Kosovën. Nëse kështu jeni duke e mbrojtur Kosovën në arenën ndërkombëtare, mos u mundoni s'ka nevojë.

U tha zotërinj se kemi mundur të bëjmë flamurin vetë. Flamurin kombi ynë e ka bërë dhe do të jeni dëshmitarë se populli ynë kurrë nuk ka qenë i interesuar dhe ka munguar vullneti të ndryshojë atë dhe ta bëjë një flamur të ri, këtu është esenca pse s'e kemi bërë flamurin.

Flamujt tranzitorë që u janë imponuar shpesh Kosovës do të imponohen, kjo po duket, por kjo do të jetë e përkohshme. Flamuri do të na imponohet sikurse na u ka imponuar ndarja prej Shqipërisë në 12-të dhe si po na imponohet jeta e ndarjes nga Shqipëria dhe pa e pyetur fare vullnetin e popullit me format demokratike në të cilat zakonisht thirremi kur marrim vendime aspak demokratike. Këtu unë nuk po ndalem te votimi i dyfishtë për të cilin u fol me të drejtë këtu as për të metat në fushën e të drejtave themelore të njeriut për të cilat folën Grupi 6+, Grupi për Integrim dhe shumë deputetë me shumë të drejtë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, le të përgatitet deputetja Naxhije Doçi. Një minutë.

EMRUSH XHEMAILI – Për mendimin tonë, megjithëse ka hapa përpara në njohjen e realiteteve në Kosovë, propozimet që bëhen në pako janë tepër larg asaj që është kërkuar nga shumica e qytetarëve të Kosovës dhe çka i takon vendit tonë. Në tekst është lënë mundësia e interpretimit pasi gjërat nuk thuhet aartë dhe shprehimisht. Kuvendi i Kosovës duhet të dalë nga këtu me rekomandime. Nuk është klub i hokatarëve ose çka po di unë shoqëri kulturo-artistike me folë e mos me bërë asgjë, duhet të dilet me rekomandime. Ju faleminderit

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari president Sejdiu i nderuari kryetar i Kuvendit, Berisha, kryeministër, anëtarë të Ekipit të Unitetit, ministra kolegë deputetë.

Nuk e besoj që prej ekzistimit të Kuvendit të Kosovës në periudhën e pas-luftës, flas që ky Kuvend ka pas një rast ose një material më të rëndësishëm dhe më serioz sesa këtë që sot po e debatojmë bashkërisht dhe dokument i cili ka rrjedhë si rezultat i angazhimit të madh në periudhat e gjata kohore i të të gjithë neve. Unë e konsideroj këtë dokument si një kalim i pragut të nevojshëm që populli i Kosovës të marrë sovranitetin mbi Kosovën dhe institucionet e Kosovës po ashtu.

Në këtë drejtim unë çmoj angazhimin e të gjithëve edhe të Ekipit të Unitetit me kërkesën që të vazhdohet më tutje përmirësimi i dokumentit të cilin sot po e analizojmë

bashkërisht. Në këtë drejtim, më lejoni që të përmend disa çështje të cilat mendoj se Ekipi i Unitetit duhet të ketë një koncentrim, një fokusim më të madh në periudhën në të cilën po hyjmë, si ta quajmë qoftë të konsultimeve apo të negociatave të cilat do t'i marrim.

E para, nëse referohemi aneksit 1 neni 3.3.7 dhe pikës, përkatësisht nenit 10 pikës 10.1 do të shohim se këtu do të kemi një problem të kuptimit të funksionimit të Kuvendit të Kosovës dhe të miratimit të Kushtetutës të Kosovës në bazë të asaj çka është thënë në këto dy nene, përkatësisht që e rregullojnë funksionimin e Kuvendit dhe miratimin e Kushtetutës.

Nëse arrijmë të përmirësojmë një mekanizëm në këtë drejtim unë mendoj që Kuvendi i Kosovës nuk do të hasë në probleme dhe në pengesa të caktuara për të mbetur peng i vullnetit dhe i dëshirës së caktuar.

Çështja e dytë ka të bëjë me financat lokale, e cila është elaboruar në aneksin e tretë dhe kryesisht ka të bëjë me financimin e komunave.

Të nderuar deputetë, është krejt normale që komunat të mbledhin të hyrat e veta, është normale që të kenë edhe financime nga donacione qendrore, po të ketë edhe donacione nga dikush tjetër. Mirëpo më duket se nuk është shumë e qëndrueshme që komunat të cilat kanë kompetenca të zgjeruara vetanake tani përsëri të marrin buxhet shtesë nga buxheti qeveritar. Këtë duhet parë dhe mendoj se një përmirësim në këtë drejtim do t'i verë në pozitë të palakueshme komunat e caktuara. Me fjalë të tjera, duhet të vlejë një parim unik i cili në bazë të kriterëve të përcaktuara nga institucionet e vendit do të financojë komunat në tërësi, jo me një ndarje që në këtë rast do të ketë një mbështetje, përkatësisht një ndarje të komunave në baza etnike.

Çështja e tretë ka të bëjë me borxhet e Kosovës. Kosova do të marrë për sipër ato borxhe të cilat janë të dedikuara për shfrytëzim final në Kosovë dhe në periudhat e caktuara kohore. Sigurisht se nuk do të jemi në gjendje për të marrë borxhin e krijuar në emër të Kosovës ndoshta në periudhën 90-99, sepse mund të jetë përdorur për arsye të caktuara, kurse Kosova do të adresojë ato borxhe të cilat kanë ndihmuar zhvillimin ekonomik të vendit dhe që do të definohen realisht. Mirëpo këtu dokumenti duhet të përmbajë edhe diçka tjetër. Çka në të vërtetë? Kompensimet që duhet t'i bëjë Serbia karshi Kosovës, qoftë për kompensimet individuale dhe kolektive, kompensimet që kanë të bëjnë me dëmet e luftës, pastaj fondet e ndryshme si dhe kompensimet që kanë dalë nga shfrytëzimi i ekonomisë kosovare në periudhën 90-99 si rezultat i masave të dhunshme në ekonominë e Kosovës.

Çështja tjetër, të nderuar deputetë, janë zonat mbrojtëse. Ne kemi Ligjin për trashëgiminë kulturore, nuk e di pse kjo marrëveshje nuk i referohet këtij ligji për të rregulluar zonat mbrojtëse, meqë është e nevojshme ose meqë themi se është e nevojshme për të mbrojtur manastiret. Ligji i rregullon këto çështje në mënyrë të mirë dhe nuk do të ishte e nevojshme të konceptohet në këtë formë, si është thënë. Unë po jua japi vetëm një shembull konkret. Nëse kam pas rast ma shumë të merrem me këtë çështje, nëse i

referohemi manastirit, si po quhet i Sokolicës në Buletin të Mitrovicës, të nderuar kolegë, thjesht aty kemi jo më larg se sa vetëm rruga që i ndanë pjesën që ka të bëjë me pronat e familjes Buletini, përkatësisht të monumentit dhe të asaj që është restaurua dhe nëse në këtë drejtim do të shkohet këto zona do të konsiderohen në këtë formë sikurse që janë, pjesa që ka të bëjë me kullën e Isa Buletinit, do të hyjë në zonë mbrojtëse.

Merre me mend aktivitetet të cilat janë të parapara tash që nuk mund të lejohet të zhvillohen brenda zonave mbrojtëse, familjarëve të Isa Buletinit nuk do t'u lejohet një tubim publik para se të marrin pëlqimin e Kishës Ortodokse Serbe dhe të komunës në këtë rast që ka të bëjë monumentin .

Çështjen tjetër do ta adresoj çështjen e kufirit. Të nderuar kolegë, ky Kuvend ka reaguar me rastin e nënshkrimit të një marrëveshjeje që është bërë më herët në mes të ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe RSFJ-së. Ne nuk kemi mandat të pranojmë diçka tjetër dhe nëse e shohim këtë amendament si është rregulluar në këtë formë, marrëveshja nuk lejon të bëjmë ndryshime në pjesën që ka të bëjë me demarkacionin. Prandaj mendoj se në këtë drejtim duhet të fokusohemi më shumë dhe ka vend për përmirësime. Dhe e fundit.

Forca e sSigurisë së Kosovës. Pa dyshim se njëri nga segmentet më stabile në Kosovë në periudhën e pasluftës ka qenë TMK-ja që duhet të jetë bartëse e ndërtimit të forcës së re edhe me strukturën organizative, por edhe me komponentët e tjerë që e bëjnë një forcë mbrojtëse në përgjithësi. Natyrisht duke freskuar radhët e saj edhe në efektivin aktiv edhe në efektivin rezervë nëse është e nevojshme. Nuk besoj se mjetet buxhetore do të jenë problem për një forcë të sigurisë sikurse është TMK-ja. Unë besoj se do të kemi angazhime të përbashkëta edhe në të ardhmen. Ju faleminderit të gjithëve.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit!. Fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi, le të përgatitet deputeti Hajredin Kuçi.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – I nderuari kryetar i Kosovës z. Fatmir Sejdiu, i nderuari kryetar i Parlamentit të Kosovës z. Kolë Berisha, i nderuari kryeministër i Kosovës z. Agim Çeku, të nderuar ministra, i nderuar Grupi i Unitetit, kolegë të nderuar deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë.

Propozim- projekti për marrëveshje për statusin e Kosovës i diplomatit Ahtisari vlerësohet si i arsyeshëm dhe si i suksesshëm nga faktorët ndërkombëtarë që do të marrin drejtëpërsëdrejti pjesë në zbatimin e tij. Finalizimi i këtij dokumenti do të bëhet kur të dorëzohet dhe kur të miratohet në Këshillin e Sigurimit. Përkrahësit ndërkombëtarë të marrëveshjes argumentojnë se zgjidhja e statusit të Kosovës do t'i japë fund çështjes së pazgjidhur të saj që nga koha e shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Kjo zgjidhje është në interesin e të gjithëve në Kosovë dhe ofron zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme edhe në Gadishullin Ballkanik.

Edhe në Kosovë propozimdokumenti i z. Ahtisarit është vlerësuar pozitivisht se nëpërmes këtij kemi mundësi për arritjen e një objektivit tonë e që është pavarësia e

Kosovës dhe bërja e Kosovës shtet për të gjithë qytetarët e saj. Mbështetja e fuqishme nga Bashkësia Evropiane dhe nga SHBA-të për dokumentin u hap rrugë Kosovës dhe qytetarëve të saj për realizimin e aspiratave qenësore të tyre dhe për kurorëzimin e përpjekjeve tona të vazhdueshme për liri, për pavarësi dhe për një shoqëri të shëndoshë demokratike të inkuadruar në Bashkësinë Evropiane dhe në NATO.

E vë Kosovën drejt rrugës së pavarësisë dhe drejt bërjes së shtetit me të gjitha kërkesat e funksionalizimit të tij, krijon mundësi drejt ribërjes së hartës së Ballkanit të bërë dhunshëm dhe qëllimshëm dikur keq ishte e pa drejtë dhe shumë e dhimbshme ajo kohë e fillim të shekullit XX për ne shqiptarët e Kosovës, e edhe më gjerë. Ky dokument përfundimisht e shkëput Kosovën nga kthetrat e përgjakshme nga sovraniteti i Serbisë pushtuese dhe me synime shfarosese për ne. Duke u mbështetur në këtë presim që mbështetja e Bashkësisë Evropiane të ndikojë fuqishëm që ky proces të kryhet sa më shpejt, kjo do ta qetësonte përgjithësisht situatën në Kosovë.

Statusi i zgjidhur i Kosovës do të hapë rrugë edhe për zhvillimin e ekonomisë së saj të brishtë, ngase ndër të tjerat do të mundësojë edhe për financimet ndërkombëtare në te. Projektdokumenti në brendinë e vet ka dispozita që meritojnë vlerësim pozitiv dhe që janë inkurajuese për ne, sepse përcaktojnë konturat e një shteti të mirëfilltë. Mbetet obligim i institucioneve të Kosovës ta ndërtojnë një vend me ekonomi të zhvilluar. Në të mund të them se ka vend edhe për shqetësime nga ana e popullit për shumicën shqiptare edhe nga të tjerët popuj që jetojnë në Kosovë dhe që janë joserbë. Këto shqetësime janë sidomos për çështjet specifike dhe të ndjeshme. Kujtoj se ne duhet të llogarisim se ky është një proces dhe si i tillë në një të ardhme të shkurtër mund të avancohet për të mirë, si për ne shqiptarët, ashtu edhe për të gjitha komunitetet e tjera në Kosovë me të cilët do të bashkëjetojmë në mirëkuptim dhe në harmoni të plotë, Zaten shqiptarët e Kosovës asnjë herë nuk kanë hezitur për t'i përkrahur dhe për t'i respektuar komunitetet e tjera, qoftë si fqinj të tyre, qoftë në vendin e punës, apo kudo tjetër, se një dhunti të tillë e kanë kulturë të trashëguar.

Edhe në botë janë të njohura bujaria dhe besa shqiptare për mikun dhe për fqinjin, qoftë i përkatësisë së vet, qoftë edhe i komunitetit tjetër. Bile në raste të veçanta për komunitete të tjera ndoshta ka pasur konsideratë edhe më të dalluar. Jemi të vetëdijshëm se projekt propozimi në fjalë nuk mund të pësojë ndryshime të mëdha nga ajo çka është paraparë në të. Përkundër punës së pakursyer të Grupit të Unitetit dhe përkundër punës që po e bëjmë edhe ne si deputetë sot. Duke qenë të bindur se ky dokument do të jetë i mirë por edhe që është i mirë, ne duhet ta zbatojmë dhe ta avancojmë punën tonë me përkushtim. Ky është obligim ynë. Jemi shumë të vetëdijshëm se ishim një enigmë, por edhe krejtësisht e harruar si për Evropën ashtu edhe për botën, si Kosovë dhe përgjithësisht si popull shqiptar në të, se nuk na linte hapësirë njohjeje për të mirë, por për të keq- pushtuesi shumëvjeçar serb.

Me angazhimin tonë të pandalur dhe të mençur nëpër vite e sidomos gjatë dhjetëvjetëshit të fundshekullit XX kur ishim të organizuar si lëvizje në ballë të së cilës ishte presidenti historik dr. Ibrahim Rugova, ne arritëm ta dokumentojmë realitetin tonë, arritëm ta tërheqim vëmendjen e botës demokratike kah ne. Për të gjitha të mirat që i kishim, për

virtutet, për cilësitë, por edhe ta dokumentojmë realitetin për padrejtësitë që na bëheshin dhe për vuajtjet tona në një pushtim të hekurt dhe të dhunshëm. Bindja pozitive e botës për ne ishte arsye e luftës që bëri NATO me Serbinë në vitin 1999, kur NATO kërkoi nga Serbia përfundimin e shtypjes së shqiptarëve dhe të gjithë popujve të tjerë joserbë. I detyroi forcat që të tërhiqen nga Kosova. Se dokumenti është i mirë, nuk ka dyshim, por megjithatë nuk do të krijojmë euforitë e tepruara, vetëkënaqësie se megjithatë ka disa elemente të brendshme që ndoshta edhe do të mund të ishin më mirë.

Shpresojmë se në një fazë implementimi, realiteti me siguri do të shkojë kah e mira. Në këtë kontekst do t'i kisha dhënë disa plotësime të mundshme sipas neneve p.sh. në nenin 7.2 theksohet: Kishat ortodokse Serbe në Kosovë, mendoj se duhet hequr termi serbe, sepse kishat në Kosovë janë trashëgimi kulturore e përgjithshme e jo vetëm serbe dhe kjo i ngjan edhe thënies sikur të thonim: Xhamitë myslimane turke e tjera janë të shqiptarëve.

Në nenin 8 ku bëhet fjalë për borxhe, ekonomi dhe pronë, propozoj që të shtohet edhe një nen tjetër dhe të theksohet: Serbia duhet t'i paguajë Kosovës dëmshpërblimin e luftës së fundit 1998-99 për vrasje dhe për zhdukjen rreth 12 mijë banorëve shqiptarë, për djegien e mijëra shtëpive të tyre dhe për shkatërrimin e pasurisë shoqërore, për aparteidin e okupimit klasik të bërë në dëm të shqiptarëve dhe të popujve të tjerë joserbë, sidomos gjatë dhjetëvjetëshit të fundshekullit XX të kaluar, duke i mbyllur shkollat dhe fakultetet në gjuhën shqipe, duke përjashtuar nga puna me mijëra punëtorë shqiptarë në të gjitha institucionet dhe duke bërë tortura, masakra dhe gjenocid kundër popullit shqiptar dhe kundër komuniteteve të tjera joserbe në Kosovë.

Në faqen 13 neni 3, në faqen 17 paragrafi 7.2 e gjetiu në këtë dokument ku thuhet: Komuniteti shumicë, mendoj se duhet të zëvendësohet me sintagmën : komuniteti shqiptar, apo populli shqiptar, sepse derisa përmenden të gjitha komunitetet e tjera si serb, rom, ashkali, egjiptas, goran në Kosovë askund nuk përmendet populli shqiptar.

Në nenin 6 faqe 16 paragrafi 6.2 ku theksohet: Dhjetë apo më shumë deputetë të Kuvendit, mes tjerash, do të kenë të drejtë të kontestojnë ligjshmërinë e çfarëdo ligji, si edhe ku bëhet fjalë për përbërjen me anëtarët e disa komisioneve kujtoj se duhet saktësuar vetëm kur kemi të bëjmë me komuna ku ka edhe serbë e jo për të gjitha komunat e Kosovës. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari kryetar i Kosovës, kryeministër, z. Surroi, zonja dhe zotërinj.

Njerëzit më legjitimë dhe vendi më legjitim në botë që duhet të flasë lidhur me dokumentin e Ahtisarit janë Kosova dhe populli i saj, por besoj që ky Kuvend është ma legjitim që duhet të japë mendimin e vet. Është krejt normale që për dokumentin ka dilema dhe ka optimizëm. Që në fillim do të thosha që dokumenti i Ahtisarit për aq sa

kuptoj unë është në mes të atyre që mendojnë që kanë dilema dhe në mes të atyre që kanë optimizëm. Një gjë e mirë e përbashkët e të dy palëve është se edhe ata që kanë dilema për dokumentin edhe ata që kanë optimizëm për dokumentin, e kanë një pikë të përbashkët. Të dy palët e dëshirojnë Kosovën, shtet sovran dhe të pavarur, i cili funksionon si shtet normal dhe modern. Normalisht ata që kanë dilema mund të thosha që kanë të drejtë ngase për Kosovën dhe fatin e tyre kanë të drejtë që të interesohen të gjithë njerëzit që jetojnë në te, apo e kanë ndërmend që të jetojnë, duke mos përjashtuar edhe ata që kanë ëndërruar me jetuar këtu. Por ata që kanë optimizëm po ashtu, kanë të drejtë se njeriu duhet ta mbështesë besimin e vet dikund, dhe besimi i tyre duhet të mbështet te njerëzit të cilët ma herët kanë bërë diçka për këtë vend, të cilët kanë kontribuar qofshin vendorë apo ndërkombëtarë . Në fund do të thosha a ka alternativë tjetër që të mos i besohet dikujt?

Lidhur me këtë pako unë do të thosha që duhet të trajtojë dy gjëra, dinamikën e procesit dhe përmbajtjen. Sa i përket dinamikës ne duhet ta theksojmë se shpeshherë dinamika s'është përcaktuar nga ne, për të mos thënë nga të tjerët dhe në veçanti nga bashkësia ndërkombëtare.

Besoj se gjatë vitit të kaluar për dy gjëra bashkësia ndërkombëtare ka ardhur në përfundim .

E para, marrëveshja eventuale në mes Kosovës dhe Serbisë është e pamundur dhe e dyta çdo zgjidhje më pak se pavarësia e Kosovës po ashtu është e pamundur. Në këtë drejtim mendoj se shtyrjet e tilla, dilemat e tilla, krijojnë energji dhe po e them në një ose mënyrë tjetër krijojnë edhe dilema të shtuara.

Lidhur me përmbajtjen unë do të orientohe në dy gjëra, në atë çka ka pakoja e Ahtisarit dhe në atë çka i mungon kësaj pakoje. Lidhur me atë se çka ka pakoja ose brenda pakos mund t'i bëjmë shumë vërejtje dhe u përmendën shumë vërejtje me arsye edhe me të drejtë. Për mua edhe si juristë është paqartë do ta quajë brishtësia politike dhe juridike e statusit të Kosovës. Unë jam shumë i interesuar të shohim më qartë raportin në mes institucioneve qendrore dhe atyre lokale. Raporti në mes institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare do të ishte me rëndësi që të shohim se si institucionet jashtë shtetit të Kosovës interferojnë në punën e institucioneve të Kosovës, në veçanti duhet të diskutojmë apo t'i mendojmë kompetencat e shtuara për fushat e caktuara në nivel të pushtetit lokal apo të diskriminimit që e quajmë ne pozitiv për minoritetet. Është krejt normale që ne në një ose në një mënyrë tjetër jemi pajtuar që minoritetet të kenë të drejtë afirmative si e quajmë ne, por është krejt normale që ne të kërkojmë që të drejtat e minoriteteve të kufizohen me dy gjëra: E para që të mos i pengojnë të drejtat e shumicës në Kosovë dhe e dyta, që të mos e pengojnë funksionimin normal të institucioneve të Kosovës dhe në këtë drejtim mendoj se gjërat e tjera nuk ka nevojë të diskutohen. Një e veçantë e saj është kompetenca po e them që janë të stërshtuara në sferën sigurisë, në sferën, do ta thosha, të legjislacionit dhe në sferën financiare.

Është krejt normale që emërtimet që janë bërë në kuptimin juridiko-politik po e them nuk janë shumë adekuate. Unë nuk mendoj që Kosova duhet të jetë vend ku ka

komunitete, Kosova ka pakicë dhe shumicë, ka qytetarë që do të jenë komb apo janë komb dhe ka qytetarë që do të jenë minoritet dhe kanë me qenë minoritet. Në anën tjetër ajo çka i mungon pakos, i mungon neni 1 dhe neni 1 do të duhej të jetë kështu: Kosova do të jetë shtet sovran dhe i pavarur . Unë e di që këtë nen nuk e shkruan dikush tjetër, por jam shumë i bindur se këtë nen do ta shkruajë Kuvendi i Kosovës. Dhe në këtë drejtim kërkoj nga Grupi i Unitetit dhe Kuvendi i Kosovës ta bëjnë projektin e vet se si do ta shkruajë këtë nen dhe si këtë nen do ta koordinojnë me bashkësinë ndërkombëtare.

Nëse neni 1 nuk gjendet, ne kemi problem me sovranitetin, po e them në kuptimin e asaj. Në organizimin e saj që është parë në pakon e Ahtisarit nuk është asnjë problem lidhur me pavarësinë nëse marrim kuptimin e objektit dhe të qeverisjes së këtij vendi, këtij territori. Nuk është asnjë problem lidhur me atë se si do ta organizojmë jetën brendapërbrenda Kosovës. Por është problemi që ne juristët e quajmë kush i ka letrat dhe Kosova do të ketë problem kush do t'i ketë tapitë për këtë vend, në kuptimin më të thjeshtë të fjalës .Pra. puna jonë duhet të jetë që t'i bëjmë letrat, t'i bëjmë tapitë. Kjo nuk bëhet vetë, unë jam plotësisht i vetëdijshëm, por njëkohësisht kërkoj që këtu të kemi një koordinim të plotë dhe do t'i sugjeroja tri gjëra kryesore, eventualisht katra.

E para. Të ruhet uniteti politik dhe veprues në Kosovë pa marrë parasysh subjektet politike apo të tjera.

E dyta. Stabiliteti i sigurisë dhe politik dhe

E treta. Mendoj partneriteti me bashkësinë ndërkombëtare me hapa të mëtejme. Në veçanti po e them prapë, do të propozoja që Grupi i Unitetit ta bëjë projektin se me cilat punë duhet të ndërmerren më tutje. E thashë pakoja e Ahtisarit është diçka në mes asaj që njerëzit kanë dilema dhe në mes asaj që njerëzit kanë optimizëm. Pakoja e Ahtisarit që të shtyhet ma tutje ka nevojë që ne të marrim hapa konkret. Unë pajtohem me ata të cilët edhe me shefin e Grupit Parlamentar edhe me kryetarin edhe me të tjerët të cilët nuk hapim dilema a pranojmë pakon apo jo , por duhet të hapim dilema çka duhet të ndryshojmë në pako dhe si ta plotësojmë pakon? Këto janë dy dilema që ne duhet t'i bëjmë dhe pajtohem po ashtu me ata të cilët mendojnë që Kuvendi është vend ku duhet t'i japin rekomandimet e veta, rekomandimet shtesë edhe që dha shefi i grupit parlamentar dhe të tjerët . Këto rekomandime besoj që Grupi i Unitetit duhet t'i marrë parasysh. Është një institucion i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës dhe me siguri sugjerimet e Kuvendit të Kosovës do t'i marrë.

Unë mund të them se veprimet të cilat do të merren në ditët në vijim do të jenë veprime të cilat me siguri kërkojnë edhe maturi politike, por do të jenë veprime që ndoshta nuk duhet të na bëjnë me humbur shumë durimin, por njëkohësisht nuk duhet të na bëjnë që edhe shumë të durojmë. Në kuptimin e saj mendoj që përgjegjësia, po e përsëris, shefin e grupit parlamentar të partisë sime i cili tha: Nëse duhet dikush të reagojë mendoj njerëzit e parë janë njerëzit nga Grupi i Unitetit apo unë do t'i quaja Ekipi Negociator dhe njerëzit nga Kuvendi i Kosovës. Sa më pak që reagojmë ne kur duhet aq ma shumë do të lejojmë për të tjerët që s' duhet. Besoj që ne do ta kryejmë punën tonë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!, fjalën e ka Nazim Jashari, le të përgatitet deputeti Hashim Thaçi.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – I nderuari kryetar i Kosovës, i nderuari kryeministër, të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit, i nderuar kryetar i Kuvendit, ministra e kolegë deputetë.

Jemi në një mbledhje maratonike e cila nuk është e zakonshme për Parlamentin tonë dhe siç nuk është e zakonshme për Parlamentin tonë dhe Parlamenti ynë nuk është i përgatitur për këso mbledhjesh, duke qenë se deputetët të cilët udhëtojnë me transport publik e kanë të pamundshme të kthehen nëpër shtëpi. Unë jam një nga ata, kështu që mendoj se për herat e tjera për një punë normale në Kuvendin e Kosovës duhet të kihen parasysh edhe rrethanat kur deputetët udhëtojnë me transport publik dhe nuk kanë transport personal. Si do qoftë, mendoj se ia vlen që të qëndrojmë më gjatë dhe të diskutojmë për një çështje e cila është fundamentale për të ardhmen e Kosovës dhe është mirë që kolegët, deputetët përkundër asaj që u shtrua presion tash të tërhiqen nga fjala nuk e bënë një gjë të tillë ,por vendosën që ta thonë fjalën e tyre secili **konform...**

Vetë fakti i mosvazhdimt të mbledhjes për ditën e nesërme bie fjala është presion, por si do qoftë unë i mbështes të gjithë ata që vendosën ta thonë fjalën e tyre, pavarësisht se çfarë kanë për të thënë.

Dua ta filloj fjalën time duke e parafrazuar një analist nga Shqipëria në një shkrim që e lexova kohëve të fundit në gazetën” Ekspres”, ku thoshte që paketa e Ahtisarit aq mirë është e rregulluar dhe aq mirë e harmonizuar sa që ka marrë masa maksimale që ta ruajë Kosovën edhe nga armiqtë më të mëdhenj të shqiptarëve, nga vetë shqiptarët.

Mendoj se këtu qëndron magjia e pakos së Ahtisarit, për të cilën realisht jemi njoftuar të gjithë. Është thënë edhe në fillim që asnjëri nuk do të jetë i kënaqur edhe që të gjithë kemi vërejtje të mëdha në te. Por, magjia qëndron pikërisht aty që është ndërtuar koncepti i cili Kosovën e çon te shtetësia. Dhe kjo nuk është punë e vogël, të nderuar kolegë deputetë, po qe se ndalemi dhe e kthejmë kokën mbrapa. Kurrë nuk do ta dimë se sa kemi ecur po që se nuk shkojmë mbrapa. Nuk po futem ma thellë në histori, po nisem nga viti 81, kam qenë student si shumë prej jush këtu dhe kemi bërë deri sa na është shterrur fyti -Kosova Republikë, pa qenë fort të bindur se do ta bëjmë atë republikë. Dhe 25 ose 26 vjet mbrapa ne jemi në prag të pranimit si shtet me subjektivitet të plotë ndërkombëtar.

Është një punë e madhe një, ta quaj mrekulli, për të cilën meritën më të madhe sigurisht që e kanë qytetarët e Kosovës, pa një demagogji sepse, udhëheqësit tanë politikë që nga viti 87, e mbaj në mend një fjalë të një zyrtari të lartë slloven që e vajtonte popullin shqiptar për kapacitetin institucional të udhëheqësve të tij, do të thoshte medet ai popull

çfarë udhëheqësish ka dhe kjo sintagmë e tij na është transmetuar periodikisht nëpër të tëra etapat historike nëpër të cilat kemi kaluar. Medet ky popull çfarë udhëheqësie pati, po shqyr që më në fund ia dolëm që ta grumbullojmë mendjen ta ofrojmë mendjen dhe ta gjejmë një modalitet komunikimi me bashkësinë ndërkombëtare për ta pranuar dhe për t'i kuptuar rregullat dhe normat moderne të sjelljes dhe për t'i krijuar parakushtet për ta tërheqë bashkësinë ndërkombëtare për njohjen e nënshtetësisë. Sigurisht që kemi akoma shumë punë përpara, kemi akoma shumë sfida përpara, po një punë e madhe vetëm tashmë është bërë. U përmendën këtu tapitë dhe dua të ndërlidhem te kjo puna e tapive. Në vitin 1999 të gjithë u gëzuam kur forcat policore ushtarake u tërhoqën nga Kosova të cilat mbillnin vetëm vrer. Dhe, e mbaj mend një dialog me një zyrtar të komunës sime nga Gjilani. si i thoshin asaj kohe prefekt i komunës apo nuk më kujtohet saktë, ishte korriku apo gushti dhe ia tërhoqa vërejtjen që me sjelljen që po e manifestojmë nuk do ta marrim tapinë kurrë.

I thashë: Serbët e kanë pasur tri herë tapi dhe ua morën, neve do të na marrin akoma pa na e dhënë. Dua të ndërlidhem të dal te dy akuza që u dëgjuan këtu ndaj kryetarit të partisë sime, jo për t'i bërë avokati, por për ta sqaruar pozicionin tim pse ndodhem në këtë parti. Në këtë parti ndodhem sepse besoj në idetë që kjo parti i prezanton, besoj në realitetin dhe në mënyrën e kundërimit të realitetit qënjerëzit që janë anëtarë të kësaj partie dhe sidomos anëtarët e kryesisë së kësaj partie.

Dhe t'jua them të drejtën, në vitin 1999 apo 2000, kur u bë ajo akuza e famshme për fashizmin, ku u parafrazua këtu edhe nga ministrja Tërkkolli edhe nga z. Hasani, nga dy pole të kundërta të politikës, do t'i quaja nga një njeri i cili ka sakrifikuar tmerrësisht me shembullin e vet jetësor për këtë Kosovë dhe nga një zonjë e cila sakrificën e ka pasur pak më të vogël, kurse hajrin pak më të madh. Pra, edhe unë i kam pasë vërejtjet e mia në atë pozicionim e asaj kohe, sepse edhe unë si z. Hasani ma shumë e kam e këqyr realitetin me zemër se sa me mend. Në qoftë se vazhdojmë ta këqyrim realitetin ma shumë me zemër se sa me mend, ne do të rrimë gjithë në pozicion z. Hasani, por në qoftë se e këqyrim vetëm me mend pozicionin, si zonja Tërkkolli, me siguri se do të jemi në pozicion të saj, sepse vetëm do të shikojmë se ku do të përfitojmë dhe do të vendosemi edhe si ky zotëria që po lëshon zëra mbrapa. Në qoftë se e shikojmë vetëm me mend pozicionin ne sigurisht do të sillemi sikur këta. Pra çështja është që duhet ta shohim pozicionin edhe me zemër edhe me mend, realitetin ta këqyrim edhe me zemër edhe me mend, të përpiqemi t'i shohim gabimet tona dhe të përpiqemi të mësojmë nga gabimet tona. Kjo është esenca e komunikimit modern, bashkëkohor edhe e bërjes së politikës së mirë bashkëkohore. Nuk mund të ecet përpara vetëm duke i parë gabimet e të tjerëve, duke e parë qimen në syrin e tjetrit kurse traun nuk e sheh në syrin tënd.

Thelbi i asaj akuze që i mëveshët kryetarit të partisë time është që disa shqiptarë i kanë përndjekur të tjerët vetëm atë se kanë qenë të tjerë dhe kjo është shumë e vërtetë dhe kjo shumë qëndron dhe jam i bindur plotësisht në këtë, sidomos ma mbrapa, sepse edhe sot në murin e fqit tim serb shkruan me dorën time e shkruar fjalia - pronë shqiptare. Dhe e kam shkruar me 17 mars 2004 në përpjekje për me shpetua prej djegies, sepse ajo përndryshe do të digjej. Për kundër asaj që shkruan pronë shqiptare, ajo nuk u bë kurrë pronë e imja, ajo ka mbetur pronë e tyre edhe sot e asaj dite është pronë e tyre, ata nuk e

gëzojnë .por shkruan akoma me dorën time e shkruar pronë shqiptare dhe duhet ta shohim të keqen e edhe brenda nesh se po e pamë vetëm të të tjerët, të jeni të sigurt se nuk kemi të ardhme. Bota mund të na përkrahë, por sa do që të na përkrahë bota nuk mund të na bëjë të ecim po qe se nuk ecim vetë dhe ne duhet të ecim vetë sigurisht, nuk do të ecim shpejtë dhe nuk do të ecim sigurt siç nuk e kemi bërë për këto 8 vjet, se po që se do të kishim ecur shpejt dhe sigurt ne do ta kishim bërë shtetin më herët, po për shkak pikërisht të këtyre manifestimeve, duke mos i parë gabimet te ne, duke mos iu vu në ballë gabimeve te ne, ne jemi vonuar tetë vite dhe rrezikojmë të vonohemi akoma, sepse nuk e kemi zgjidhur problemin. Ne kemi krijuar bazën për shtetësi, por shtetësinë akoma s'e kemi ndërtuar, do të kemi këtu një tutor që do të na rri mbi kokë si shqiptonjë dhe mbase do të na kapë për veshi dhe do të na heq prej politike sa herë që atij do t'ia merr mendja që ne e kemi shkelur gabimisht dhe ai sigurisht që nuk do ta bëjë përmendsh atë punë, do ta bëjë duke u bazuar në disa fakte në disa argumente Prandaj të jemi realistë të përpiqemi ta shohim paketën me të mirat dhe me të këqijat, të përpiqemi që në të gjitha ato momente në të cilat paketa nuk ofron qartësi, të kërkojmë sqarim. Kjo është ajo që kërkoj unë prej Grupit të Unitetit, kërkohen sqarime të nevojshme që të hiqen dilemat dhe shmangia e dilemave sigurisht do të krijojë parakushte, sigurisht duke e përmirësuar edhe cilësinë tonë të bërjes së politikës që Kosova më në fund të jetë një shtet i pranuar me drejta të plota në gjirin e shteteve moderne. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Replikë urdhëroni

DEPUTETI HASHIM THAÇI – Ne u konsultuam këtu, në Ekip të Unitetit, pak nëse dom ta përfundojmë sonte duhet të jemi shumë të sqartë. Gjithë dokumentin e kemi lexuar brenda partive tona. Gjithë i kemi dhënë qëndrimet tona si parti politike. Të gjitha këto parti që jemi këtu e kemi përkrahur dokumentin. Gjitha institucionet e kanë përkrahur dokumentin, e kanë mirëpritur, e kanë respektuar procedurën konsultative për takimet në Vjenë. Prandaj do të ishte me interes që ose të arrijmë një përfundim sa më të shpejtë të mundur, do të thotë të përbashkët dhe ky dokument të mos jetë ai i cili do të mund të kuptohet si diçka një betejë me Ekipin e Unitetit, por si diçka që mbështet Ekipin e Unitetit dhe që e plotëson në qëndrime e fuqizon. Për këtë arsye mendoj se duhet të arrijmë marrëveshje mirëkuptimi këtu, çka? A po vazhdojmë debatin, atëherë propozojmë një orë pushim së paku dhe vazhdojmë deri kur ta përfundojmë, por jo vetëm kështu, ose sonte, do të vazhdojmë nesër, jemi krejt Ekipi i Unitetit në angazhime që kemi dhe të dielën edhe të hënën jemi të shpërndarë. Po flas nga ajo që di, agjendën që e kemi, prandaj kisha propozuar një orë pushim dhe vazhdojmë pastaj deri kur të përfundojmë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Replikën e ka Nait Hasani, pastaj shkojmë në pushim një orësh. Vazhdojmë deri në mëngjes, s'ka problem. Urdhëro Nait.

DEPTUETI NAIT HASANI - I nderuari kryetar. Unë nuk e kam pasë ndërmend të dal të bëjë replikë me asnjë këtu, por duke u përmendur disa herë emri im pikërisht për çështjet se unë deklarova, duke e falënderuar Veton Surroin ne e kemi hëngër dajakun në burgjet e Serbisë, ndërsa z. Jashari më përmend mua dhe thotë se, unë nuk di si ka ndodhur dhe si ka qenë ajo pjesë e asaj kohe, ka raste individuale sa do, por në asnjë program qeverisë të

program të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në asnjë program politik të Kosovës nuk ka pasë për përndjekje të pakicave të askujt. Prandaj unë kërkoj që pikërisht Veton Surroi, Ekipi i Unitetit dhe delegacioni, anëtari i tij edhe më herët deklaroi: se unë qëndroj pranë asaj deklarate: Unë kërkoj nga ky Kuvend ta bëjë një distancim politik nga kjo deklaratë, se ne nuk jemi popull fashist, as që kemi qenë dhe as që do të jemi, prandaj ju lutem ta bëni një qëndrim ta merrni si Kuvend kundër kësaj deklarate, për përndryshe ne jemi fashistë, ne mund të na krahasonin me Musolinin, me Hitlerin, me regjimet totalitare e me të tjerë. Është turp për neve të themi se jemi shqiptarë -popull fashist, kur ne kemi vuajtur me qindra vite. Prandaj unë kërkoj të distancohem nga kjo përgjegjësi politike dhe nëse kemi ne njerëz në Ekipin e Unitetit, çfarë uniteti do të na bien ata neve, në të ardhmen çfarë pavarësie do të na bien, kur ne jemi fashistë. Ju lutem kryetar, kjo është një deklaratë që anëtari i juaj i Ekipit e prezantoi sot dhe e tha që unë kam thanë dhe unë mbes pranë asaj. Rastet individuale janë të papërgjegjshme për askënd. Program politik nuk ka pasë Qeveria jonë as e përkohshme, as para kësaj qeverie as kjo qeveri që është tash. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!. dëgjoni i kemi edhe 27 deputetë që janë paraqitur për fjalë. Sonte duhet të përfundojë kjo mbledhje, edhe 26 vota janë të paraqitur. Urdhëroni z. president.

PRESIDENTI FATMIR SEJDIU – Të nderuar deputetë. Një propozim ishte shumë i qartë dhe ishte pjesë e marrëveshjes sonë, besoj që do të keni mirëkuptim edhe ju. Për shkak të itinerarit që do të jetë në ditët në vijim, ne kemi filluar këtë debat sonte, bëjmë një pauzë, nëse deputetët insistojnë të dalin me fjalët e tyre, të dalin, të dëgjohemi bashkë, të marrim rekomandimet dhe të ecim proces mandej, kjo është një punë ma e mira që mund t'i ndihmohet edhe Ekipit të Unitetit edhe mund t'i ndihmohet realisht Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, urdhëro Bislim Hoti.

DEPUTETI BISLIM HOTI- Faleminderit z. Kryetar i Kuvendit. Përsëritje për Presidentin e Kosovës z. Fatmir Sejdiu, përsëritje për karrikat e vetmuara nga anëtarët e Grupit të Unitetit që gjenden pranë jush, të nderuar kolegë deputetë.

Sot po diskutojmë një çështje mjaft të rëndësishme dhe të ndjeshme për Kosovën, ku këto çështje po përsëriten nga shumë deputetë dhe kjo tregon se çështja e zgjidhjes së statusit të Kosovës nuk duket fare e qartë.

Plani në substancë përmban një lloj pavarësie, por pavarësi e pa emër, pavarësi pa afat kohorë, apo që Kosova po shkon drejt një pavarësie.

Raporti i ofruar nga z. Ahtisari flet më se 80% vetëm për komunitetin serb dhe se minoritarët serb i bënë superkomunitet në Kosovë.

Andaj, unë nuk mund ta pranoj këtë dokument të ofruar nga Ahtisari edhe pse dikush nga këtu të pranishëm mund të thotë se punë e madhe a e pranon Bislim Hoti apo jo. Theksoj si do të pranohet ky projekt kur bëhet fjalë vetëm për krijimin e komunave serbe mbi bazën etnike.

Si mund të pranohet kur serbët bëjnë pazar me pronën e Kosovës në kufi me Maqedoninë, apo që Kosova po u dashka t'i kthej borxh Serbisë.

Si mund të pranohet ky dokument kur bëhet uzurpimi i pronave të qytetarëve për mbrojtjen e kishave serbe, ku këto prona do t'i prekin interesat jetike të banorëve për rreth.

Si do të pranohet ky projekt që TMK-ja mos të ketë rolin që duhet ta ketë, por si organizatë civile, joqeveritare dhe jo si ministri e Mbrojtjes dhe Ushtri. Të nderuar kolegë deputetë, unë për gjitha këto që i cekam kam material që për secilën të flas, por duke u bazuar në atë se gjithë parafolësit e mij i dhanë materialet shpjeguese, unë do të ndalem vetëm aty ku sipas diskutimeve që bëri Presidenti i Kosovës, Kryeministri i Kosovës dhe z. Thaçi shihet qartë që e lavdërojnë projektin dhe thonë se ky projekt realizon dhe mundëson respektimin e të gjitha komuniteteve në Kosovë, e në veçanti të komunitetit serb.

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju Grup i Unitetit, kjo veçanti që po flitet gjithmonë për komunitetin serb që tetë vite po e them edhe një herë jo që e ka bërë komunitetin serb, superkomunitet në Kosovës, por që komuniteti serb në të ardhmen do ta luajë edhe rolin e UNMIK-ut, që e luajti deri më tash në Kosovë. Kur bëhet fjalë edhe për komunitetet e tjera është e vërtetë se nëpër dokumente favorizohen, por aspak nuk është e vërtetë që komunitetet e tjera mund të implementojnë kërkesat e tyre në ndërtim, kthim, e shumë çështje tjera.

Kjo ka ndodhur sepse Qeveria, Grupi i Unitetit, duke e bërë një përkëdhelje shumë të madhe për komunitetin serb, komunitetet tjera i lënë anash edhe pse përmenden këto dokumente. E them një fakt se edhe asamblatë komunale nëpër komuna e luajnë të njëjtin rol që të gjitha kërkesat t'i realizojnë vetëm për komunitetin serb. Të nderuar kolegë deputetë, nuk dua me thënë diçka që më bien mua për vete, që 8 vite unë jetoj me qira në Gjakovë, ndërroj banesa me 7 anëtarë të familjes, disa herë kam kërkuar në Kuvendin komunal dhe kreu i Kuvendit komunal më ka thënë z. Hoti, z. deputet po që do të ishte serb edhe i thjeshtë në Kosovë brenda natës do të jepet pllaci, brenda ditës do ta ndërtojmë shtëpinë, pra, këtë nuk po e them për vete, por përderisa unë si deputet i Kuvendit të Kosovës që dy mandate nuk kam mundësi të paktën që 8 vite të realizoj të vetmen kërkesë, atëherë duhet ta kuptoni çka qenka realizuar për komunitetin tim.

Ju them të vërtetën që 8 vite komuniteti egjiptas ka ngelur mbrapa ashtu si kanë ngelur shumë familje shqiptare, ashtu si kanë ngelur shumë familje të dëshmorëve, ashtu si kanë ngelur shumë familje të invalidëve të luftës dhe në saje të kësaj komuniteti ynë ka arritur një varfëri të skajshme në Kosovë. Unë para se të dalim në pushim e dëgjova zotin Hashim Thaçi që m'u duk që u bë edhe zëdhënës i subjekteve të tjera politike që ne e kemi përkrahur gjithë këtë dokument, që ne jemi marrë vesh nëpër subjekte politike, atëherë nuk e shoh të arsyeshme, pasi që jemi marrë vesh subjektet politike, pse LDK-ja dhe PDK-ja na morën kohën dhe bëjnë diskutime të gjata deri më tani. Unë e them në emër timin personal, Bislim Hoti nuk pranon këtë dokumentet të tillë, unë e thashë edhe më parë, Bislim Hoti do ta pranojë vetëm një dokument i cili do të jetë se deri më tash asnjë dokument të tillë apo deklarata, apo platforma, të cilat kanë ardhur nuk i kam pranuar, Nuk e kam ndërmend ta pranoj as këtë dokument. Dokumenti i vetëm që do të

pranoj do të jetë Kushtetuta e ardhshme e Kosovës ,e cila do të jetë një çiment i fortë që do t'i lidhë të gjithë gurët pavarësisht ngjyrën e tyre që do të kenë. Prandaj unë mendoj që të gjitha këto çka i ceka do ta kenë vëmendjen e Grupit të Unitetit, sepse deri më tash qe 8 vite unë as që kam mundur ta ushtrojë edhe identitetin tim kombëtar duke munduar që me deklarata të ofruara nga ndërkombëtarët e kanë përzierë me komunitetet e tjera. Unë nuk do të kem identitet po qe se nuk ka shtet, shteti është ai që do të ma mbrojë identitetin tim dhe mendoj që, po e them në fund unë i jap përkrahje Grupit të Unitetit, por ta dinë që dokumenti i vetëm që do të pranojë Bislim Hoti është Kushtetuta e ardhshme e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit!. Fjalën e ka deputeti Ramadan Musliu,le të përgatitet deputeti Ymer Muhaxheri

DEPUTETI RAMADAN MUSLIU – I nderuari z. president, i nderuari z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër dhe kolegë deputetë. Në duar e kemi propozimin gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin. Konsideroj që gjitha këto debatet e deritashme dhe idetë që u dhanë do të jenë pjesë komplementare të një qëndrimi që do ta ketë i ashtuquajhuri Ekipi i Unitetit për vlerësimin e plotë të këtij dokumenti.

Konsideroj se kemi të bëjmë me një kornizë reale për një marrëveshje për zgjidhjen e statusit përfundimtar. Me këtë dokument shihet se kalohet nga një lloj tranzicioni në një lloj tranzicioni tjetër. Nga administrimi i UNMIK-ut që qeverisjen e bënte me asistencë të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes. Në mbikëqyrje në zbatimin e marrëveshjes që konsideroj që është një model funksional tranzitor i qeverisjes në Kosovë nga institucionet vendore. Po ashtu mendoj që është një stad i domosdoshëm veçmas duke pasë parasysh synimet tona për integritet euroatlantike. Normalisht që duhet t'i plotësojmë disa standarde që konsiderojmë se kemi pretendime për integritet në këto struktura.

Nga ky dokument unë për veti kam hetuar që ekziston përpjekja për përforcimin e institucioneve shtetërore dhe në anën tjetër fillesat e disa institucioneve që i karakterizojnë shtetin, sikurse që janë sfera e mbrojtjes dhe e sigurisë e tjera. Mirëpo konsideroj se në këtë dokument që do të duhej mbase të ishte edhe një pikë e veçantë, si një aneks i veçantë, mungon problematika e politikës së jashtme dhe e diplomacisë. Dihet që na po bëjmë përpjekje që të bëjmë zyra ndërlidhëse në Bruksel, në Nju Jork, Vashington nuk e di. Po edhe në vendet e tjera. Dihet në anën tjetër se ekziston një nevojë e domosdoshme sidomos e njerëzve tanë që përkohësisht punojnë në botën e jashtme për pajisje me dokumente e që bëhet përmes shërbimeve konzullore. Po ashtu i dimë se çfarë peripecish kanë të pajisen pajisje me këto dokumente gastërbajterët që vinë gjatë pushimeve. Në këtë dokument mungon kjo pikë që mendoj se do të ishte e domosdoshme së paku të gjendet një lloj zgjidhje, mirëpo meqë pas kësaj pason Kushtetuta besoj që do të përfshihet.

Meqë është një kornizë e mirë që mund të bëhet funksionale, por me plotësime dhe korrigjime të domosdoshme disa prej të cilave janë thënë deri më tash. Lëshimet që duhet pasur në konsideratë për mendimin tim janë aneksi 8 neni 3.2. ku flitet për tërësinë

territoriale të Kosovës. Nuk dua ta lexoj nenin, por e them kështu në vija të përgjithshme se thuhet : Duhet të përfillet vija kufitare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda RSFJ-së, e datës 31.12.1988. Me një ndërhyrje tjetër duke pasur parasysh korrektimin që i është bërë vijes kufitare me ish Republikën e Maqedonisë të datës 23 shkurt 2001. Po ashtu e dimë qëndrimin e Këshillit të Sigurimit për ratifikimin e kësaj marrëveshje, unë mendoj se duke u nisur nga fakti se me Maqedoninë na lidhin interesa të shumta, përveç raporteve të mira fqinjësore duhet të kultivojmë edhe raporte të forta miqësore për shumë arsye të cilat i dimë të gjitha tash të mos e zgjas. Po ashtu jam i obliguar edhe për një fakt tjetër ta potencojë se vijë nga ajo zonë që lidhet drejtëpër - drejt me këtë problem, përveç 2500 hektarëve që përmendëm, 400 hektarë janë kryesisht tokë e punueshme që i takon fshatit Dobëllde.

Kam parasysh që është fjala për një zonë kufitare shumë të ndjeshme që kufizohet po ashtu me një pjesë me një popullatë shqiptare të them shkurt kështu si me thanë e qartë, janë zona belaxhish të cilët nuk u pritojnë ngatresave. Mendoj që me Maqedoninë, duke marrë parasysh edhe faktin se është marrëveshje që është ratifikuar nga Këshilli i Sigurimit mund të kërkohet të bëhet një marrëveshje xhentëlmene edhe për një zgjidhje afatgjatë, pa i cenuar interesat thelbësor të asnjë shteti.

Po ashtu edhe për problemin e decentralizimit konsideroj se një zgjidhje që ofrohet nuk e di sa mund të jetë produktive, për shkak se të gjitha ato aspekte që u përmendën ,jo ndihma financiare jo shumë sende tjera lidhet me Serbinë, ato do të jenë të përkohshme. Atëherë kur do të zgjidhet problemi i statusit përfundimtar të Kosovës unë besoj se Serbia do të heqë dorë prej ndihmave financiare sidomos, edhe do të shihet se ky lloj decentralizimi nuk do të jetë aq funksional dhe do të ketë nevojë për ridefinimet e tjera dhe për integrimin e minoritetit serb që ta ketë statusin taman të këtij minoriteti të mos jetë si një paralele e ndarjes së Serbisë ,e cila do të shërbejë për situata të caktuara si një vatrë destabiliteti, mirëpo me zgjidhjen e statusit unë besoj që duhet të kemi një qëndrim tjetër. Po ashtu edhe aneksi 7 neni 6 ku flitet për kthimin e pronës është shumë i paqartë ,për shkak se hapet problemi i kthimit të pronave në një territor ku ka pasë kolonizimr, reforma agrare e rikolonizime mendoj se të hapet kutia e Pandorës ku dalin 1000 probleme, mund të shtohet edhe problemi i kthimit të pronave të cilat janë marrë nga shteti të gjendet një zgjidhje ligjore që ato mund të bëhen ma vonë me ligje të caktuara, përndryshe me u marrë drejtë për drejtë me kthimin e pronave dhe me kompensime çfarë kërkohet atje, jo kishës ortodokse kur dihet fakti se popullata shqiptare as nuk ka pasur pushtet as mundësi që të bëjë uzurpime të tilla e të marrë toka të vakëfit,mendoj që është e tepërt.

Po ashtu ndoshta mund të bëhet ndonjë vërejtje sikurse që e banë për këto zonat e mbrojtura, mendoj që këto zona ma shumë janë rezultat i një propagande edhe preokupim me një histori e cila është plotësisht e pandriçuar, për shkak se unë këtu dëgjova edhe faktin se kisha serbe është ashtu, kishat ortodokse janë kisha nacionale shpesh si me thanë kanë qenë çerdhe të shumë politikave, çerdhe politike kryesisht ku janë bërë edhe plane ekspansioniste e strategji okupuese, mirëpo ky është problem tjetër.

Mendoj se problemi i zonave të mbrojtura duhet të shihet edhe në një aspekt tjetër ,se pikërisht këto objekte kanë qenë të mbrojtura nga vetë shqiptarët për shkak se historikisht janë të lidhura me to, shqiptarët asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia kristiane, qoftë ajo katolike apo ortodokse. Dihet se ka ndodhur një konvertim masovik prej konfisionit ortodoks në atë islam, këtë fakt nuk e pranon kërkos. Kërkoj lidhje domosdoshme me katolicizëm ndoshta ajo prirja aksidentale e jona që të lidhemi me Perëndimin, mirëpo këto probleme kanë ekzistuar, po ashtu ndoshta është problemi i **historisë** shqiptare që s'është marrë me ndriçimin e shumë aspekteve se pjesa ortodokse shqiptare i ka takuar ritit sllav, sikurse që i takojnë shqiptarët e Jugut të Shqipërisë ritit ortodoks. Prandaj këto zona mbrojtëse unë mendoj që janë të tepërta, jofunksionale për shkak se e dimë edhe vetë se ka pasur familje shqiptare që janë marrë me mbrojtjen drejtë përdrejtë të këtyre objekteve që mos ta zgjasim mjaft edhe ashtu ju falënderoj për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ymer Muhaxheri, le të përgatitet Ylber Hysa.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvend i nderuar, z. president, z. kryeministër, z. kryetar. Unë kam një qasje krejtësisht tjetër lidhur me përmbajtje e marrëveshjes, për atë edhe arsyet që i paraqes nuk shkon në pajtueshmëri me kahjen e të menduarit e që dominon sot këtu. Prej disa druve nuk shihet krejt mali. Nëse i kthehemi dhe e analizojmë brendinë e kësaj marrëveshjeje, është vleftë e madhe fakti se në këtë marrëveshje në mënyrë definitive Kosova po shkëputet nga jurisduksioni i shtetit serb. Kjo është e madhe është madhështore, një ëndër dy mijë e sa vjet po bëhet zhgandër, po lind, po zhvillohet, po krijohet një shtet. Një shtet që ka me fuqizuar edhe një çështje tjetër. Arsyeya e dytë, nëse me fuqinë e dritës së arsyes analizohet brendia e kësaj marrëveshjeje shihet se kontura e shtetit është dhënë në mënyrë të plotë me të gjitha ato attribute që e përcjellin një shtet dhe që e bëjnë funksional qëndrojnë aty. Një arsye tjetër, se gjitha qendrat e vendosjes pa rezervë e përkrahin përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje, arsye tjetër, çështja e decentralizimit nuk është materie që përfshihet me anë të Kushtetutës, si e tillë ajo ndryshon modifikohet me kohë për atë nuk është relevante. Një arsye tjetër nëse Ekipi i Unitetit, Ekipi Negociues, kërkon ndryshime lidhur me përmbajtjen e kësaj, atëherë bien në desh, me gjithat kahet e veprimi të qendrave të vendosjes. Në anë tjetër mundet me u favorizuar pala tjetër e dihet pala tjetër çfarë qëndrimi ka ndaj misionit të presidentit të Ahtisarit. Nëse shikojmë natyrën e kësaj përmbajtjeje e shohim se faktikisht edhe praktikisht është e pa mundur me u ndryshuar diçka, kjo është tejet e rëndësishme. Fakti se presidenti Ahtisar kërkon për çdo eventualitet ndryshimi pajtimin e dy palëve rivale, praktikisht faktikisht është e fakt, një vështirësi tjetër për të cilën duhet me pas kujdes shumë, gjithë posaçërisht ekipi negociues është një vështirësi në lidhje me një pjesë e cila ju ka bashkangjitur hartimit të marrëveshjes së presidentit Ahtisar. Kjo ka të bëjë me pjesën e sigurisë, pjesën e KFOR-it, ajo është hartuar nga qendrave të vendosjes. Si e tillë është absolute, është e pandryshueshme nuk është modesti me kërkuar prej Ekipit Negociues me pas kujdes lidhur me kërkesat që kemi me bë eventualisht për ndryshimin e paketës. Jemi gjallë e të shohim se a ka me ndryshua diçka nga përmbajtja e kësaj që është paraqitur. Kisha përdorur një urtësi popullore që thotë: Mos e prej rremin ku qëndron ti, sepse mundesh

me thye qafën”. Kërkesat eventuale për ndryshim nuk janë të këndshme, nuk priten prej anës sonë, **jemi anë** historikisht për herë të parë, ishalla jo e mrama e favorizuese-kujdes. Fakti se çështja e Kosovës është bërë problem gjeopolitik e ka ringjallë, atë rivalitet atë konfrontim mes këtyre dy palëve, kërkon edhe ma shumë kujdes, Vështirë është me kanë në nivelin e detyrës së Ekipit Negocues, e niveli i detyrës e ka edhe nivelin e përgjegjësisë. Ju faleminderit profesor.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Fjalën e ka Ylber Hysa, le të përgatitet deputetja Qibrje Hoxha.

DEPUTETI YLBER HYSA – Janë besoj disa arsye pse nuk duhet ta zgjas këtë debat. E para është se në këto nuk besoj se do të kisha thënë diçka shumë të mençme dhe sikur do të kisha thënë diçka gjeniale nuk besoj që do ta nxini mesataren një debati racional dhe të mençëm për ditën e sodit, vetëm se jam i obliguar t’i jap disa shpjegime pas një dëgjimi që bëra sot nga keqkuptimi dhe keqinterpretime të shumta që janë bërë nga një pjesë e kolegëve të mi, dhe nga e një pjesë e komentatorëve dhe analistëve të cilët po shihen këto ditë në media duke i dhënë vetes të drejtë për të interpretuar se çka po ndodh me pako, por jo me trashëgimi. Më lejoni t’ju shpjegoj se bëhet fjalë për 45 zona të mbrojtura nga të cilat vetëm 22 janë të ashtuquajtura me **zonifikim** special, pra bëhet fjalë për tri kategori të mbrojtjeve dhe vetëm kjo i takon pjesës së zonifikimit special, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me një lloj zonifikimi standard ,i cili njihet gjithkund në botë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e monumenteve i cili me automatizëm e ka një **baferzum** prej 50 metrash në zona urbane, ndërsa në 100 metra me zona rurale. Bëhet fjalë për një pjesë të monumenteve të cilat këtu disa prej sosh që nuk janë prej karakterit religjioz nuk janë kategorizuar si monumente serbe po monumente të mesjetës, por këtu bëhet fjalë kryesisht për Novo Berdën dhe vendbanimet e tjera. Më duhet t’ju them , po ashtu, se këto janë regjime mbrojtëse hapësinore të cilat njihen gjithkund në botë, pra ku nuk mund të bëhet gjithçka siç ndodhë në Kosovë që mund të shihni pompa të benzinit, vetëshërbime kudo që silleni dhe shkelni, bëhet fjalë për marrjen e obligimeve ndaj këtyre monumenteve dhe ky regjim vlen për të gjithë vlen edhe për vetë kishën, një regjim mbrojtës i cili njihet gjithkund në botë dhe askund nuk e tjetërson këtë hapësirë as që e merr dikund tjetër dhe as që kemi të bëjmë me një ekstraterritorialitet.

Më duhet po ashtu të bëj disa shpjegime që dikund afro 40% e këtyre objekteve gjenden në hapësira ku s’janë të banuara me shqiptarë, plotë prej tyre në Veri, Leposaviq, Zveçan, një pjesë e tyre e madhe në komunën e Shtërpçës, apo një pjesë e tyre në komunat e reja që do të krijohen p.sh. në **Manastiri Dragas** në Novobërdë

Dhe krejt në fund, pa dashur që ta zgjas debatin, përndryshe nëse ka nevojë jemi të gatshëm që ta bëjmë një riedukim me gjithë ata kolegë , mund ta bëjmë edhe një lloj takimi të brendshëm, më lejoni t’ju them që krejt hapësira për të cilën po bëhet fjalë me kaq dramë përbën 0.90% të territorit të Kosovës, pra po e përsëris është 0,90% e territorit të Kosovës dhe nëse kolegët e mij tuten prej kësaj pune, atëherë me të vërtetë nuk di çka me ju thanë tjetër. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!, fjalën e ka deputetja Qibrije Hoxha le të përgatitet deputetja Fatmire Mulhaxha Kolçaku

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA - I nderuar president!Te nderuar anetarë te Grupit te Unitetit, i nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë! Desha vetëm t’ju them se unë fjalën time me pikëpamjet e mia rreth propozimit për marrëveshjen për statusin e Kosovës do ta deponoj me shkrim.

Propozimi per Marreveshjen per Statusin e Kosoves, pajtohem se paraqet nje dokument i cili vë bazat e shtetesise se Kosoves dhe si i tille eshte i rendesishem per Kosoven. Te nderuar anetare te Grupit te Unitetit, me lejoni qe t’ ju deshiroj pune te mbare dhe unitet, ne finalizimin e mbare te Marreveshjes per Statusin e Kosoves.

Une deshiroj t’i paraqes disa verejtje te mia rreth kesaj marreveshjeje.

Se pari, kjo propozimmarreveshje nuk permend shumicen shqiptare, as ne dispozitat per te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, e as ne nenin 3, ku flitet per te drejtat e komuniteteve dhe pjestareve te tyre. Keto dispozita jane pikerisht ato te cilat garantojne te drejtat e minoritareve, pikë se pari nga shumica shqiptare qe perben 90% te te gjithe popullsisë ne Kosove.

Po ashtu e konsideroj te padrejte qe shumica shqiptare te emertohet me nocionin komunitet.

E them kete sepse, në Korrnizen e Konventes se Keshillit te Evropes per mbrojtjen e minoriteteve, vendosen qarte raportet ne mes shumices dhe pakices ose minoriteteve. Emertimi i minoriteteve ne kete konvente te Keshillit te Evropes shkon edhe me larg ,sepse minoriteteve ua jep nje emrtim tjeter si minoritete nacionale. Ky emeritim i minoriteteve behet pikerisht per te percaktuar se ne shtetet perkatese shumeetnike ekziston nje shumice ose komb ose nacion, si dhe ekzistojne pakica ose minoritete qe jetojne ne nje shtet te caktuar.

Konsideroj se, dokumenti perfundimtar per statusin e Kosoves duhet te bazohet ne konventat e UE dhe ne Konventen e Keshillit te Evropes per Mbrojtjen e Minoriteve ne menyre qe Kosova te kete si baze ligjet qe vlejne per te gjitha shtetet e Evropes. Mendoj qe në dokumentin perfundimtar ku flitet per mbrojtjen e minoriteteve, duhet te qendroje nocioni shumica shqiptare. Mos te harrojme se Kuvendi i Kosoves te gjitha ligjet i miraton ne baze te rekomandimit te Zyeres per Integritme Europjane dhe nisur nga kjo, nuk ka arsye qe te mos aplikohet ne teresi edhe Konventa e Keshillit te Evropes per Mbrojtjen e Minoriteve edhe ne Kosove.

Çeshtja tjeter, per te cilen deshiroj te shpreh mendimin tim, eshte ajo e decentralizimit.

Konventa e Keshillit te Evropes per Veteqeverisje Komunale, e cila hyri ne fuqi ne vitin 1985, keshtu e definon veteqeverisjen lokale, ne nenin 3: Te drejtat dhe mundesite e komunave qe ne kuader te kufijve ligjorë, te marrin pergjegjesi qe: te rregullojne, te perkujdesen per nje pjese te madhe te çeshtjeve publike dhe ne interes te qytetareve.

Ndersa ne Propozimin e Marreveshjes per Statusin e Kosoves, ne dispoziten III, neni 1, thuhet se: Veteqeverisja lokale ne Kosove do te mbroje dhe promovoje standardet e pranuar nderkombetarisht te te drejtave te njeriut, me konsiderate te veçante per nevojat e komuniteteve joshumice dhe anetareve te tyre ne Kosove.

Por formimi i komunave të reja në baza etnike, nuk figuron në Konventën e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve, e as në Konventën e Këshillit të Europës për Vetëqeverisje Lokale.

Aneksi për Decentralizim i Propozimit të Ahtisaarit për Statusin e Kosovës, në dispozitat themelore të tij, thirrret në Kartën e Europës për Vetëqeverisje Lokale si dhe në standarde ndërkombëtare, ku natyrisht se nuk definohet formimi i komunave serbe. Kurse nënë në vijim të aneksit mbi Decentralizimin flasin kryekput për komunat e reja serbe dhe rregullimin e tyre në të gjitha fushat.

Kjo është rrjedhim i negociatave mbi decentralizimin dhe vetëqeverisje lokale për Kosovën, që në të vërtetë ishte negociatë për formimin e komunave të reja serbe. Është kështu sepse decentralizimi me asnjë konventë nuk është proces i cili është i negociueshem. Proceset demokratike nuk janë procese të negociueshme, sepse ato janë procese të pandalshme shoqërore që synojnë të drejtë dhe liri për njëzë, si dhe obligime të definuara qytetare në të mirë të të gjithëve pa dallim etnie, gjinie apo feje. Këto të drejta dhe obligime qytetare caktohen në kuadër të konventave ndërkombëtare dhe zbatohen në pajtim me specifikat e shteteve përkatëse.

Natyrisht se në shtete të dryshme shprehën kërkesa për të drejtën e vetvendosjes së minoriteteve mbrenda një shteti dhe këto kërkesa kanë të bëjnë kryesisht me lamitë e kultures, traditave, barazi si dhe çështje tjera që lidhen me shumë kultura.

Të gjitha të drejtat e minoriteteve janë të përmbledhura në Konventën e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve. Në mes tjerash në këtë konventë qartë precizohet se: Konventa nuk nënkupton ndonjë njohje të të drejtave kolektive, por mbrojtja e minoriteteve kryesisht vlen për mbrojtjen e individëve.

Në mbetjet të presim finalizimin e dokumentit të Ahtisaarit, të cilit, Grupi i Unitetit do t'ia përcjellë vërejtjet e deputeteve të Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA –Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku. Le të përgatitet deputeti Kamber Kamberi

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryetar, Ekipi i Unitetit, kabinet qeveritar dhe ju kolegë deputetë.

Është e qartë që dje kur menduam që nuk është e përshtatshme që ky debat fillojë në orët e pasditës ishte mua kjo që po ndodhë që tani më të gjithë të lodhur të shikojmë se si ta përfundojmë ma shpejtë një debat. Me të vërtetë kemi ardhur në situatë të palakmueshme që t'ia tërheqim fjalimet tona. Nuk është që do të themi diçka shumë të re, është e qartë që përmes shëfave të grupeve kemi dhënë atë përkrahjen e duhur të kësaj pako. Megjithatë në kemi pasur disa vërejtje që ndoshta kishte me qenë mirë t'ia dëgjojë Ekipi i Unitetit dhe eventualisht diçka të inkorporohet atje në atë draftin përfundimtar. Ajo çka më ka habitur prej disa deputetëve ishte fakti që kërkonin që në ditën e sodit Ekipi i Unitetit të vijë me qëndrime unike, them me njëmendësi. Në presim që ajo të ndodhë kur shkojnë në Beograd në konsultime, por nuk duhet me u marrë faktin që në një pako që është marrë ditë më parë dhe është në shqyrtim. Mendojmë që ky Kuvend vërejtjet e ndëgjueme në këtë Kuvend duhet t'ia ketë parasysh Ekipi, nëse keni menduar që është dashur të vijë ekipi me një draft të përfunduar, siç ka pasur sugjerime nuk është dashur të ndodhë ky debat. Ju lutem kur nguteni në vlerësime, dëgjojeni mendimin deri në fund.

Në qoftë se ky debat ka pasur një rëndësi është rëndësia që ato vërejtje që thuhet Ekipi i Unitetit t'i dëgjojë me vëmendje dhe në propozimet që do të ketë rast të shkojë në konsultime t'ia paraqet ato që janë të arsyeshme dhe mundësisht që munden të ndikojnë në përmirësimin e draftit final. Është e qartë që nuk jemi të gjithë të kënaqur me çdo pikë. ajo është e pa kontestueshme, megjithatë ne presim që drafti përfundimtar, megjithatë t'i pësojë disa ndërrime që do të jenë në favor tonin, në rend parë e dimë cila fjalë i mungon dhe ajo të inkorporohet.

Unë kam dashur shumë konkretisht të flas vetëm për dy çështje, të mos harroj të them se u tha këtu që Qeveria nuk ka përmend shumëçka. Edhe një fjalë po e them, mos të harrojmë që përgjegjësia është konform fuqisë politike. Shumë çështje që janë në pakon e Ahtisarit kanë qenë temë e debatit edhe në këtë Kuvend. Po e marr p.sh. decentralizimin. Askush s'ka qenë këtu kundër decentralizimit ,por ka pasur dallime në atë se si të ndodh, dhe kur të ndodh. Mos harroni pak të ktheheni të kaluarën dhe në debate në këtë Kuvend, ajo çka kam dashur të fokusohem është çështje e shëndetësisë që është në komuna që do të krijohen në komunat serbe, ato do të kenë mundësi mbikëqyrjeje edhe në nivelin sekondar që me Ligjin për shëndetësi për momentin komunat kanë kompetenca vetëm për nivelin parësor. Mendojmë që kjo mund të rishqyrtohet ,sepse për këtë kemi një sistem gjithëpërfshirës unik shëndetësor. nuk ka pas nevojë që t'i lihet kjo kompetencë komunave. Do të thotë kjo është një vërejte.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me trusnin pensional. Këtu lihet të kuptohet që ky trust do të vazhdojë të jetë si i tillë. Ajo çka duhet të mendojmë mirë se ne me gabimet tona që sot nuk e kemi këtu në Kuvend, proceduam Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, padrejtësisht i kemi lënë pensionistët në një situatë tejet të pavolitshme , ku është privuar e drejta e garantuese dhe e fituese me mundin e vet, pra duhet të dimë që po ta kishim ligjin dihet se ky trust do të jetë sistem i vullnetit të mirë, do të thotë njerëzit do të vendosin si shtyllë e tretë. Do të jetë, jo si tani si është edhe të mbesim pensionistët edhe më tutje me këtë pensionin bazë që e quajmë ndihmë sociale, ndërsa trusti suveren dhe fondet e Kosovës që flitet 230 milion sot menaxhohen jashtë Kosovës.

Këto kanë qenë vërejtjet se nuk kemi mendjen të marrim kohën në këto orët e vona dhe t'i ripërsërisim të gjitha ato që janë folur gjatë këtij debati. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit, me qenë se deputeti **Kamber Kamberi** ka hequr dorë, fjalën e ka deputeti Berat Luzha. Le të përgatitet **Kamber Kamberi**

DEPUTETI BERAT LUZHA – Ju faleminderit z. kryetar. Faleminderit edhe për rendin që më keni qitur krejt në fund.

Edhe unë pajtohem se dokumenti i Ahtisarit ka elemente pozitive, madje edhe elemente shtetërore, mirëpo për hir të së vërtetës duhet thënë se përveç elementeve pozitive dokumenti, apo pakoja e Ahtisarit ka edhe mjaft elemente negative, elemente të cilat Kosovën nuk e bëjnë shtet, së paku nuk e bëjnë shtet normal ashtu si e dëshirojmë ,por

më së paku e bëjmë shtet jofunksional , një shtet të ndarë në dy etnitete, i cili kurrë nuk mund të zgjidhë problemet e veta të cilat do të krijohen edhe si pasojë e kësaj pakoje. Ne e kemi pritur me padurim këtë pako, me shpresë së robërisë sonë po i vie fundi, se sakrificat dhe durimi ynë do të shpërblehen me liri, se ëndrrat tona shekullore më në fund po realizohen, se bashkësia ndërkombëtare do ta zgjidhë drejtë nyjën e Gordit të quajtur Kosovë, por pakos së Ahtisarit deri sa ajo erdhi në Kosovë si duket i kishin dalë po thuaj të gjitha virtytet. Asaj i kishte mbetur vetëm shpresa si kutisë së Pandorës. Jam i bindur se ky debat s'po bëhet si thuhet- si kofini pas të vjelave, tashmë nuk mund të mbrohet asgjë, madje, në Vjenë në bisedimet e ardhshme mund të humbim edhe më shumë. Ne jemi treguar shumë të kënaqur në këtë pako e cila nuk premtonte shumë. Disponim të kundërt kanë treguar autoritetet shtetërore të Beogradit të cilat realisht nuk kanë pasur të drejtë as të bëhen palë për negociatën. Ky debat është dashur të bëhet shumë më herët dhe atë disa herë në mënyrë që dokumentet e ofruara UNOSEK-ut nga pala kosovare paraprakisht të merrnin vizën në Kuvend. Tashmë, sipas kësaj pakoje ndarjen e Kosovës e kemi në tavolinë, e kemi reale. Formimi i komunave gjugje dhe rigorozisht etnike ,zonat e mbrojtura,vendet e rezervuara, shkalla e lartë vetëqeverisës për një etnitete të caktuar, votimi në Parlament që i hap derën obstrukcionit institucional bashkëpunimi ndërkomunal dhe tejkuftar si thuhet kompetencat vetanake të zgjeruar të drejtat e veçanta, përdorimi i dy gjuhëve zyrtare në tërë territorin e Kosovës, shtetësia e dyfishtë, regjistrimi i qytetarëve të Kosovës edhe në Serbi dhe në shtetet fqinj, pastaj universiteti autonom apo paralel paraqesin asimetri të padëgjuar në botën e sotme që e bëjnë pakicën serbe në Kosovë, “nebeski narod” apo shqip” popull hyjnor”, kurse Kosovën e bëjnë Bosnje të dytë. Është interesant se askush deri më tash nuk i ka parë tri pika shumë domethënëse në aneksin 3.

Në pikën 9.1.2 të aneksit 3 pra parashihet “themelimi i një organi vendimmarrës i përbërë nga përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se komunat serbe kanë të drejtë sipas këtij dokumenti të themelojnë hiç më pak se një organ vendimmarrës ,domethënë një parlament apo një Kuvend apo një **Skupshtinë** si do ta quanin ata.

Në pikën 6.1.1. të aneksit të njëjtë thuhet: Autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kërkojë nga komuna të rishqyrtojë vendimet që konsiderohen si jo të pajtueshme me kushtetutën, apo ligjet në fuqi. Kërkesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit apo të aktit tjetër, do të thotë, qendra nuk ka mundësi të ndikojë që të shfuqizohet një vendim i një komune të caktuar edhe nëse është në kundërshtim me ligjet dhe me kushtetutën.

Komunat serbe sipas këtij dokumenti kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komunat, institucionet dhe agjencitë qeveritare të republikës së Serbisë.

Ky bashkëpunim do të përfshinte, siç thuhet edhe asistencën financiare dhe teknike, donacionet nga Qeveria e Beogradit do të jenë publike, por ato do të kalojnë përmes ndonjë banke serbe që është e regjistruar në Kosovë dhe për to vetëm do të njoftohet Thesari Qendror, do të thotë financat nuk do të kalojnë përmes institucioneve të Kosovës. Pse Grupi Negociator nuk ka kërkuar nga Ahtisari dhe UNOSEK-u që asimetria mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë të shndërrohet në një simetri reale në mes serbeve të

Kosovës dhe shqiptarëve në Kosovën Lindore. Pse pajtohemi kaq lehtë me formulimin në pako për kufizimin me Maqedoninë që është një zgjidhje djallëzore e Qeverisë së Beogradit kur këtë problem duhet dhe mund ta zgjidhin institucionet kompetente të Kosovës dhe të Maqedonisë. Kisha ortodokse serbe sipas dokumentit gëzon mbrojtje, të drejta, privilegje imunitet, ajo do të gëzojë edhe privilegje doganore dhe tatimore. Çka nëse këtë mbrojtje, këto të drejta, këto privilegje dhe këtë imunitet i keqpërdor për qëllime politike dhe për qëllime të tjera destruktive. Me gjithë këto vërejtje për mua është shumë parimore dhe përsëri jam optimist se gjërat do të ndryshojnë për të mirë gjatë zhvillimeve të mëtejshme. Unë ende shpresoj se bashkësia ndërkombëtare nuk do të na zhgënjëjë edhe këtë herë. Por lirinë dhe pavarësinë ne e kemi fituar me gjakun e bijve më të mirë të popullit tonë, e kemi fituar me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në krye me komandantin legjendar, Adem Jasharin. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA –Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputeti Gjergj Dedaj.

DEPUTETI ZEF MORINA – Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit, i nderuari president i Kosovës dr. Fatmir Sejdiu, i nderuari z. kryeministër, të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit, ministra të nderuar zonja dhe zotërinj.

Populli i Kosovës me padurim ka pritur shpалosjen e pakos së presidentit Ahtisari në të cilin është përcaktuar zgjedhja e statusit të Kosovës. Dy shkurti i vitit 2007, pa dyshim është ndër ditët më të rëndësishme të Kosovës dhe popullit të saj. Presidenti Ahtisari paraqiti propozimin në të cilin përcaktohen konturat e shtetit të Kosovës.

Shikuar në përgjithësi ky projektdokument është mjaft i rëndësishëm, sepse hap rrugën për krijimin e shtetit të Kosovës, rrugë e cila mendoj se nuk është edhe aq e lehtë. Kjo brengë jona bazohet në çështjet që kanë të bëjnë me detaje që përmban në brendi projektdokumenti. Gjatë analizimit të neneve dhe të anekseve të këtij dokumenti kemi vërejtur mjaft elemente të cilat do të paraqesin vështirësi në krijimin e bazave të shtetit të Kosovës, siç janë, kushtetuta, ligjet bazike, simbolet vendimarrëse në institucione dhe shumë gjëra të tjera të cilat varen nga disponimi dhe vullneti i pakicave ,veçanërisht i pakicës serbe. Këtë e bazoj në të drejtën që i është dhënë komunitetit serb, e cila mund të keqpërdoret për të penguar funksionimin dhe zhvillimin e punëve në institucionet shtetërore dhe lokale.

Zonja dhe zotërinj , më lejoni të bëj një krahasim të thjeshtë. Pakoja po të merrej si tërësi është e njëjtë me një godinë e cila nga distanca duket shumë e bukur, ndërsa pasi të hyhet brenda ka shumë vërejtje të cilat banorët i bëjnë të pakënaqur dhe po qe se nuk përmirësohen ato nuk do të jenë të lumtur për të jetuar në to. Gjithashtu edhe detajet në këtë projektdokument duhet të përmirësohen ,në mënyrë që statusi të jetë i pranueshëm për qytetarët e Kosovës. Vërejtjet kryesore ,të cilat duhet të përmirësohen në këtë projekt dokument janë: çështja e decentralizimit dhe kompetencat që u janë dhënë pushteteve lokale. Mendoj se këtu nuk bëhet fjalë për bartjen e përgjegjësi në nivelet lokale, por thjesht shkëputja nga përgjegjësia që duhet të kenë nivelet komunale karshi pushtetit qendror, si dhe krijimi i komunave me shumicë dërmuese të populluar me serbë.

Trashëgimia fetare dhe kulturore në këtë fushë si e veçantë i është dhënë Kishës Ortodokse Serbe, gjegjësisht kishave, manastireve dhe pronës së tyre. duke u përmendur fare pak ,besimet e tjera, të cilat përbëjnë mbi 90% të popullatës së Kosovës, atë të besimit islam- katolik dhe protestant. Çështje tjetër e cila na brengos është çështja e TMK-së. Neni 9.6 thotë se TMK një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje duhet të shpërbëhet. Mendoj se gjatë themelimit të forcave të sigurisë së Kosovës përparësi të kenë pjesëtarët e TMK-së gjithnjë duke zbatuar kritere dhe standarde që përcakton NATO-ja, gjegjësisht që TMK-ja mos të shpërbëhet, por të transformohet në forcën e sigurisë së Kosovës, pra në ushtri të Kosovës, sepse vetëm kështu do të vlerësohet lufta dhe angazhimi i tyre për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Me borxhe dhe me kredi ndërkombëtare Kosova ngarkohet pa të drejtë, që i ka marrë Serbia ,gjoja se për Kosovën ,duke ditur se me ato mjete Serbia ka luftuar dhe ka djegur Kosovën. Këtu nuk përmendet pasuria monetare ish -Jugosllavisë që i takon Kosovës, gjithashtu nuk përmenden pensionet dhe kursimet e qytetarëve të Kosovës që Serbia i ka përvetësuar dhe keqpërdorur. Çështja e kufirit me Maqedoninë. Assesi nuk mund të pranohet që 2500 hektarë të Kosovës t'i dhurohen Maqedonisë ,sepse në këtë mënyrë do të vijë deri te ndryshimi i kufirit të Kosovës. Në nenin 3.3. të aneksit 8 thuhet. Territori i Kosovës do të definohet nga vija kufitare e ish- Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda ish RSFJ-jë ashtu siç ka qenë vija kufitare e 31.12.88 dhe të fshihet pjesa tjetër ,sepse nuk paraqet vullnetet e institucioneve dhe as të popullit të Kosovës.

Vendet e siguruara dhe më vonë të garantuara për komunitetet pakicë do të jenë pengesë për funksionimin e institucioneve të shtetit të Kosovës, të cilat në rastet e caktuara mund të paralizojnë jetën institucionale dhe parlamentare. Këto superkompetenca që janë caktuar për minoritetet nuk i kanë as vendet më demokratike të Evropës dhe botës. Për të pagjeturit është folur shumë pak, shumë pak rëndësi i është dhënë edhe çështjes së të pagjeturve. Këtu mendoj që Ekipi i Unitetit duhet të kërkojë takstativisht mënyrën dhe kohën e zbardhjes së fatit të të pagjeturve dhe të mos lihet si një kërkesë e cila mund të zgjasë me decenie.

Serbia jo vetëm që ka bërë gjenocid mbi popullin shqiptar të Kosovës, por i ka shkatërruar në themel ekonominë dhe pasurinë e vendit, kështu që duhet të kërkohet kompensimi i dëmeve të luftës nga Serbia.

Nuk mund të pranohet që komuna të caktuara të kenë kompetenca shtesë siç janë Mitrovica e Veriut, Graçanica dhe Shtërpca,sepse në këtë mënyrë do të shkelej kushtetuta e cila garanton të drejtat e njëjta për të gjithë qytetarët dhe komunat e Kosovës. Prania ndërkombëtare duhet të jetë më e butë ,sepse sipas këtij projektdokumenti përfaqësuesi civil ndërkombëtar gjegjësisht përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian, është autoriteti fuqiptotë dhe vendimmarrës, kështu që Kosova po shndërrohet në një Bosnje të dytë. Gjithashtu kërkohej që të përcaktohet afati kohor i mandatit të kësaj pranie. Kërkojmë që gjithsesi në dokumentin final të presidentit Ahtisari që do t'i prezantohet Këshillit të Sigurimit të OKB-së të paraqitet fjala pavarësi në mënyrë që Parlamenti i Kosovës menjëherë të shpallë pavarësinë dhe të kërkojë njohjen nga bashkësia

ndërkombëtare. Ka edhe shumë gjëra të cilat mund të paraqiten ,por për shkak të kohës së limituar këto do t'ua prezantojmë me shkrim. Kërkojmë nga Grupi Negociator që këto vërejtje t'i marrë parasysh dhe të insistojë në përmirësimin e tyre dhe në përgjithësi e përkrahim punën e Grupit Negociator dhe Pakon e Ahtisarit. gjithnjë duke e kërkuar përmirësimin e këtyre vërejtjeve që u cekën më lart.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Falën e ka deputeti Gjergj Dedaj, le të përgatitet deputeti Sabit Rrahmani.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Shumë respekt z. president, z. kryeministër z. kryetar i Kuvendit, z. Thaçi, Surroi, kolegë deputetë, ministra, mysafirë.

Deri më dy shkurt, kur presidenti Ahtisari e shpalli planin, jam munduar me dhanë kontributin ndoshta me qenë një deputet i mërzitshëm i këtij Kuvendi të Kosovës pa asnjë tendencë vetëm me arrit atë çka mund të bëhet të nxjerrim nga ky projekt diçka më tepër. Pas shpalesjes së këtij plani, unë konsideroj dhe flas në emër të Partisë Liberale të Kosovës, një partie e vogël në Kosovën e vogël, që duhet pas dy shkurtit të jemi të guximshëm të jemi unik, të jemi të dinjitetshëm dhe të përgjegjshëm.

Në radhë të parë për shkak se për këtë ditë historike është derdhur shumë gjak dhe na vjen keq prej atij gjaku që shpeshherë ndoshta e përmendim dhe hyjmë në gjynah.

Për këtë ditë historike bashkësia ndërkombëtare miqtë tanë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Bashkimi Evropian kanë investuar dhe kanë dhënë kontribut crucial. Për këtë ditë populli i Kosovës, të cilit duhet t'i adresohet dhe dedikohet gjithë kjo meritë, d.m.th. kemi pritur këtë ditë me shumë gëzim. U thanë shumë vërejtje, u thanë shumë kritika, i kuptoj se shqetësimet kanë qenë shumë me vend, por në këtë rast unë kujtoj se meqenëse Ekipit Negociatorë i kanë mbetur edhe disa konsultime duhet të japim një mbështetje pa rezervë. E di se politika nëse është art e ne artistë nuk domethënë që duhet të harrojmë disa çështje që janë më cruciale dhe ma të mëdha se ne dhe është fati i Kosovës dhe ardhmëria e fëmijëve tonë.

Kështu që sinqerisht shfrytëzoj rastin që këta liderë që janë para nesh këtu prej dy shkurtit t'i inkurajojmë dhe të themi se e kanë mbështetjen e plotë të Partisë Liberale të Kosovës. Unë mund të flasë vetëm në emër të anëtarësisë, të Partisë Liberale të Kosovës, pa asnjë rezervë, e më vonë do ta kuptoni pse, sepse po bëhet realitet ajo për të cilën kemi sakrifikuar të gjithë, po bëhet realitet shteti i Kosovës ,po bëhet realitet miqësia e përhershme jona dhe po hapet rruga historike e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian në NATO dhe në të gjitha struktura e tjera verioatlantike.Prandaj ,të mos e zgjas shumë se jemi ndoshta edhe të lodhshëm edhe të frustruar nga kjo pritje 8 -vjeçare dhe nga ky rrugëtim 17 vjeçar ,100- vjeçar, 50- vjeçar sa të doni i këtij populli të martirizuem edhe një herë prej dy shkurtit i përgëzojë këta bura, këta liderë dhe inkurajojmë që të kthehen nga Vjena edhe të na vijë një lajm historik nga Nju Jorku që edhe Uashingtoni edhe Brukseli edhe Londra shumë shpejt do ta bëjnë realitet shtetin e ri dhe të pavarur të Kosovës. Shfrytëzoj rastin të përshëndes të gjitha familjet e dëshmorëve, pjesëtarët e UÇK-së, familjet e martirizuese që i kanë dhanë gjithçka

Kosovës. E shfrytëzoj rastin që edhe një herë presidentit Sejdiu, kryeministrit Çeku, kryetarit të Kuvendit Berisha, z. Thaçi, z. Surroi t'u dëshiroj punë të mbarë në finalizimin e kësaj marrëveshjeje historike.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit z. Dedaj, fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani, le të përgatitet Fetah Berisha.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari kryetar Sejdiu, i nderuari kryeministër, të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit, të nderuar deputetë. Edhe pse e di që ka humbur përqendrimi i deputetëve të Kuvendit për me dëgjuar në lidhje me këtë temë, meqenëse unë mendoj se shumica çka kanë mbetur dëshirojnë që t'i japin pikëpamjet e tyre se ata që kanë thënë fjalën kanë shkuar se nuk u ka interesuar më tepër vetëm me folë diçka dhe me ecë, meqenëse jemi duke biseduar rrafsh qe 8 orë në lidhje me këtë pikë. Mua më ka shtyrë diçka me menduar pse bashkësia ndërkombëtare shkon me hapa të breshkës në Kosovë, me një fjalë popullore tu prek, gjithmonë e kam pyetur vetveten pse aq ngadalë procesi në Kosovë dhe çka është me rëndësi për bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë? Gjithmonë kam menduar që diçka është e rëndësishme në Kosovë që bashkësia ndërkombëtare nuk po mund ta zgjidhë problemin ashtu qysh kërkon vullneti politik i shumicës shqiptare.

Me ardhjen e pakos së Ahtisarit në Kosovë atëherë e kam parë realitetin pse bashkësia ndërkombëtare e ka vonuar procesin në Kosovë edhe çka ka qenë e rëndësishme për ta. Duke marrë parasysh që 80% dokumenti i tij flet për serbët e Kosovës, do me thanë për bashkësinë ndërkombëtare vetë pakoja e Ahtisarit ka dëshmuar se cila ka qenë rëndësia e saj në Kosovën e pasluftës.

Për bashkësinë ndërkombëtare nuk ka qenë interesante që prej vitit 1912 deri në vitin 1999 t'i marë parasysh të gjitha vuajtjet e komunitet shqiptar, por edhe vuajtjet e komuniteteve të tjera të cilët e kanë përkrahur qëndrimin e vullnetit politik të shqiptarëve shumicë.

Besoni që në vitin 1998 dhe 1999 në kohën e luftës në Kosovë unë nuk do të them sikur në kohën e konfliktit sikur që po dalin edhe disa reklama në televizion në kohën e **konfliktit për** për mua ka qenë luftë edhe kurrë nuk mundet me qenë konflikt. Besoni që komuniteti ashkali e njashtu edhe komuniteti egjiptas që gjuhë amtare e kanë gjuhën shqipe, kanë qenë shtypur prej regjimit. Unë nuk them prej serbëve se kurrë nuk mundet me u akuzua kolektivi për individ, nuk flas për serbët por flas për regjimin e Milosheviqit, i cili ka qenë shumë shtypës edhe kriminal dhe komuniteti ashkali me komunitetin egjiptas i kanë parë ato pasoja dhe vetvetiu kanë qenë të shtypur edhe ata.

Vetëm për atë arsye që e kanë folur gjuhën shqipe, meqenëse ne gjuhë amtare përveç shqipes nuk kemi. Këtë desha me lidhë me një fjalë që nuk po potencoj emra se ndoshta lyp dikush replikë edhe kërkon me marrë kohë, me atë çka thanë disa deputetë këtu, që pakicat kanë qenë të shtypura, kanë qenë të përndjekura. Dëgjoni në Kosovë ka pasë kampe edhe ka hala, ka në Plemetin, ka në Mitrovicë, ka pasë kampe edhe në kohën e

pasluftës janë mbushë edhe disa shkolla me pjesëtarë të komuniteteve. Po kush i ka bërë këto?.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka pasë vizion, meqenëse prej kohës e kam përkrahur dhe jam në rrjedhje se çka ka dashtë me ba Ushtria Çlirimtare e Kosovës në luftën e Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka pasë vizion me përndjek pakicat, shumica shqiptare njerëzit e vetëdijshëm që e kanë desh këtë tokë nuk e kanë pasë vizion me i përndjekë pakicat, po ata që i ka përndjekë pakicat për Sabit Rrahmanin nuk janë shqiptarë, abs. Një pjesë e tyre kanë qenë ekstremistë, që kanë qenë edhe kundër shqiptarëve, kanë qenë kundër proceseve në Kosovë, kanë qenë kundër pavarësisë së Kosovës, që faktikisht kanë qenë dirigjum prej regjimit të Millosheviqit që Kosovën kurrë të mos e lanë rehat edhe m'u zhvilluar edhe ekonomikisht edhe në mënyrë kombëtare dhe në të gjitha drejtimet e tjera.

Vetë ngjarjet e 17 dhe 18 marsit e kanë treguar një send të këtyllë për shembull më 17 dhe 18 mars nga Vushtrria janë larguar 52 familje të komunitetit ashkali, por kryeministri Rexhepi ka ardhur dhe i ka demantua të gjithë ata njerëz që kanë bërë këto sende. Faktikisht për mua tani ata nuk kanë as komb, as fe edhe bile më së paku mund të quhen shqiptarë. . Shqiptarët kanë qenë të shkelur edhe unë e di që një popull që ka qenë vet i shkelur dëshiron që komunitetet e tjera të cilat e ndiejnë veten pak si anash i çojnë më përpara që të kenë përparësi.

Unë kam besim të plotë edhe te shqiptarët edhe te ky Grup i Unitetit që mund ta bëjë një gjë të tillë.

Proceset pozitive në Kosovë kah kanë rrjedhë, unë pajtohem me fjalën e profesor Hamiti që tha edhe mua pak më preki që nuk u përmend kryetari Rugova. Unë mendoj që kontributi i tij është pjesë e këtyre proceseve, ka qenë shumë i nderuar, shumë i qetë, i butë që nuk ka dalluar as ngjyrë, as fe e as racë.

Gjithë ky proces është vazhdimësi edhe përpjekje e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për një shtet të pavarur dhe sovran. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka luftuar kundër serbëve të Kosovës. Sot njerëzit shkojnë në Hagë edhe gjykohen për krime lufte jo, jo. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka luftua për dinjitet, ka luftua për të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët e pranojnë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran dhe e pranojnë realitetin e ri të krijuar në Kosovë e pas luftës, do me thënë vizioni i tyre ka qenë që edhe në Kosovën e pasluftës të jetë një demokratike paqësore për të gjithë komunitetet.

I gjithë ky proces është edhe vazhdimësi e miqve tanë ndërkombëtarë. Me qenë se z. Haliti tha këtu që Këshilli i Sigurimit edhe Ahtisari nuk e bjen pavarësinë, por kjo do të varet prej Kuvendit. Unë e kam një propozim konkret z. Kryetar, që atë ditë kur Kuvendi i Kosovës ta shpallë pavarësinë dy miqë shumë të ngushtë të Kosovës që lidhen ngushtë me fatin e shumicës shqiptare të jetë pjesëmarrës këtu. Ish kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës z. Bill Clinton dhe ish- administratori i OSBE-së Viliam Voker, kjo është propozim që unë e jap.

I gjithë ky proces është vazhdimësi e komunitetit shqiptar që gjithmonë ka qenë i gatshëm t'i përkrah pakicat, por edhe vazhdimësi e komuniteteve joserbe që gjithmonë ka qenë pjesë e mbështetjes dhe nuk kanë penguar vullnetin politikë shumicës shqiptare.

Kur është fjala te dokumenti i Ahtisarit, gjithë atë që e ka thënë z. Xhevat Bislimi dhe dr. Numan Baliq e mbështes edhe pse të tjerët kam qenë me një masë e kanë dhënë kontributin e vet po ata që më kanë pëlqyer më së tepërmi edhe kanë thanë që duhet me thanë janë këta.

Grupi i Unitetit duhet t'i ketë tri gjëra ose tri pika parasysh që nga Rezoluta që është nxjerr prej Kuvendit të Kosovës. Pikën 2 Kuvendi garanton konfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës për pavarësi nëpërmjet referendumit. Kjo është nën 1.

Nën 2, Kuvendi i Kosovës garanton tërësi territoriale të Kosovës dhe të pacenueshme të kufijve të saj, është pika 8 e Rezolutës. Në këtë rast keni shumë kujdes në kufirin Maqedoni dhe me Mitrovicën, sidomos me Mitrovicën nëse serbët e atjehitë dëshirojnë që të bëjnë një autonomi, Qeveria e Kosovës edhe Grupi i Unitetit duhet që menjëherë të reagojë.

Dhe pika 10 e kësaj rezolute thotë që Kuvendi i Kosovës, duke mbështetur Grupin e Unitetit do ta përcjellë gjithë procesin e punës së tij dhe çdo vendim merr për të ardhmen e Kosovës që të ratifikohet në Kuvend apo nëpërmjet referendumit, kjo nuk është bërë deri tash, kjo pikë është shkelur.

Grupi i Unitetit është e dyta herë është që vjen në Kuvend të Kosovës edhe nuk i ka ndarë mendimet dhe qëndrimet e Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës sidomos Grupi Parlamentar për Integrim ka kërkuar që Grupi i Unitetit të vijë edhe më herët këtu, por kjo ftesë nuk është marrë parasysh në Grupin e Unitetit

Në nenin 2 në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dokumenti i Ahtisarit pakicat joserbe, por edhe shumicën siç tha z. Sabri Hamiti asnjëherë nuk është përmend, pakicat sidomos, pakicat joserbe i ka karakterizuar në kategorinë e dytë të njerëzve që nuk është hera e parë që e bëjnë këtë, askund s'jemi përmend, vetëm për vendet e rezervime.

Serbia flitet që Kosova do t'i kthejë disa borxhe Serbisë, por Grupi i Unitetit e ka për obligim që edhe nga Serbia të kërkojë dëmshpërblim për gjithë infrastrukturën e shkatërruar në kohën e vitit 1990 – 1999.

Plus asaj neni 9 sa i përket sektorit të sigurisë përbërje e TMK-ës unë them transformim i TMK-ës apo reformim i TMK-ës e jo të jepë të shpërbëhet kjo TMK se unë mendoj që do ta zhdukë edhe një pjesë të historisë të cilën e kemi lënë mbrapa.

Sa i përket decentralizimit këtu flitet për komunat serbe edhe absolut duke marrë parasysh Këshill konsultativ i komuniteteve përfaqësuesit e tyre p.sh. për Vitomiricë, për Reçanë ... për shumë sende që kemi thanë na atje.

Vendet e rezervime ju kisha lutë këtu mos u lidhni në vendet e rezervume, gjithë pakicat joserbe që janë në këtë Kuvend të Kosovës binduni që do t'i mbështesin interesat e shumicës shqiptare. Votimin e dyfishtë ne nuk jem pjesë e pengesave edhe pjesë që ta pengojmë procesin demokratik edhe në Kosovën pas statusit, absolutikisht komunitetet joserbe nuk janë për atë që ta shfrytëzojnë atë votim dyfishtë në dëm të shumicës. Bile, bile po të kishim ra në harmoni me kolegët e mi.....

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputetja Flora Brovina.

DEPUTETI FETAH BERISHA – I nderuari zoti kryetar i Parlamentit, i nderuari kryetar i Kosovës, kryeministër e ministra, anëtar të Grupit Negociator dhe të çmuar kolegë deputetë. U fol dhe u shkrua shumë në të gjitha mediat kombëtare dhe ndërkombëtare për Paketën e Presidentit Ahtisari për statusit final të Kosovës. U parafrazua nga shumë analistë se Paketa përfshinë këtë ose atë, u lakua shumë herë edhe emri 2005 si i rëndësishëm për Kosovën, ndërsa viti 2006 u trajtua si vit i pavarësisë së Kosovës.

Tani dokumentin e Presidentit Ahtisari për statusin e Kosovës të gjithë e kemi para vetës dhe po debatojmë pasi i është shpalosur institucioneve të Kosovës dhe Serbisë. Ky dokument edhe pse nën ankth u mirëprit nga shqiptarët si fillim legjitim i procesit në këtë fazë drejt pavarësisë së Kosovës. S'ka si të kuptohet ndryshe kur në vete ngërthen elementet bazë të shtetësisë së Kosovës dhe pse faktikisht nuk e përmend emrin pavarësi. Po ashtu dokumenti u vlerësua tejet pozitivisht edhe nga Grupi Negociator, Grupi i Kontaktit, analist e qarqe të ndryshme diplomatike ndërkombëtare. S'kish pse të mendojmë ndryshe për punën me përkushtim që kishte bërë për Kosovës ky diplomat i rryer i kombit.

Të nderuar deputetë,

Sado i përsosur të jetë dy dokument për finalizimin e statutit të Kosovës për Serbinë është i papranueshëm. Regjimi i sotëm i Beligradit nuk bjen dakord kurrë të heqë dorë nga kolonia Kosovë. Mirëpo mbi 2 milionë shqiptarë të Kosovës kur s'mund të pajtohen që të jetojnë me Serbinë apo nën mbikëqyrjen e pakicës serbe të cilën e përbëjnë 5% në Kosovë, siç ka ndodhur në të kaluarën. Jo, kjo s'mund të ndodhë edhe për faktin sot dihet botërisht se historia e dhembshme e tragjike e Kosovës, e cila rreth një shekull përjetojë torturë për qeset montuara politike, dënime me shumë vite burg, shpërngulje me dhunë e vrasje e masakra siç ndodhi në luftën e fundit.

Pra, Kosova ka të drejtë e do të jetë e lirë. Kosova duhet të gëzojë pavarësinë dhe sovranitetin e saj. sepse Kosova e robëruar nënkupton Ballkanin e trazuar, kurse Kosova e pavarur fuqimisht reflekton stabilitet në këtë rajon gjithmonë të trazuar. Historia e dhimbshme dhe tragjike e Kosovës nuk mund të krahasohet me asnjë vend të Kaukazit as me krahinat në Jug të Gjeorgjisë ,ngase në Kosovë ndodhi holokausti, kolonizimi me elementin serb me qëllim që, të ndërrimit të strukturës etnike.

Ende bijtë e masakruar të Kosovës nuk dihet në cilat gropa të Serbisë i kanë futur të masakruar paramilitarët, ushtria dhe policia kriminale serbe. Kur flitet për pakicat sikur duket e vërtetë se të drejtat e pakicave në mes tyre ndryshojnë. Në këtë kontest duhet cekur sikur kështu fitohet përshtypja se minoriteti serb po potencohet si tejet i dallueshëm dhe sikur fitohet përshtypja se minoritetet tjera lihen në plan të dytë dhe lihen nën hijen e përkëdheljes së minoritetit serb, i cili ende nuk është integruar në Kosovë. Po ashtu fitohet përshtypja në shumë momente sikur minoriteti serb është viktimë e shqiptarëve të viktimizuar rreth një shekull nga regjimet serbijane.

Të çmuar deputetë,

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare është detyrë imediateve e njerëzimit. Shqiptarët gjatë historisë janë dëshmuar në këtë lëmi. Për të gjithë tani është e ditur se shqiptarët që kanë mbrojtur dhe ruajtur kishat ortodokse në Kosovë quheshin vojvodë. Mirëpo nuk duhet ndodhë dhe të bëhet dallimi i asnjë minoriteti, feje apo trashëgimie, si të shpjegohet rasti.

Kisha e Sokolicës në Zveçan të Mitrovicës e cila bashkë me 40 e sa kisha të tjera është futur në zonën mbrojtëse, e dihet mirëfilli se kjo kishë është ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Këtë e vërtetojnë edhe shumë burime dokumentare kishtare shtetërore serbe. Problemi është se, kompleksi i memorialit i Kullës së Isa Buletinit futet në kuadër të zonës mbrojtëse të manastirit të Sokolicës. Pra, sikur reflekton se traditat, tapia e **venalija**, siç thotë populli u fut nën çadrën e qipqisë. Kjo ndryshe nuk shpjegohet kur dihet se serbët gjatë historisë kanë qenë përvetësuesit më të mëdhenj të vlerave të kulturave të tjerëve kanë qenë edhe përvetësuesit e të tjerëve.

Kishat bizantine dhe katolike, serbët i përvetësuan në Kosovë dhe në themelet e tyre i ngritën kishat ortodokse serbe. Prandaj, është momenti për hir të së vërtetës që edhe Ekipi Negociator t'i verë në përdorim edhe faktet historike, në mënyrë të qartë e të vërtetë të shpjegojë për manastiret fetare në Kosovë. Po ashtu për hir që të mos ketë dallim te vlerave kulturore duhet të caktohet një zonë mbrojtëse e veçantë edhe për kishat katolike shqiptare në Kosovë edhe për mauzoleun e Sulltan Muratit dhe Tyrben e Bajraktarit, e të mos futet nën zonën mbrojtëse të Gazimestanit ku perandoria e Car Dushanit në luftën e Kosovës më 1389 pësoi disfatë aty ku regjimi serbian pat festuar mbase një herë këtë humbje.

Në aneksin 5 zona mbrojtës për lokacionet në mesin e mbi 40 kishave e manastireve është futur edhe zona mbrojtëse e fshati serb Hoxhë e Madhe, fshati i komunës së Rahovecit, i cili në bazë të Rregullores 2000/45 në konsultim me komunën do të ushtrojë autorizimin për trashëgiminë fetare dhe lëmin mbrojtëse. Ky fshat i Rahovecit dhe trashëgimia e tij fetare asnjëherë nuk ka qenë i rrezikuar nga fqinjët shqiptarë përkundrazi. Prandaj, të shpallet zonë e mbrojtur që nënkupton rrezikimin nuk kërkon me realitetin.

Në aneksin 8 thuhet, se duhet të negociohet në bazë të një farë marrëveshjeje në mes Maqedonisë dhe Kosovës dhe kështu që këtu kemi besim se gjatë negociatave Kosova me

Maqedoninë do të merren vesh dhe 2500 hektarë tokë do t'i kthehen Kosovës ,e cila ishte bërë pazar pa hanxhinë. Sidoqoftë pakoja apo dokumenti para final që solli presidenti Ahtisari për Kosovë është lajmëtar i parë i pavarësisë është i arsyeshëm është edhe i pranueshëm për ne i vlerësuar si punë cilësore e një diplomati të rryer prandaj për këtë arsye edhe e gëzoj përkrahjen e merituar anë e këndë Evropës demokratike dhe qarqeve të tjera diplomatike në botë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit . Nuran Malta, nuk është këtu, Sylfije Hundozi, nuk është, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën, s'është as ky. Deputetja Hatixhe Hoxha.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. kryetar, anëtarët e Grupit të Unitetit të nderuar deputetë. Ne sot po diskutojmë për propozimin për marrëveshjen për statusin e Kosovës. Prandaj dhe qasja jonë në lidhje me këto çështje do të thojë shumë të ndjeshme nuk ka si të mos kërkojë seriozitetin tonë të shtuar.

Unë dëshiroj të ndalem në disa nene për të shprehur rezervat, por edhe shqetësimin tim. Prandaj, dëshiroj të përqendroj vëmendjen tuaj në këto nene.

Aneksi 3 që ka të bëjë me decentralizimin i cili fillon kështu citoj.
Do të themelohet një sistem i avancuar dhe i qëndrueshëm i vetëqeverisjes lokale në Kosovë për trajtimin e shqetësimeve legjitime të serbëve të Kosovës. Përfundon citati.
Sipas këtij pasuesi dëshmohet se decentralizimi po bëhet për serbët dhe jo për qytetarët e Kosovës në përgjithësi, siç është proklamuar tash e sa kohë.

Në nenin 6.1.1 për autoritetin mbikëqyrës administrativ. Mendoj se siç shihet ky nen dëshmon pamundësinë e ndërhyrjes së institucioneve qendrore në komuna dhe në rastet kur vendimet e tyre janë në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Neni 8.4 u referohet privilegjeve të rezervuara për komunat me shumicë serbe në aspektin financiar e ku thuhet se. Citoj:
Komuna do të kenë të drejtë në fonde qendrore shtesë.

Propozimi në nenin 12.4 mendoj se ky nen mundëson krijimin e numrit të pakufizuar të komunave me shumicë serbe ku thuhet citojmë:
Kosova do të hyjë në konsultime me komunitetin jo shumicë, në rastet kur ky komunitet përbën së paku 75% të popullsisë në një vendbanim të përqendruar me një popullsi të gjithmbarshme prej së paku 5000 banorë. Përfundon citati.

Ndërsa në lidhje me themelimin e komunave të reja përfshirë kufijtë administrativ në nenin 14.2 thuhet:
Kufijtë mund të shqyrtohen dhe ndryshohen nga PCN shqyrtimi do të marrë në konsideratë zhvillimet demografike dhe në veçanti kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur. Përfundon citati.

Ndërsa neni 14.1. thotë:

Republika e Serbisë do ta autorizojë regjistrimin e refugjatëve.

Në neni 14 aneksi 3, i cili bënë fjalë për refugjatët e ku thuhet se refugjatët në shtetet fqinje të Kosovës do të regjistrohen, nuk bënë fare fjalë apo nuk i përmend fare shqiptarët që lëshuan Kosovën me vite të tëra dhe u vendosën në shtetet e ndryshme.

Në nenet 4.1.3. pikë b) dhe 7.1.1 në lidhje me të drejtat e minoritetit serb në komunat e tyre përveç tjera thuhet se. Ju njihen të drejtat e avancuara pjesëmarrësve në zgjedhje dhe shkarkimin e komandantëve të stacioneve të policisë dhe se në shkolla të cilët vijojnë mësimin në gjuhën serbe mund të zbatojnë plan programet e Serbisë.

Në aneksin 6 neni 1.1 si shehet edhe në nenin 8 që ka të bëjë me çështjet ekonomike dhe pronësore pika 8.2 ku bëhet fjalë për borxhet ndërkombëtare ndër të tjera, thuhet se. Kosova do të marrë përsipër pjesën e vetë të borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë. Askund nuk përmendet që Kosova të jetë trashëguese e një pjese të pasurisë së ish - RSFJ-ës ne duhet të shqyrtojmë jo vetëm ndarjen e borxhit por edhe pasurinë e përbashkët. Nuk ka kuptim që një vend të trashëgojë obligimet dhe jo pasuritë, përveç saj prona që po i mbetet Kosovës ajo që gjendet në Kosovë është shkatërruar nga Serbia para dhe gjatë luftës.

Përveç shkatërrimeve çdo amortizim i pronës në Kosovë që është shkaktuar nga Serbia duhet të zvogëlohet nga borxhi që trashëgohet nga Kosovës. Mendoj se në këto dokumente duhet të përfshihen kompensimet e dëmeve të luftës Serbisë duhet t'i ngarkohen.

Nën 1, Kompensimi i dëmeve të luftës, duke përfshirë shkatërrimin ekonomive familjare, kompensimin e viktimave të luftës, fondin pensionalë, humbjet e shkaktuara nga papunësia e shfrytëzimit të pronës.

Në aneksin 11 në nenet 2, 3 dhe 4 ku flitet për mandatin dhe autoritetin e përfaqësuesit civil ndërkombëtar edhe unë dakordohem me përfaqësuesit që parafolësit më herët që folën se vërtetë flitet për kompetencat tepër të mëdha që është dhënë misionit ndërkombëtar.

Të nderuar deputetë,

Mendoj se duhet të rishikohet veçmas me shumë kujdes edhe çështje si ajo e TMK-ës e Kuvendit e sidomos ajo për shkak të votimit që e përmendën disa më herët çështja e kufijve. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Flora Brovina, le të përgatitet deputetja Gjylshene Berisha.

DEPUTETJA FLORA BROVINA – Faleminderit z. kryetar. Të nderuar anëtarë të Grupit të Unitet, z. kryeministra dhe kolegë.

Pakoja e z. Ahtisari për Kosovën nuk është një çështje e vlerësimit të një gote a është më shumë e zbrazët apo më shumë e mbushur. Por është një çështje më shumë se aq. A rezulton kjo me pavarësinë funksionale dhe me seperacionin e vërtetë nga Serbia, kjo është çështja.

Pakoja le mundësi për vështrim të ndryshëm dhe hapësirë për interpretim dhe për përmirësim, natyrisht.

Vërtet u angazhuam dhe besuam në një Kosovë shtet të qytetarëve të barabartë dhe u angazhuam e u pajtuam për përkujdesje të veçantë të minoriteteve por pakoja është më shumë se kaq. Ajo me të vërtetë zyrtarizon enklavat në emër të decentralizimit. Decentralizimi askund në botë nuk është njënacional dhe në emër, por ndodh në emër të qytetarëve dhe në dobi të tyre. Dhe shembulli konkret le të jetë komuna e re Novobërda ku qytetari për një certifikatë duhet të udhëtoj 30 deri 40 kilometra. Kjo pra nuk ju afron shërbim qytetarit.

Decentralizimi njënacional në shëndetësi, nuk është një çështje e re e sjellur për herë të parë në pakon e z. Ahtisari. Ajo si ide ka lindur që në kohën e regjimit të Milosheviqit në vitet 90-ta, por tani zyrtarizohet. Në sistem të tillë të decentralizimit njënacional në shëndetësi nuk mund të kemi funksionalitet në shërbimin shëndetësor, në përgjithësi pra në Kosovë. E nuk funksionon ligji i shëndetësisë për shëndetin publik, pastaj Ligji për transfuzionin, për informimin e sigurimin shëndetësorë dhe tjera e tjera nuk është në dobi të qytetarit të Kosovës

Në emër të decentralizimit pozitiv a mund të lejojmë ekstra privilegje për minoritet dhe jo për një minoritet tjetër.

Në pako nuk përmendet ato që janë arritur dhe për të cilat ne në Kosovë mburremi sa ju takon minoriteteve. Integrimi e minoriteteve të tjera në të gjitha institucionet dhe ajo që është ofruar komunë e re për minoritetin turk, shkollimi deri në fakultet për minoritetin boshnjak dhe të tjera, kujdesi social për minoritetin romë, ashakli dhe të tjera i cili dhe vazhdon.

Pse lejohet diskriminimi në baza dhe përkatësi fetare ndërsa privilegje për përkatësin tjetër fetare. Kush dhe si u dokumentua përkatësia etnike e kishave dhe monumenteve në Kosovë e që përmenden në të ashtu quajtura zona mbrojtëse. Pse duhet të sakrifikon kishat dhe monumentet tjera fetare në emër të një përkatësie tjetër fetare si për shembull kisha e Letnicës që është një simbol për kishën katolike në Kosovë. Tyrbja e Sulltan Muratit, kulla e Isa Buletinit që është gjithashtu një simbol dhe për cilën populli shumicë sigurisht që ndihet i ofenduar.

Në emër të zonave mbrojtëse dhe të kishave të ashtuquajtura ortodokse serbe. Ku janë kishat bizantine të Kosovës si trashëgimi dhe vlera kulturore ku lejohet dhe kërkohet trashëgimia e pronës dhe e Kishës Ortodokse që nga mesjeta. Më bëhet se në këtë lëmi sa i përket trashëgimisë kulturore z. Ahtisari nuk ka pas mjaftë fakte dhe argumente për trashëgimin autoktone. Ndoshta sot diskutuam mjaftë por diskutuam kot, sepse disa gjëra edhe nuk mund të ndryshohen por sigurisht mbetet frika e funksionalitetit dhe e sigurisë

së shtetit të Kosovës në këto rrethana që na janë ofruar si dhe kostoja shumë e shtrenjtë e obligimeve të mëdha.

Dua të them se është vështirë kjo të funksionoj nën tutelën ndërkombëtare shumë të rëndë e cila është vështirë të hiqet nëse pakaja nuk plotësohet. Ky projekt ka mund të jetë shumë praktik dhe funksional me një pako përcjellëse të zhvillimit ekonomik të Kosovës që është çelësi dhe zgjidhja e bashkëjetesës së qytetarëve të saj.

Ky plan më tepër i ngjan një plani Dejton të pasuksesshëm, siç ndodhi në Bosnje se sa një plani të mundshëm shumë praktik planit Marshall me nevojat që i ka Kosova. Kur përmenden, tanimë me shumë çështje jam pajtuar dhe ato u thanë. Por unë do t'i shtojë edhe disa.

Kur përmenden arhivat dhe dokumentacionet sikur harrohen Fondi i pensioneve, Fondi shëndetësor, kursimet në bankat e qytetarëve të Kosovës, Thesari i Kosovës.

Në fund z. Kryetar, më lejoni që të propozoj të themelohet një grup i cili do të nxirrte konkluzionet e përgjithshme dhe konkluzionet e veçanta nga kjo seancë shumë e gjatë, që do t'ia dorëzonte Grupit të Unitetit, i cili me durim e përcolli këtë seancë maratonike, por ka nevojë për këto konkluzione edhe z. Ahtisari. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Gjylshen Berisha. Le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

DEPUTETJA GJYLSHEN BERISHA – I nderuari kryetar i Parlamentit, i nderuari kryetar i Kosovës, Grupi i Unitetit që si duket Grupi i Unitetit ka kaluar krejt në LDK me këtë qëndrueshmëri të gjatë sonte këtu deri në këto orë të vona, është një shaka për një relaksim me të vërtetë.

Më lejoni të përshëndes dhe njëkohësisht t'i falënderojë punën e madhe dhe angazhimin e z. Ahtisarit dhe të gjithë ata që e kontribuuan që ne sot të diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme për Kosovën për dokumentin si bazë substanciale për formimin e shtetit dhe për perspektivën evropiane të Kosovës.

Do të citojë fjalët e z. Ahtisari se dokumentin dinë ta lexojnë ata që i njohin zhvillimet në Kosovë prej vitit 1989 e këndeje. E ne i njohim zhvillimet në Kosovë edhe më herët. Andaj, e kuptoj dhe e përkrah në parim këtë ofertë të z. Ahtisari si një propozim që ofron bazë për një marrëveshje të drejtë dhe të qëndrueshme. Mendoj se ndryshimet eventuale sigurisht janë të nevojshme, por vetëm me qëllim të funksionalitetit të shtetit dhe të institucioneve. Gjithmonë mund të themi se ka pasur mundësi të jetë edhe më mirë, por është kjo që është.

Dhe e përkrah me besimin e plotë në finalizimin e procesit edhe të këtij dokumenti. Me njohjen e pavarësisë së Kosovës që njëkohësisht do të finalizojë procesin për stabilitetin dhe paqen në rajon.

Kërkoj nga Grupi i Unitetit, vërtet të reflektojë një unitet në funksion të jetësimit të vullnetit politik të popullit të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran . Besoj ,gjithashtu .se ky grup bashkë me ekspertët do t'i marrë për bazë propozimet dhe diskutimet konstruktive të deputetëve në këtë seancë.

Dhe në fund, do t'i falënderoja miqtë e Kosovës që punuan dhe punojnë edhe tani për Kosovën. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, le të përgatitet deputeti Mazllom Kumonova.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – Faleminderit z. Kryetar, i nderuari president Sejdiu, kryeministër dhe anëtarët e Grupit të Unitetit z. Thaçi dhe z. Surroi.

Unë do të jem shumë i shkurtër dhe përshëndes punën që e keni bërë dhe besoj që Grupi i Unitetit do të veprojë për të mirën e të gjitha komuniteteve. Unë shpresoj se këtu asnjë nuk e njeh më shumë Kosovën se sa ju që e prezantoni dhe bëni përpjekje të shkurorëzoheni nga një shtet i cili ka sjellë lufta të mëdha në Ballkan.

Prandaj, do ta tërheq fjalën time dhe do t'i përshëndes Grupin e Unitetit që të punojë për të gjitha komunitetet, por edhe për komunitetin egjiptas. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Faleminderit që e mbajtët fjalën. Fjalën e ka deputeti Mazllom Kumnova, le të përgatitet deputeti Ferid Agani.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Z. kryetar, z. president, z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi. Gjatë leximit të këtij dokumenti edhe pse i pritur me **shumë** nuk mund ta lexosh pa emocione kuptohet. Nuk kërkohet ndonjë zbërthim aq detaj për të radhitur shumë vërejtje, veç disa vërejtje u thanë nga kolegët dhe disa të tjerë do të paraqiten edhe pas meje. Unë po shkëpus vetëm disa vërejtje.

Neni 1.7 te simbolet kombëtare në realitet përcaktohet karakteri dhe përmbajtja e atyre, çfarë mbetet këtu për t'u vendosur? Asgjë. Do të thotë kërkohet vetëm një dizajn për mua është kundër çdo parimi të njohur ndërkombëtarisht për simbolet e një shteti.

Neni 1.9 thuhet në dokument se tërë pushtetin e domosdoshëm në zbatim të marrëveshjes e kanë institucionet e instaluar ndërkombëtare. Kërkohet një riformulim tjetër, sepse është denigruese për institucionet vendore dhe të zgjedhura nga populli, ka fuqi e prova legjislative dhe administrative çfarë ndodh vetëm në koloni, ka kuptimin e vendosur me shtrëngim që rrezikon qytetërimin dhe format tradicionale të vlefshme të jetës në Kosovë.

Aneksi i dispozitës kushtetuese ,dispozitat themelore pretendojnë që marrëveshja të jetë mbi Kushtetutën e Kosovës. Unë nuk e di a ka ndonjë rast të tillë që rekomandohet dhe jo vetëm në praktikën aktuale, por edhe në trajtimet shkencore e di si praktikë e tillë është në Bosnje ,mirëpo të gjithë e dimë sa ka treguar sukses. Kështu si është propozuar krijohet

një hierarki që do të jetë e veçantë „do të kemi marrëveshje, Kushtetutë, ligje etj. etj. në shqip mbi Kushtetutën e këtij shteti të ardhshëm të Kosovës „do të jetë marrëveshja pra një kaçubet.

Unë dhe të tjerët besojmë se përmbajtja e këtij dokumenti mund të jetë objekt i shqyrtimit gjatë hartimit të Kushtetutës, mirëpo kurrsesi mbi Kushtetutën dhe atë pa e afatizuar.

Neni 1 pika 6 e aneksit të parë, kur flitet për të drejtat e qytetarëve të ish -Republikës Federative të Jugosllavisë u tha edhe më parë të cilët kanë qenë banorë më 1 janar të vitit 1998 fitojnë nënshtetësinë e Kosovës. si pasojë të gjithë serbët kalojnë nga viset e tjera që janë instaluar në Kosovë pas fillimit të luftës në Kroaci, Slloveni e Bosnje si dhe gjithë paramilitarët serbë do të gëzojnë këtë të drejtë, kjo është e patolerueshme duhet të merret data 31 dhjetor e vitit 1988.

Neni 7 aneksi 3, mbi përparësitë që i jepen organizimit të veprimtarisë së arsimit në gjuhën serbe janë rast pa precedent në sistemet e arsimit ndërkombëtar, me një anë formohen komisionet e pavarura që duhet ta rregullojnë dhe janë vendimmarrëse sidomos në organizimin e arsimit universitar dhe në anën tjetër anashkalohet gati në tërësi Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, si institucion kompetent përgjegjës për veprimtarinë e arsimit. Unë nuk di se në veprimtarinë e arsimit diku në botë a ekziston kjo mënyrë e zgjidhjes. Atëherë është e drejtë jona të kërkohet një kriter i tillë edhe për arsimin shqip në Luginën e Preshevës.

Aneksi 9, në mandatin e autoritetit të përfaqësuesit civil ndërkombëtar në përshkrimin e përgjegjësiave monitoruese ka edhe shmangie në drejtimin që nuk kufizohet vetëm në monitorim.

Dispozita e nenit 1.2 2 ngritja e këtij autoriteti ndërkombëtar deri në largim nga detyra e çdo zyrtari publik apo të ndërmarrë masa të tjera, është një kompetencë autoritare, kompetencë monitoruese që nënvlerëson autoritetet vendore.

Po ashtu janë dhënë përgjegjësi të pakufizuara të emërimeve dhe kompetenca të drejtpërdrejta.

Aneksi 3. decentralizimi. Nëse lexohet me kujdes dokumenti vërehet se hartuesi është nisur nga realiteti ekzistues dy pushtete lokale, duke bërë përpjekje që të ofrohet një zgjidhje tjetër, një kompromis, me sa duket eksperimental, prandaj duhet të rishikohet seriozisht sidomos nga Grupi i Unitetit, duke u nisur nga realiteti, objektivi, integrimi i këtyre komunave me shumicë serbe në pushtetin lokal të Kosovës e që në të vërtetë si komunitet do të jetë më i privilegjuari në botë. Qëllimi ka qenë integrimi i asaj pjese të Kosovës që ka qenë rebeluar e dirigjuar nga politika e Beogradit dhe e përkëdhelur nga Administrata e UNMIK-ut.

Dispozitat e Aneksit 3, të nenit 4, kompetencat e zgjeruara vetanake komunale janë propozuar kompetenca të nivelit qendror të qeverisjes, fuqisë të shtetësie dhe janë

përcaktuar komuna ,siç thuhet në dokument ,me shumicë serbe në fushën e arsimit ,të policisë ,të shëndetësisë ,të politikës fiskale që nuk i kanë komunat e tjera sipas të drejtave të avancuara që realisht diskriminon komunat e tjera ,në qoftë se i ndan një lumë në mes.

Autoriteti qendror sipas dispozitave të këtij dokumenti vlerëson pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe ligjet.

Sipas nenit 6 pika 1, të këtij aneksi nuk mund të pezullojë ekzekutimin e vendimeve komunale çfarë paraqet **absolutet** në procesin e zbatueshmërisë së Kushtetutës dhe të ligjeve. Mirëpo është fakt se ne mund të kontestojmë aneksin e decentralizimit me aneksin e këtij dokumenti dhe në përgjithësi politikën e zgjerimit me komunat e reja, por nuk bën të harrojmë kaq shpejt se ky është produkt i Grupit të Unitetit dhe i bisedimeve në Vjenë.

Pra, dokumenti në këtë drejtim është një vazhdimësi dhe unë e kuptoj kështu. Është fakt se hapen mundësi të bashkëpunimit brenda komunave si dhe bashkëpunimin ndërkufitar. Këto nuk janë bërë si ndryshim i mirë i formës së pushtetit lokal në pamje si e jep leximi i këtij dokumenti, por skajshëm për komuna me shumicë serbe. Shqetësim të arsyeshëm nxit edhe neni 8 në kuadër të dispozitave të financave lokale pika 4 janë dhënë privilegje financiare komunave me përgjegjësi të kompetencave të zgjeruara çfarë shënon një diskriminim ndaj komunave të tjera që nuk e kanë këtë kompetencë.

Në tërësi këto dispozita duhet korrigjohen dhe duhet mënjanuar ky diskriminim. Më vonë nëse zbatohet një ndryshim i tillë Kosova do të përballet me shumë probleme ,qoftë me buxhetin e saj të varfër deri te zbatimi i ligjeve dhe kushtetutës ,qoftë me administrimin e pavarësisë në bashkëjetesë me një komunitet aq të privilegjuar.

Duke mos i përmendur edhe shumë variante të tjera, përkrah këtë dokument me korrigjime vetëm si pjesë e procesit deri te Rezoluta e Këshillit të Sigurimit për njohjen dhe pranimin e pavarësisë së Kosovës. Çdo variant tjetër nuk na detyron ta respektojmë këtë marrëveshje. Po ashtu kjo marrëveshje duhet të hapë çështjen e raportit të shqiptarëve në Luginën e Preshevës me shtetin e ardhshëm të Kosovës. Atë që e pranojmë ne shqiptarët për komunitetin serb, padyshim në mënyrë reciproke marrëveshja duhet të sigurojë edhe për shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe të vendbanimeve të tjera me shumicë shqiptare nën juridiksionin e Serbisë.

Kur e lexova për herën e dytë këtë dokument m'u kujtua një fjalë e popullit në një furrë të hapur buka nuk piqet.

Në fund nuk po e kuptoj Grupin e Unitetit tonë kur njëri thotë se Kosova do të ketë një prani të lehtë ndërkombëtare dhe tjetri prani të fortë ndërkombëtare.

E dyta fjala e papërgjegjshme e z. Surroi dy herë, kur ngreh akuza për ndekje të minoriteteve nga ana e shqiptarëve, mendoj se duhet të kërkojë falje dhe ta kthejë

mbrapshtë këtë fjalë dhe këtë klasifikim. Këtë po e them me respekt që e ndiej ndaj atij si politikan. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ferid Agani. Le të përgatitet deputeti Enver Hoxhaj.

DEPUTETI FERID AGANI - Faleminderit z. kryetar. I nderuari president i Kosovës, i nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari z. kryeministër, të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit z. Thaçi dhe z. Surroi, të nderuar deputetë dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar.

Nga këndvështrimi i Partisë së Drejtësisë Propozimmarrëveshja për statusin e Kosovës nuk reflekton vlerat e sakrificës monumentale të popullit shqiptar, meritat e tij heroike, si dhe pritjet legjitime të shumicës së madhe të popullit të Kosovës. Njëkohësisht është fakt se ky dokument ka mbështetje të gjerë ndërkombëtare. Është i mbështetur nga miqtë tanë më të mëdhenj dhe synon përfundimin e sovranitetit të shtetit serb mbi territorin e Kosovës që pa asnjë dyshim paraqet moment pozitiv dhe historik. Këto fakte kundërthënëse e vështirësojnë vlerësimin objektiv të dokumentit gjë që në disa momente u reflektua edhe gjatë debatit të sotëm dhe të mbrëmjes.

Unë shpresoj se deri në momentin e dorëzimit të Pakos së presidentit Ahtisari në Këshillin e Sigurimit do të qartësohet pozita e tij lidhur me statusin e Kosovës duke definuar atë jo si një shoqëri amorfe, multietnike si qëndron tani por si shtet të pavarur dhe sovran në përbërje shumë etnike dhe shumëkonfesionale. Konsideroj se pa këtë përcaktim juridik shumë zgjidhje brenda Propozimmarrëveshjes mund të kenë potencial serioz destabilizues.

Të nderuar deputetë,

Momenti aktual politik dhe zhvillimet e shpejta politike imponojnë nevojën për veprime konkrete të matura dhe para së gjithash vizionare. Duke pasur parasysh se në momentin aktual mbështetja e propozim marrëveshjes së presidentit Ahtisari nuk ka alternativ kuptim të plotë.

Partia e Drejtësisë e mbështet në parim këtë dokument në radhë të parë nga perspektiva e garancave ndërkombëtare për sendërtimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, ndonëse mangësitë e dokumentit janë evidente. Disa prej tyre u përmendën edhe gjatë debatit të sotëm, shumë prej tyre me siguri se do të paraqiten në formë të shkruar nga ana e deputetëve.

Njëkohësisht e theksoj se anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si shtet i pavarur në sovranitet të plotë dhe të drejtat e barabarta si dhe anëtarësimi i Kosovës në Bashkësinë Evropiane, në NATO dhe në strukturat e tjera veriatlantike paraqet parakusht esencial për realizimin e synimeve të përgjithshme të kësaj marrëveshjeje dhe për zbatimin e saj funksional. Në të kundërtën nëse kjo nuk arrihet, Marrëveshja me veprime manipulative të Qeverisë në Beograd, shumë shpejtë mund të degjenerohet në zgjidhje jofunksionale dhe burim të jostabilitetit në Kosovë dhe në rajon.

Propozimet konkrete për përmirësimin e funksionalitetit të Propozim- marrëveshjes së presidentit Ahtisari sipas neneve përkatëse në radhë të parë kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë, pozitën e bashkësive fetare, anulimin e së drejtës për referendum, ndarjen artificiale të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës nga procesi i formimit të forcave të sigurisë së Kosovës. Të drejtën e licencimit të institucioneve shëndetësore dhe arsimore në nivelin e komunave, rolin e përfaqësuesit civil ndërkombëtar në procesin e miratimit të ligjeve në Kuvendin e Kosovës, lidhjen e nënshtetësisë së Kosovës me datën 1 janar 1998 në vend të lidhjes së kësaj date 31 dhjetor 1988, datë kjo e cila i përcakton kufijtë ndërkombëtarë të Kosovës, çështjen e Mitrovicës e cila në dokument në mënyrë shumë ambivalente në gjuhën shqipe emërohet si Mitrovicë ndërsa në gjuhën angleze ose si alternativë e gjuhës serbe si Mitrovicë e Veriut do të thotë një pasiguri e qartë në këtë aspekt, ku si zgjidhje do të mund të jetë emërtimi si njësi territoriale komunale dhe shumë çështje të tjera, Partia e Drejtësisë do t'ia adresojë, në formë të propozimeve konkrete ,në formë të shkruar dhe do t'ua paraqesë presidentit të Kosovës dhe anëtarëve të tjerë të Ekipit të Unitetit. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Enver Hoxhaj, le të përgatitet deputeti Genc Gorani.

DEPUTETI ENVER HOXHAI – I nderuari z. president, i nderuari z. kryetar, z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi, të nderuar ministra, të nderuar kolegë. E kam ndërmend të jem sa më i shkurt dhe t'i përmend vetëm nja tri- katër elemente të cilat, për mendimin tim, shpeshherë krejt debatin që e kemi pasur këto ditët e fundit, pas arritjes së pakos nga z. Ahtisari, kanë ikë prej këtij debati.

Ndër temat, të cilat kanë qenë më të diskutuara kohëve të fundit, qoftë si përfaqësisht qoftë edhe më detajisht, ka qenë çështja pse paketa nuk e ka emrin e saj emrin e pavarësisë. Për mendimin tim nëse lexohet teksti në gjuhën angleze paketa edhe nëse s'e ka emrin, e ka një shtyllë e cila është e shtetit, konceptin e përmendi atje me qytetarë asaj që thirret si të zë në **shqip në gjuhën angleze**.

Kështu që do të duhej ta kemi parasysh që asnjëherë nuk ka ndodhë në histori që shtetet të cilat kanë lindë në protektorat ,ata të cilët e kanë ushtruar protektoratin, ia kanë ngjitur edhe emrin atij shteti.

Përmendja e nocionit të qytetarisë që është shtyllë e shtetit në gjitha gjuhët dhe gjuha angleze është goxha precize, është bazë e sigurt që teksti do të duhej të interpretohet në atë frymë.

Çështja e dytë që duhet ta ngritë, që u përmend në kontekste të tjera në kuadër të aneksit që merret, me siguri për herë të parë përmendet territori, territori i Kosovës. Shtetet çdo herë kur lindin kryejnë balancë të re, kuptimin e sigurisë. Kështu që nuk ka shtete të cilat nuk kanë territor dhe nuk ka territore që s'kanë shtet

Përmendja e territoreve në konceptin e sigurisë, është shtyllë e identitetit të ri që do ta ketë Kosova.

Paragrafi 3 që u përmend që kalimthi këto ditë dhe është diskutuar më tepër për borxhet në një kuptim tjetër është ajo që ka të bëjë mbi të gjitha me atë që në rastin e përcaktimit të borxhit ndërkombëtar ndaj klubeve që janë përmendur në fjalë do të duhej të respektohen parimet e suksesionit për ish- Federatën Jugosllave. Ne jemi përpjekur për disa decenie me radhë që ta interpretojmë rastin e Kosovës si të tillë që ka qenë pjesë e Federatës Jugosllave dhe sot dhe këto pesë ditë na ik fare nga debati që veç dokumenti thotë që zgjidhja e problemit të Kosovës është zgjidhja dhe përmbyllja e kaptinës së fundit të shkatërrimit të ish -Jugosllavisë.

Dhe debati që ka pasë Kosova gjatë vitit të kaluar ka qenë rreth asaj se si ta kemi një shtet i cili nuk ka kufizim në të drejtat e veta, meqë nuk ka shtet që kanë disa të drejta dhe shtetet që nuk e kanë të drejtat e tjera.

Teksti i ofruar nga z. Ahtisari i përmend të gjitha të drejtat, të cilat i ka një shtet normal. Disa të cilat do të vijnë automatikisht me adresimin në Kombet e Bashkuara disa të cilat do të vijnë gradualisht në të ardhmen.

Shqetësimi më i madh, për mendimin tim, fokusi më i madh i debatit ka qenë i një relacioni tjetër të asaj ku rregullohet çështja e shumicës karshi pakicave. Për mendimin tim çdo debat që ka ndodh në këtë drejtim e që Kosova ka dëshmuar në këto 7 vitet e fundit që është për atë që të krijojë hapësirë për jetën publike në pakica, mund të përmblihet në dy fjali thelbësore.

E para është, për të gjitha ato që u ngritën edhe për arsim edhe për shëndetësi dhe që ka të bëjë me atë nivel ku zakonisht janë përgjegjësit te pushteti qendror. Shqetësimi kryesor është sa mund të ushtrohet një e drejtë do të thotë mund të garantohen të drejtat. Mirëpo sa mund të ushtrohet një e drejtë prej një komuniteti të caktuar.

Dhe e dyta është, në raste të caktuara ,ndoshta, si mund të keqpërdoret një drejtë e tillëqë për mendimin tim në të ardhmen duhet të punojmë drejtë asaj se si kjo pjesë e marrëveshjes të ketë provizione ose të ketë sugjerime konkrete të mos të ndodh që të keqpërdoren të drejtat, me qëllim që të mos kem një bllokim të jetës politike në Kosovë.

Për mendimin tim kam shumë shqetësime të cilat mund të ngriten , por shqetësimet kryesore të cilat janë ngritë nga shefi i Grupit Parlamentar të PDK-ës z. Krasniqi, janë ato thelbësore dhe janë substanca e krejt debatit të cilin do të duhej të lëviz në të ardhmen dhe do të duhej që gjatë kohës së ardhshme ndoshta të mësohemi edhe me situatën kur shpeshherë në orën 10,00 do të debatojmë si të përmbillet kaptina e fundit të shkatërrimit të ish Jugosllavisë. Mirëpo ju ftoj të kalojmë nga pjesa e perceptimit të politikës,që ta shohim politikën si fakt, se ky është një dokument botëror dhe reflekton definitivisht qëndrimin edhe të politikës botërore për procesin. Ju faleminderit. për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Genc Gorani, le të përgatitet deputetja Remzije Nimani.

DEPUTETI GENC GORANI – Faleminderit z. kryeparlamentar. I nderuari z. president, z. kryetar i Parlamentit, z. kryeministër, anëtarët e Grupit të Unitetit dhe kolegë deputetë.

Pa dyshim se një numër i madh shqetësimesh që janë paraqitur këtu kanë argument i fortë, ndonëse me atë argumentim s'është thënë gjithmonë në mënyrë racionale sa do të kishte mund të thuhej. Kjo është njëra prej arsyeve që unë mendoj se duhet së paku për veti. Do t'i përmendi disa prej pikave që besoj edhe janë përmend dhe atë shkurtazi.

Atë që dua ta them kështu në mënyrë ndoshta edhe pak emocionale, është ajo që pritshmëria nga aspekti i një dokumenti që do të propozonte një koncept të qartë ishte shumë më e lartë se sa ajo që po e shoh. Nuk e kam personalisht aq të qartë pse ky dokument nuk propozon një skicë më të qartë, një rrugëtim më të afatizuar dhe një mënyrë të shprehjes, një mënyrë të paraqitjes së kësaj skice të re shumë të rëndësishme dhe pa dyshim historike për ne që cila do të na i zvogëlonte disa prej dyshimeve të cilat pa tjetër lindin prej leximit të këtij dokumenti.

Ajo që besoj se do të na duhet shumë, është në të ardhmen, sepse besoj se s'kemi shumë alternativa që të punojmë së bashku dhe të dakordohemi mbi pikat më të rëndësishme që janë në këtë dokument dhe, pa dyshim, në dokumentet që do të vijin më vonë, ato që do të jenë një farë kuptimi kontraktuale për ne.

Kisha dashur të them se ajo që më shqetëson posaçërisht është kaptina që ka të bëjë me ekonominë. Nuk dihet pse, nuk ka sqarime paraprake pse trusti pensional do të menaxhohet ashti se si parashihet. Nuk di pse dhe cilat janë ato argumente paraprake në lidhje me organizimin e suksesionit të AKM-ës. Nuk dihet si, ndoshta nuk është ky dokument tash, mirëpo skica e dokumentit nuk skjaron nuk jep me shpresua ashtu siç kishim tash lidhje me disa prej zhvillimeve të ardhshme në aspektin ekonomik. Dhe ajo që më së tepërmi më befason është që në dokument nuk bëhet referencë mbi atë se ne hyjmë në një fazë të integritimeve evropiane, euro atlantike. Është jashtëzakonisht materie substancë e varfër në aspekt të ardhmërisë sonë evropiane. E besoj se në këtë dokument pikërisht në këtë dokument ka qenë vendi se ku do të ishte, mund të paraqitej kjo.

Prezenca ndërkombëtare është jashtëzakonisht e fortë në atë masë që kam frikë se jetën tonë demokratike jo vetëm që nuk do ta përkrah në aspekt pozitiv por ka mundësi që ta "Faksifikonë" ta denatyrizon këtë jetë parlamentare, jetë politike në Kosovë e që do të jetë shumë me rëndësi.

Presupozohen shumë gjëra të cilat normalisht do të ishin dash të ishin një çështje e debatit inten tonë politik.

Çështja e zgjedhjeve shembull është e pragjykuar në mënyrë relativisht arbitrare. Nga ana tjetër përvoja tregoi se prezenca ndërkombëtare në shumicë thanë se ajo e fortë evropiane

s'ka qenë gjithmonë shumë efikase dhe veçanërisht jo në atë aspekt çfarë ne presim prej demokracive kaq të vjetra si ato evropiane.

Në asnjë rast nuk më kujtohet se ndonjë instancë e udhëhequr nga kjo prezencë ndërkombëtare është marrë me ndonjë llogari dhënie dhe në asnjë rast nuk më kujtohet se kjo prezencë me të vërtetë definitivisht i ka dhënë një shtytje demokracisë ose një procesi demokratik në atë kuptim që mos të ketë më dyshe. Në asnjë rast garant korrupsionin nuk e di që është zvogëluar nga ata të cilët e kanë kontrolluar çështjen e sigurisë dhe çështjen sa i përket kësaj teme të korrupsionit.

Në fund shpresoj se ne do të kemi fuqi ta realizojmë një përkrahje të mjaftueshme ndaj këtij momenti edhe ndaj zhvillimeve të afërta që vinë këto ditë që janë paralajmëruar nga z. Ahtisari dhe të tjerë. Po më së shumti shpresoj se do të kemi hapësirë politike, kohore dhe ç'fare duhet që shumë prej pikave që janë për implementim t'i diskutojmë, shpresoj shumë që mund të na epet ai rasti të diskutojmë në atë mënyrë që ky tregim të kthehet në një tregim suksesit dhe atë shumë shpejtë. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputetja Remzije Nimani.

DEPUTETJA REMZIJE NIMANI – I nderuari Kryetar i Kosovës me Grupin e Unitetit, i nderuari Kryetar i Kuvendit, ministra, kolegë deputetë. Në propozimin e marrëveshjes për statusin e Kosovës që na është prezantuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara z. Marti Ahtisari do t'i parashtoj disa vërejtje dhe sugjerime që kanë të bëjë më tepër me Mitrovicën, ku sipas kësaj marrëveshje parashihet formimi i dy komunave, komuna jugore dhe ajo veriore e Mitrovicës me një bord të përbashkët. Qytetarët e Mitrovicës e kanë pritur me padurim pakon e Marti Ahtisarit duke shpresuar se do të integrohet Mitrovica e jo të ndahet në dy komuna.

Në nenin 13.4 thuhet se. Përfaqësuesi civil ndërkombëtarë do të hap një zyrë të ndarë në Mitrovicë. E unë propozoj që kjo zyre të jetë në një lokacion ku do të kenë qasje të lirë të gjitha komuniteteve, nuk dihet pra vendi, lokacioni ku do të jetë kjo zyrë.

Mandej thuhet se disa komuna të caktuara në Kosovë do të kenë kompetenca të zgjeruara vetanake, ndër to është Mitrovica veriore e cila do të ketë kompetenca vetanake në arsim të lartë dhe në shëndetësi.

Sipas nenit 7.1.1 Shkollat në gjuhën serbe thuhet aty. Mjafton vetëm të njoftojnë MASHT-in për plan programe apo tekste të hartuara nga Ministria e Arsimit të Serbisë.

Unë propozoj që plan programet dhe tekstet paraprakisht të miratohen nga MASHT-i. Mandej flitet për universitetin e Mitrovicës i cili do të jetë institucion autonom i arsimit të lartë, edhe për këtë propozoj që Universiteti i Mitrovicës të jetë institucion multi-etnik ashtu si po kërkohet edhe për Kosovën me të drejtë shkollimi të të gjitha etniteteve dhe komuniteteve.

Dua të përmendi edhe shfrytëzimin e infrastrukturës ku bëhet fjalë për spitalin në veri, universitetin në veri, mandej shtëpinë e shëndetit në jug, shtëpinë e kulturës në jug dhe palestrën sportive në jug. Për të gjitha këto propozoj që të rregullohen në atë mënyrë dhe të gjitha këto objekte të kenë qasje të dy komunat për shfrytëzim reciprok.

Në nenin 4.1 bëhet fjalë për refugjatë dhe persona të zhvendosur nga Kosova në vendet e tjera të cilët kanë të drejtë kthimi në vendet e veta. Nuk janë përmend fare shqiptarët e dëbuar nga pjesa veriore e Mitrovicës e që janë refugjatë pa status në qytetin e tyre apo edhe në qytetet tjera të Kosovës.

Shpresoj se Grupi i Unitetit do t'i ketë parasysh të gjitha këto vërejtje dhe sugjerime dhe t'i qaset më tepër Mitrovicës sepse është ajo i ka specifikat e veta. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Bajrush Xhejali.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari Kryetar i Kuvendit, i nderuari President i Kosovës, të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, të nderuar ministra që jeni prezentë, kolegë deputetë, përfaqësues ndërkombëtarë.

Ndonëse jokoreksi për marrjen e fjalës unë e kamë edhe një padrejtësi që mu sonte më duhet të dal në veri dhe atje jo të legjitimohem një herë po dy herë dhe të kontrollohem pikërisht sikur të isha kriminel. Për këtë edhe e kërkoja fjalën kur e kam kërkuar megjithatë kjo është e shkuar dhe s'ka asgjë nga kjo.

Para se të jap vlerësimin tim në dokumentin e Ahtisarit më lejoni të demantojë një konstatim gjegjësisht dy konstatime sot të dëgjua këtu nga Veton Surroi dhe Ylber Hysa.

E para, përndjekja e joshqiptarëve, serbëve dhe të tjerët nga Kosova nuk ka ndodhur asnjëherë dhe në asnjë pranverë në historinë e popullit shqiptarë në Kosovës dhe aq që do të ndodhë ndonjëherë të ardhmen që ajo duhej. Andaj konstatimit të tillë i Surroit nuk qëndron dhe si i tillë ky Kuvend duhet ta demantojë sepse është vlerësim i kalkulimeve të hershme politike të një kohe të kaluar dhe të interesave individuale dhe politike.

E dyta, edhe pse nuk është këtu z. Ylberi konstatova nga diskutimi i tij se ai për pjesën veriore të Kosovës as që ka ditë t'i lexoj hartat dhe më vjen keq ndoshta as Grupi i Unitetit fortë mirë hartat nuk ka ditë t'i lexojë. Sido që të jetë kjo është çështje që donë diskutim dhe sqarim më të plotë në procesin e mëtutjeshëm.

Në opinion e krijuar në Kosovë dhe atë ndërkombëtarë është publikuar dhe është thanë me qindra herë se çështja e Kosovës do të zgjidhet në vitin 2006. si dhe kjo çështje do të jetë në pajtueshmëri të plotë me dokumentet e publikuara të Grupit të Kontaktit dhe Grupit të Unitetit. Unë duke qëndruar dhe duke dëgjuar vlerësime të shumta sot do të tërhiqem nga një pjesë e diskutimit tim dhe do të ndalem vetë në ato që konstatoj se nuk janë theksuar deri më tani.

Në nenin 1 pika 1 përkufizimi i propozimit nuk definojnë theksoj, nuk definojnë politikisht dhe nuk sqaron juridikisht shoqërinë multietnike. Në raport me konceptin e shtetasit në Kosovë si shtetas i barabartë pa dallim etnik, fetar, gjinorë social duke nxjerrur minoritetin serbë si të privilegjuar në raport me turqit, boshnjakët, romët, hashkallitë, egjiptianët dhe të tjerët.

Në veçanti ngarohen shumë rëndë shoqëria multietnike me simbolet e shtetësisë së Kosovës si për shembull flamurin, stemën, himnin, i cili qind për qind në të gjitha shtetet e botës shpreh identitetin e kombit shumicë duke garantuar liri dhe të drejtat e përdorimit të simboleve të tyre etnike por jo duke ngritur në nivelin shtetërorë apo duke i përzier dhe krijuar surrogat artificial që është identiteti etnik kulturor, historik, politik, pragmatik, programor të qytetarëve shumicë në Kosovë. Kjo është në kundërshtim të plotë me Bashkësinë Evropiane dhe me dokumentet e Këshillit të Sigurimit të OKB-ës dhe nëse ka dikush fakte të tjera le t'i argumentojë.

Për Mitrovicën paraqiten dhe pasiguri edhe më të mëdha sepse vjen deri te krimi i komunës serbe në veri mbi bazat tipike etnike dhe enklavizuese duke mos i përmbajtur aspak standardeve të reformës dhe as të decentralizimit të pushtetit lokal. Në këtë fazë është më se e domosdoshme që ekipi negociator të ketë parasysh dhe të epë sqarime mbi atë se numri i përfaqësuesve shqiptarë në këtë komunë i boshnjakëve dhe i turqve në çfarë strukture dhe në çfarë mase të sigurisë parashihet në këtë dokument.

Po ashtu para se kjo të miratohet në veri të Mitrovicës duhet të krijohet paraprakisht bordi drejtues si strukturë e definuar dhe përfaqësuar adekuate në përputhje me konstatimet e komunës më parë, dhe po se vjen deri te konstituimi i komunës serbe iluzionet duhet t'i hjekim se serbët do të vinë në këtë bord, ata do të krijojnë jetën që e krijojnë dhe e zhvillojnë edhe tani. Kjo do të ndodhë me fakultetin, me qendrën rajonale të spitalit, me gjykatën, me shërbimin policor dhe me baza të tjera që janë jashtë jurisdikcionit të plotë të institucionit të Kosovës sot.

Në tekstin anglisht të dokumentit shkruan toponimi shqip dhe serbisht çka është mirë. Po këtu është dashur të shkruhet edhe emri gjegjësisht oponimi i Kosovës Kosova dhe jo Kosovo e kjo fjalë pa tjetër në tri gjuhët ka sinonime të ndryshme dhe në këtë kuptim nuk e thotë të vërtetën se fjala bëhet për Kosovën.

Si toponim dhe si emërim. Grupi negociator sipas konceptit të presidentit dr. Ibrahim Rugova ka pasur të bisedoj, nuk ka pasur mandat të bisedoj, por mandat të paraqes vetëm vullnetin e popullit shumicë të Kosovës çka unë mendoj se është dalur në disa pjesë nga kjo sferë. Dhe këtë përgjegjësi mund të marrin ata vetë, unë arsyetime nuk mund të dha, edhe përkundrazi të gjithë atyre dy gjuhësia zyrtare në Kosovë do të ketë implikime politike, financiare dhe shumë çështje të tjera të pazgjedhura me të cilat jemi mësuar dekada më parë.

Të nderuar anëtarë të Grupit të Unitetit, deputetë të nderuar.

Në dokumentin e Ahtisarit në një vend me rëndësi zënë edhe trashëgimi fetare kulturore, në veçanti ajo serbe, por jo edhe ajo shqiptare, turke, boshnjake, rome, hashkali etj. edhe në këtë rast

Unë do të ndalem vetëm në mos përfshirjen e zonave mbrojtëse trashëgimore të kombit kombëtar, kulturorë dhe fetare në veriun e Kosovës dhe me këtë rast kërkoj nga Grupi i Unitetit që objektivën të ketë parasysh që këto zona mbrojtëse të zgjërohen me shumicë atje ku është dhe po trajtohet serbe. Konkretisht në veri të Mitrovicës xhamia e Ibrit, mulliri i vjetër, tek ura xhamia e boshnjakëve, xhamia në fshatin Vllahi dhe Dedi askund nuk kanë hi në këtë juridikcion të zonave të mbrojtës.

Në Zveçan duke krijuar zonën mbrojtëse Kompleksi kulla e Isa Buletinit dhe mundësitë e afrimit të këtij kompleksi janë të pamundura sepse 100 metra zonë ato janë 1,5 m njëra afër tjetrës, këtu u cekën nga shumë.

Kalaja antike e Zveçanit. Zotëri të nderuar dhe pikërisht për ata që kanë menduar, nuk është kala mesjetare dhe koncepti mesjetë dhe koncepti antik, dardan ndryshon në tërësi.

Po ashtu në komunën e Zveçanti në Banjškë kompleksi i varrezave turke i hamamit, i varrezave shqiptare, i xhamisë dhe tjera nuk janë përfshirë dhe për qenë habia më e madhe është: në Vushtrri ura e gurit trajtohet si ura e Vujanoviqëve ndërsa dihet se kush e ka ndërtuar dhe nga është kjo bazë.

Dhe në tërësi në kishat serbe ato ortodokse krijohet një pushtet që kanë vetëm ambasada dhe këto nesër oficerët serbë mund të vinë me ushtri dhe të vjen në petkun e priftit dhe dihet se çfarë roli mund të luan.

Vlerësoj se pika 9 pikë 6 e Grupit Negociator duhet të ketë një qëndrim më të matur dhe më të theksuar. TMK-ja nuk mund të shpërbëhet por të duhet të riorganizohet si forcë mbrojtëse e Kosovës në baza të standardeve të NATO-së.

Vlerësoj se ndryshimi dhe plotësimi si dhe begatimi në nenin 10 ku i kushtohet kushtetutës dhe komisioneve kushtetuese dhe atyre zgjedhore pa tjetër duhet pësua transformime rrënjësore në kuptimin e së drejtës

Për ne dhe mendoj konkretisht neni 12 pika 2 është shumë e diskutueshme dhe jo e arsyeshme sepse mbetemi në një fushë shumë të ndjeshme ku është legjislacioni i vjetër dhe udhëzimet e UNMIK-ut të cilat mund të zbatohen edhe më tutje duke mos e qfuqizuar Rezolutën 1244. Vlerësoj se ka shumë gjëra në strukturimin dhe në qëndrimet në nivelin qeveritarë të nivelit komunal dhe atij lokal. Megjithatë duhet krijuar bazën juridike dhe duke analizuar propozimin e Ahtisarit për statusin e Kosovës nga shikimi politik juridik në mënyrë të qartë rezulton shumë konkluzione dhe pyetje që hapin dilema dhe nuk dhanë përgjigje, shkaktojnë shqetësime dhe mundësojnë komentime subjektive të cilat burojnë dhe interpretimet subjektive të dëshirave individuale.

Prandaj propozimi i Ahtisarit duhet interpretuar në mënyrë reale ashtu siç është shkruar në rrethanat ekzistueshme politike në raport me

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Kelmendi. Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli, le të përgatitet Ymer Halimi.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryetar. Përshëndetje për ju dhe për Grupin Negociator, përshëndetje për kolegët e mijë deputetë. Jam menduar që për shkak të zgjatjes së kësaj seance si dhe për atë që u tha shumë çka të shkurtojë fjalën time në minimum.

Në fillim dua të theksoj se nuk jam aspak i entuziazmuar me këtë pako të cilën na solli z. Ahtisari përkundrazi. Sidoqoftë gjykuar mbi bazën e pakos nuk mund të thuhet se nuk është projektuar një farë shteti. Po çështja shtrohet se çfarë është ky shtet. Për dallim nga disa këtu që patën shumë dilema unë së paku në një çështje unë nuk kam dilemë se, ky farë shteti do të jetë një shtet ulok i palëvizshëm pra, thënë më zbuti, absolutisht nuk do të jetë funksional, aq sa rrezikon të mos implementohet fare si projekt.

Unë kam arsyet e mia do të mundohem që pak disa prej tyre t'i numërojë.

Nën 1, Decentralizimi paraqitet në baza etnike mbi cilën bazë serbët e Kosovës qeverisin në mënyrë autonome rreth $\frac{1}{4}$ e territorit të Kosovës kështu që në fakt në Kosovë formohen dy etnitete shqiptare dhe serbe.

Nën 2, Ky dokument nuk e ndërton Kosovën mbi parimin qytetarë e demokratik por në një dualizëm etnik shqiptaro - serb me kusht që të ndërtohet me konsensus të plotë dhe të detyruar. Pavarësisht se serbët përbëjnë rreth 5% të popullsisë së Kosovës. Edhe pse shqiptarët përbëjnë 90% serbët janë jo vetëm të barabartë në tërë territorin e Kosovës edhe aty ku nuk jetojnë por edhe të privilegjuar duke iu dhënë të drejtën që të pengojnë çdo vendimmarrje të sjell me shumicë votash në Kosovë duke siguruar më parë shumicën e votave serbe sipas parimit të vendimmarrjes konsesuale kombëtare.

Nën 3, Kosova si shtet është i detyruar që për çdo gjë të hy në procesin e negociatave dhe marrëveshjeve të brendshme shqiptaro serbe. Pra nuk respektohet parimi demokratik një qytetarë një votë dhe i marrjes së vendimeve $\frac{2}{3}$ të votave.

Nën 4, Zgjidhja që ofrohet nuk e bënë ndarjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Nën 5, Çështja e pazgjidhur drejtë e Kosovës mbetet burim krize e konfliktit në rajon duke rrezikuar paqen në këtë pjesë të Evropës dhe më gjerë.

Enklavat aktuale serbe. Tani mbi bazën e këtij dokumenti do të shndërrohen në entitet dhe si i tillë do të krijoj kriza sa herë që dojë Serbia dhe këto kriza mbi bazën e fuqishme decentralizimit favorizon dhe derivon ndarjen e Kosovës që për mendimin tim është opsioni i vetëm serb dhe në të cilën çdo gjë është duke investuar Serbia.

Prandaj, faktorët negociues nëse duhen ta sigurojnë një shtet funksional duhet të përfshinë shumë argumente që u thanë me drejtë nga deputetët në këtë seancë.

E mira e këtij dokumenti është se. Çështja e Kosovës bënë një lëvizje përpara pas tetë vjetësh dhe e mira e dytë është se nuk i vëhet pikë çështjes së Kosovës. Prandaj na mbetet të angazhohemi më shumë se deri tash për të realizuar aspiratën tonë shekullore për liri dhe pavarësi. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. fjalën e ka deputeti Ymer Halimi, le të përgatitet Fehmi Mujota.

DEPUTETI YMER HALIMI - Faleminderit Kryetar,
I nderuar Kryetar Sejdiu, Kryeminister Çeku, zoti Thaçi dhe Surroi, të nderuar deputetë,

Do të flas nga disa reflekse mbi dhe nga dokumenti, ku besoj se çkyqjen dilemën për shumë çka. Ju kisha dash që mendimi im sot të interferojë shumë me atë që e kam thanë me një seancë përpara.

Ne kohë më parë kemi debatuar mbi një material që Grupi negociator për statusin e Kosovës që e kishte dorëzuar në Vjenë. Disa kokonkluzione të dokumentit të Ahtisarit kanë derivuar nga ai dokument. Shqetësimet tona që ishin prezentë në atë debat, për zgjidhjen e disa segmenteve të politikave të shtetit janë shqetësuese edhe sot.

Megjithatë, dokumenti i Ahtisarit është një hap në proces për pavarësi.

Dhe mirë është që ne politikë të dihet hapi pasues, së paku bile dy në mënyrë suksesive. A i dimi ne këta hapa pasues? Besoj duhet ti kemi të çartë.

Së pari le të rikujtojmë se Bashkësia Ndërkombëtare vendosi më 1999 që Kosova të administrohet nga UNMIK-u, edhe me një afat trevjeçar.

Ky afat nuk u përfill. Shkaqet mund t'i sqarojë ndoshta historia, por procesi i vendosjes së demokracisë në Kosovë, në një fazë, pësoi konsiderueshëm.

Pësoi, shkak i pjesë të obskurantizmit të politikës tonë, edhe e pjesës burokratike të UNMIK-ut. Dhe tash kjo po reflekton jo mirë në procesin e statusit. Prandaj kjo në vijim nuk duhet të lejohet.

Kjo ishte koha e testimi institucional ndërkombëtar. Si e kaluam duhet ta kemi shumë të qartë.

Me që po hyjmë në një fazë të re, ku po kristalizohen shumë segmente të procesit për shtetësi, me një qëndrueshmëri afatgjate, është mirë që për gjërat që nuk janë determinuar aq mirë; ndoshta edhe ka kohë e vullnet që dikush të veprojë. Për këtë Ekipi i Unitetit duhet të angazhohet dhe te mbështetet nga ne.

Dihet se “karakter i pakorrigjueshëm”, sepse është gjenetik. Ky mendim reflekton në shumë rrafshe. Por ky e prekë edhe këtë dokument, është jo përfundimtar, e ka karakterin, dhe sa duket lë mundësi korrigjimi edhe pse duket i pakorrigjueshëm.

Çka përmban “pakoja e Ahtisarit” nga e pa thënjmja në këtë qastë?
Sintetizon përcaktimin e botës demokratike perëndimore për të mbështetur “principin e vetëvendosjes së një populli” (por në proces), i cili ka përjetuar edhe gjenocid, nga shteti në të cilin ka jetuar.

Sintetizon altruizmin e Krishterimit perëndimor për të na ndihmuar mbi ndjenjën e pastër njerëzore, që të jemi të lirë, i cili altruizëm ka munguar, fatkeqësisht, më 1878 dhe më 1913; A nuk e reflekton kjo në përfundimin e procesit.

Më pastaj, pasqyron realitetin e krijuar të mikroproceseve dhe makroproceseve politike në Kosovë dhe jashtë saj. Propozon zgjidhje ekuilibruese, sipas raportit të forcave politike në Ballkan, duke lënë përshtypjen se kjo është zgjidhja e mundshme.

Kam shqetësim se realiteti i brendshëm në Kosovë ka pjesë hipotetike edhe dokumenti nuk i ka përcaktuar saktë e as drejt, që shihet me plot arsye si pasiguri politike në të ardhmen.

Ky material, në vendorëve na sqaroi se pavarësia nuk është një akt aq i thjeshtë, por është proces që ende e kërkon formën e vet, strukturimin politik dhe klasën politike të përgjegjshme për ta realizuar.

Po ashtu, e vë në sipërfaqe veprimin e një shtrese politike vendore të pozitës dhe opozitës, e cila për shtatë vite rresht e ndau politiken nga funksioni i saj primar-bërjen e shtetit. Kjo shtresë politike i shkëputi substancë materiale mundësisë së vetëqeverisjes vendore në vazhdim, duke e zhvendosur atë në duar të të tjerëve për kohë të papërcaktuar. Pse ishte kështu? Prandaj për këtë duhet të jemi të shqetësuar e shumë të vëmendshëm në proceset në vijim./ kemi Aneks të veçantë për te/

Pakoja e Ahtisarit ka saktësuar se Kosova do të shkëputet edhe juridikisht nga Serbia. Kjo është edhe e vetmja zgjedhje demokratike që do ta pranoi edhe demokracia perëndimore kësaj shumë i besoj.

Prandaj, shqetësimi i ynë real e qendror, duhet të jetë se si do të vendoset funksionimi i shtetit në Kosovë, kur e njohim etnocentrizmin serb dhe qëndrimin tepër refuzues për të bashkëpunuar me institucionet legjitime të Kosovës?

Kjo është pjesa më me përgjegjësi e proceseve në vijim e politikës së vendorëve po edhe për Bashkësinë Ndërkombëtare. Ky duhet të jetë një shqetësimi primar dhe kjo duhet të jetë puna e jonë shumë e vështirë.

Ndërsa veçimi aq i veçantë i objekteve fetare Ortodokse në përmasën e një “Republike Serbe Ortodokse” (nëse emërtimi s’është gabim), është ireal. Le ta sqarojë dikush këtë juridikisht nga Grupi politik strategjik.

Kështu nuk duhet të figurojë në dokument e as ta pranojë demokracia perëndimore. Objektet e rriteve fetare apo bashkësitë fetare nuk emërtohen si Republika. Për ato objekte te kultit fetar e kemi respektin të gjithë ne, se na lidhë ndjenja reale me djersën, brushat, karrigat e të parëve tanë qe i kemi aty.

Së paku për tolerancë fetare e kemi vetëdijen e kamotshme. Nuk mund të na akuzojë askush aq rënd siç paragjykon dokument.

Dhe vërtetë dokumenti i Ahtisarit i lë detyrë klasës politike të Kosovës që të ngre strukturat e shtetit sipas përcaktimit të dokumentit. Ndërsa botës demokratike, përballë këtyre koncesioneve, pak sa hiperbolike, për pakicën serbe i jep rastin që me rezolutën Re të OKB të sjellë një vendim demokratik, i cili duhet të pasqyrojë vullnetin e popullit shumicë të Kosovës. Ky është hapi qe duhet te vjen dhe e presim.
Deputetë të nderuar,

Do të jemi me shtet e të lirë, në kuptimin e plotë, vetëm atëherë kur ligji arrin të sanksionojë të bërat gabim të politikanit, deputetit, ministrit, kryeministrit apo të kryetarit të shtetit. Ky është sot kahu i proceseve që sot ekziston në botën demokratike, për bërjen e shtetit. Atë herë do të jemi te pranuar nga te gjithë.
Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fehmi Mujota, le të përgatitet deputeti Gazmend Muhaxheri me kartelën e Nazim Jasharit.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Faleminderit z. kryetar, z. president, z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi të nderuar ministra dhe të nderuar deputetë.

Debati i sotëm për një çështje kaq kapitale për Kosovën sikur ka dëshmuar por edhe një herë që ne në shumë raste nuk diskutojmë mbi bazën e asaj që quhet realiteti që ka na përcjellur në procesin e pas luftës në Kosovë po edhe më herët.

Në qoftë se shikojmë pak ma me vëmendje dokumentin e propozuar nga z. Ahtisari atëherë mendimi im është që këtë dokument mund ta ndajmë në dy pjesë.

Pjesa e parë e dokumentit është ajo pjesë e cila tregon fuqishëm bazën e krijuar deri më 12 qershor të vitit 1999 përfunduar me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ndërsa pjesa e dytë e këtij dokumentit që rastin ton quhet aneks të dokumentit. Prezanton përgjithësisht procesin e pasluftës në Kosovë dhe qeverisjen në Kosovë. Këto dy anë të dokumentit në qoftë se shikohen mirë dhe në qoftë se i analizojmë ashtu si tani për tani duhet prezantuar edhe në arenën që na pret do me thanë në fazën finale të përcaktimit të statusit politik të Kosovës.

Duhet parë që Vjena është një prodhim i procesit ndërsa, procesi nuk e ka prodhuar Vjenë, dhe po të shikojmë këtë gjë në këtë mënyrë atëherë del që akti përmbyllës final i statusit të Kosovës do të jetë pavarësia e Kosovës dhe sovraniteti i Kosovës i finalizuar

përmes rrugës tash më të njohur dhe përmes punës që ne duhet bërë edhe Kuvendi i Kosovës dhe gjithë qytetarët e Kosovës.

Është një moment për të vlerësuar punën e Ekipit Negociatorë, punën e Ekipit të Unitetit bashkë me gjithë grupet tjera punuese përfshirë këtu punën e Grupit politik strategjik që është puna bosht dhe gjithë ekipet përfaqësuese në Vjenë. Jo për të përfaqësuar zërin e tyre si edhe vet që jam pjesë e atij delegacioni përfaqësues, por vërtetë duhet të kemi qartë një gjë që jo, jo.....